monumentet

DO NOT COPY

50 VJET
STUDIM
DHE RESTAURIM I
TRASHËGIMISË
KULTURORE SHQIPTARE

50 YEARS
STUDY
AND RESTORATION
OF ALBANIAN
CULTURAL HERITAGE





55/2016

Monumentet

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
"GANI STRAZIMIRI"

MINISTRY OF CULTURE
INSTITUTE OF CULTURAL MONUMENTS
"GANI STRAZIMIRI"

DO NOT COPY

Monumentet

Restaurimi ndër vite

Katalog i ekspozitës me rastin e
50 vjetorit të IMK

Monuments

Restoration in years

Catalog of the Exhibition on the occasion of the
50th Anniversary of ICM

55-2016

DO NOT COPY

Përgatiti / Prepared by

Prof. Dr. Pirro Thomo
Ark. Joli Mitrojorgji

Materiali u përzgjodh / The material was selected by

Arta Dollani
Pirro Thomo
Joli Mitrojorgji
Agron Islami

Tekstet u shkruajtën nga / The texts were written by

Pirro Thomo
Joli Mitrojorgji
Era Xhaferaj

Redaktimi letrar / Editing
Mimoza Zereci

Përkthimi nga shqipja në anglisht / Translation from Albanian into English

Stafi i IMK / Staff of ICM

Redaktimi i tekstit anglisht / English text editing

Thomas Lanterman
Iris Baboçi

Përpunimi grafik i fotove dhe skicave / Graphic processing of pictures and drawings

Graphic Line, Gjergji Kote

Faqosja kompjuterike / Layout

Marson Korbi

DO NOT COPY

Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
Publication of the Institute of Cultural Monuments
Tiranë 2016

Hyrje

Retrospektivë e misionit të Institutit të Monumenteve të Kulturës në 50 vjet

Misioni i Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" mbetet i pandryshuar në këtë gjysmë shekulli: gjurmim, dokumentim, mbrojtje, studim dhe restaurim i monumenteve, si dhe botim i rezultateve studimore e restauruese.

Instituti i Monumenteve të Kulturës u themelua në vitin 1965 nga Gani Strazimiri, i cili përzgjodhi njerëzit që plot pasion qëmtuan mbarë Shqipërinë për të evidentuar e vënë në mbrojtje thesarin më të madh të popullit shqiptar, monumentet.

E nisën këtë rrugë fare të rinj, e vazhdojnë dhe sot me ngulm e përkushtim, me po të njëjtën energji rinore për të na transmetuar ato dije e mjeshtëri të akumuluara për 50 vjet.

Kjo konferencë mbahet për nder të këtij jubileu dhe në mirënjohje të heronjve të Monumenteve që nuk ndodhen më mes nesh.

Gjatë dy ditëve të konferencës do të ndjekim disa raste studimore, të prezantuara nga studiues shqiptarë e të huaj, mbi vlera, tipare e tipologji të ndryshme të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Ndihem e nderuar të falënderoj Prof. Pirro Thomon, Prof. Emin Rizën, Prof. Aleksandër Meksin, Prof.Gjerak Karaiskajn, gjithë specialistët restauratorë që kanë dhënë e japin kontribut të vyer, studiuesit, bashkëpunëtorët pranë fakulteteve, stafin e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Drejtorive Rajonale, për mbështetjen dhe punën e çdo dite.

Rikthehem në përmendjen e Institucioneve që kanë bërë historinë e Trashëgimisë Kulturore shqiptare. Bazat e para u formuluan nga Instituti i Shkencave të Shqipërisë. I themeluar në vitin 1948, botoi dekretin 568, datë 17.03.1948 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla", me 107 monumente të gjinive të ndryshme, kryesisht ndërtime mbrojtëse dhe kulti, si edhe ndërtime shoqërore.

Më tej miratohet Rregullorja "Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe historike dhe pasurive natyrore të rralla", me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 30, datë 09.04.1955.

Universiteti Shtetëror i Tiranës, themeluar në vitin 1957, përfshiu në përbërjen e tij Grupin e Kulturës Materiale, me mision gjurmimin, studimin dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës.

Fillimet e edukimit të masës popullore datojnë me vendimin e datës 07.07.1959 i KQ të PPSH "Mbi traditat patriotike e revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm".

Shqipëria aderon për herë të parë në Konventa Ndërkombëtare me Dekretin Nr. 3131, të datës 18.07.1960, e cila përfshin atë në Konventën "për Mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur" si edhe në "Protokollin" dhe "Rregulloren për zbatimin e Konventës".

Qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit, nëntoka e Durrësit dhe Pazari i Vjetër i Krujës, vihen në mbrojtje shtetërore me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 172, datë 02.06.1961. Në po këtë datë miratohet "Rregullorja mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit". Lista e monumenteve pasurohet me 88 monumente të gjinive të ndryshme, në qytetin muze të Beratit.

Anëtarësimi i Shqipërisë në ICCROM (Qendra Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve) shënon në vitin 1962. Por specialistët shqiptarë nuk mundën të përfitojnë në kohë kualifikimet profesionale të kësaj Qendre.

Krijimi i Atelieve të përhershme restauruese në qytetet e Gjirokastrës, Beratit, Korçës, Durrësit dhe Shkodrës, ishte një hap tepër i rëndësishëm në përkujdesjen e përditshme dhe në restaurimet madhore të monumenteve. Ato krijohen me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 283, dt. 28.07.1962 "Mbi disa masa për mbrojtjen, ndreqjen dhe restaurimin e monumenteve". Këto atelie u bënë qendra të grumbullimit të mjeshtrave të punimit të materialeve

DO NOT COPY

Hyrje

Retrospective mission of the Institute of Cultural Monuments for 50 years

The mission of the Institute of Cultural Monuments' "Gani Strazimiri" remains unchanged after half a century and continues to consist of : The tracing, documentation, protection, study and restoration of monuments, and ... the publication of the results of the restoration studies.

The Institute of Cultural Monuments was founded in 1965 by Gani Strazimiri, who selected passionate people who in turn, searched throughout the land of Albania to identify and protect the greatest treasures of the Albanian people: Monuments.

These dedicated men started on this road when they were very young, but even today they continue with tenacity and dedication, with the same youthful energy in order to pass on to us the heritage of their accumulated knowledge and skill of 50 years.

This conference today and tomorrow is held in honor of this jubilee with sincere gratitude to the heroes of monuments that are no longer among us.

During these two days of the conference, we will attend several case studies presented by Albanian and foreign scholars on the significant values and features of different types of Albanian cultural heritage.

I feel honored to thank Prof. Pirro Thomo, Prof. Emin Riza, Prof. Aleksandër Meksi and Prof. Gjerak Karaiskaj, all restoration specialists who have given and continue to give valuable contributions, Thanks also to the researchers, collaborators at the faculties, the staff of the Institute of Cultural Monuments and the Regional Directories, for their support and every day work.

This precious exhibition comprises a series of remarkable restoration work over the course of 50 years. There you will find survey documents, projects and photos taken during the execution of the restoration works, which were realized through countless changes and today they are examples of restoration work done at a European level. Among the works of the exhibition are also presented graphic works, drawings and paintings by well-known architects and engineers, who have collaborated with the Institute over the years and actively pursue our work.

In addition I would like to mention the institutions that made the history of the Albanian Cultural Heritage. The first bases were formulated by the Institute of Sciences of Albania. Established in 1948, it published Decree 568, dated 17.03.1948 "On protection of cultural monuments and rare natural monuments", with 107 monuments of various types, mainly fortifications and religious constructions as well as social objects.

Further it was approved the Regulation "On protection of cultural and historical monuments and natural rarities", by the Council of Ministers Nr. 30, dated 04.09.1955.

The State University of Tirana, founded in 1957, included within its structure the Material Culture Group, whose mission was the tracking, studying and protection of cultural monuments.

The beginnings of educating the masses dated the decree 7.7.1959 of the CC of the PLA "On patriotic and revolutionary traditions of our people and measures for their recognition and further development."

Albania joined for the first time in International Conventions through Decree Nr. 3131, dated 07.18.1960, which included Albania in the Convention of "Protection of cultural values in case of armed conflict" as well as "the Protocol" and "Regulations for the implementation of the Convention".

The cities of Berat and Gjirokastra, the many unexcavated ancient constructions of Durrës and the Old Bazaar Kruja, were placed under state protection by the Council of Ministers with decision Nr. 172, dated 02.06.1961. On the same date was approved the "Regulation on the administration of the city-museum of Berat". The list of 88 monuments was increased by adding monuments of different genres, in the city of Berat.

Albania's membership in ICCROM (International Centre for Conservation and Restoration of Monuments) was

DO NOT COPY

tradicionale të ndërtimit, të cilët u mirëkualifikuan me kohën. Lista e tretë e monumenteve të kulturës u shpall në vitin 1963, nga Rektorati i Universitetit të Tiranës. Pas listës së vitit 1948 dhe 1961, numri i objekteve me status monument kulture arrin në 471.

Miratimi i "Kartës së Venecies", dokumenti ku bazohen konceptet e vlerësimit dhe restaurimit të monumenteve, daton në vitin 1964. Delegacioni shqiptar mori pjesë në Kongresin II Ndërkombëtar të arkitektëve dhe teknikëve të monumenteve dhe kjo shënon një ngjarje me rëndësi historike për fushën e restaurimeve në Shqipëri.

Instituti i Monumenteve të Kulturës themelohet me vendimin Nr. 67, datë 15.03.1965, të Këshillit të Ministrave. Në dokumentin fillestar ai cilësohej Instituti i Mbrojtjes dhe Restaurimit të Monumenteve, por ky emër shumë shpejt zëvendësohet me emrin e tij aktual.

IMK tashmë ngarkohet me detyrën e mirëmbajtjes, mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të monumenteve historiko kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke bërë studimet teknike dhe shkencore përkatëse. Specialistët e IMK zhvillonin paralelisht punën kërkimore dhe hartonin projektet e restaurimit, zbatimin e të cilëve i ndiqnin në terren. Gjithashtu propozonin dhe vinin në mbrojtje objektet me vlera të spikatura.

Viti 1967 pati pasoja tronditëse në fushën e monumenteve. Ndalimi i ushtrimit të fesë, u ndoq nga shkatërrimi i një numri të konsiderueshëm objektesh kulti, madje dhe të atyre që për vlerat e tyre madhore ishin të shpallura monumente kulture, vlerat e të cilave u zhdukën përgjithmonë. Por dhe to që mbetën u përdorën për funksione tepër banale dhe shpesh poshtëruese, si për depo, stalla bagëtish etj. Dhjetra objekte të tjera u rrezikuan, vlerat e tyre u minimizuan dukshëm, në mënyrë që t'i shpëtonin valës së verbër së shembjes, duke i sjellë kulturës kombëtare një dëm të pallogaritshëm.

Botimi i Revistës Monumentet ishte një risi në këtë fushë. Numri i parë daton në vitin 1971 dhe në të botohen kryesisht artikuj të punonjësve të Institutit mbi punimet restauruese e çështjet studimore. Numri 53 i revistës u botua në fund vitin 2015. Krahas revistës Monumentet u botuan disa monografi e albume.

Në vitin 1973 lista e monumenteve të Shqipërisë pasurohet dhe arrin numrin 700 të tilla. Objektet e shtuara janë kryesisht Monumente të kategorisë së parë së qytetit muze të Gjirokastrës, si dhe disa banesa fshatare.

Rregulloret e Qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës përmblidhen në një të vetme në vitin 1984.

Në vitin 1987, Komiteti i Kulturës dhe Arteve ishte organi i ngarkuar me shpalljen e monumenteve të kulturës.

Në harkun kohor të 40 viteve (1948-1988) janë miratuar 14 lista monumentesh, çdo herë duke e pasurur atë (përveç vitit 1967) duke arritur në numrin 1134. Lista u pasurua me komplekse ndërtimore dhe qendra të banuara, si dhe objekte të veçanta.

Shqipëria anëtarësohet në "Konventën për mbrojtjen e Pasurisë Botërore Kulturore dhe Natyrore" të UNESCO-s në vitin 1989. Akademia e Shkencave të Shqipërisë ngarkon Insitutin e Monumenteve të Kulturës me hartimin e dosjeve për cilësimin e Qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Qendrës Arkeologjike të Butrintit, Amfiteatrit të Durrësit dhe Varreve të Selcës, "Pasuri Botërore".

Si rezultat, Qendra Arkeologjike e Butrintit, shpallet "Pasuri Botërore" e Unesco-s në vitin 1992.

Një tjetër ngjarje me rëndësi është shpallja e Gjirokastrës Pasuri Botërore në vitin 2005, më pas vijon Berati si i tillë në vitin 2007.

Në dhjetor 2015, Ministria e Kulturës, nën kujdesin e veçantë të ministres Mirela Kumbaro, prezantoi krijimin për herë të parë të hartës WebGIS, database-it të unifikuar me të gjitha materialet e arkivave të IMK-së. Ky databazë standardizon mënyrën e hedhjes dhe analizimit të informacionit, kategorizimin korrekt të monumenteve sipas një strukture të organizuar.

Për sa i përket listës aktuale të monumenteve të kulturës, numri i këtyre objekteve është 1892.

DOKUMENTI

in the year 1962. But the Albanian specialists were not able to benefit in time for the professional qualifications offered by this center.

The establishment of permanent restorative Ateliers in the cities of Gjirokastra, Berat, Korça, Shkodra, and Durrës was a very important step in the daily care and major restoration of monuments. The Ateliers were created by the decision of Council of Ministers Nr. 283, dated 07.28.1962 "On some measures for protecting, repairing and restoration of monuments". These ateliers became the centers for the master craftsmen of traditional building materials, whose skills in restoration construction improved over time.

The third list of cultural monuments was declared in 1963 by the Rector of the University of Tirana. After the list of 1948 and 1961, the number of buildings with the status cultural monument reached a total of 471.

Adoption of the "Venice Charter", the document which the concept of assessment and restoration of monuments was based on, dates back to 1964. The Albanian delegation took part in the Second International Congress of Architects and Technicians of monuments and this marked an historic milestone for the field of restoration in Albania.

The Institute of Cultural Monuments was established by Decision Nr. 67, dated 03.15.1965 of the Council of Ministers. In the original document, it was named Institute for Protection and Restoration of Monuments, but this name was quickly replaced by its current name.

ICM was already tasked with the maintenance, protection, conservation and restoration of cultural and historical monuments in the territory of the Republic of Albania, making the relevant scientific and technical studies. ICM specialists developed parallel research studies for designing restoration projects, the implementation of which was followed on the actual project sites. They also proposed and put under protection objects of outstanding value.

The year 1967 was a time of dramatic political upheaval which put many of Albania's monuments in tremendous peril. Prohibition of the exercise of religion was followed by the destruction of a great number of cultural objects, many of which had been designated as monuments of culture for their significance. Sadly, many of those disappeared forever. Those remaining were used for functions, rather banal and often humiliating, such as warehousing, cattle stalls, etc. Dozens of others were at risk, their intrinsic values being significantly minimized in order to escape the blind wave of destruction that caused incalculable damage to the national culture of Albania.

The publication of the magazine " Monumentet" was a novelty in this field. The first edition dates back to 1971 and mainly published articles of employees of the Institute on restoration work and study issues. Number 53 of the magazine was recently published in late 2015. Besides "Monumentet" magazine, several monographs and albums were published, too.

In 1973, the total number of monuments listed in Albania was increased to 700. The objects added then were mainly monuments of the first category of the museum city of Gjirokastra, as well as some rural dwellings.

Regulations for both historical centers of Berat and Gjirokastra were summed up in a single regulation in 1984. In 1987, the Committee on Culture and the Arts was the body charged with the notification of the monuments of culture.

Over the span of 40 years from 1948 to 1988, 14 lists of monuments were approved, each time (except in 1967) until the total number reached 1,134. The list grew even longer due to the addition of complex construction and residential centers, as well as special objects.

Albania joined the "Convention for the Protection of the World Cultural and Natural Assets" of UNESCO in 1989. The Academy of Sciences of Albania charged the Institute of Cultural Monuments with the duty of creating

DO NOT COPY

Instituti i Monumenteve të Kulturës vijon intensivisht punën në gjurmimin dhe studimin e vlerave të objekteve në të gjithë territorin e Shqipërisë.
Pavarësisht tjetërsimit diametral të realitetit shqiptar, misioni i mirëartikuluar dhe qëllimi i qartë nuk kanë ndryshuar.
Në nismën e ndërmarrë "Edukim përmes Kulturës", ka vendin e tij edhe edukimi lidhur me Monumentet e Kulturës, një sfidë kjo për të gjithë ne: kujdesin ndaj tyre, përhapjen e dijes, shpjegimin pse domosdoshmërisht monumentet duhen mbrojtur, që ky shpjegim të jetë i kuptueshëm dhe të formëzojë ndërgjegjen e shoqërisë.
Aktualiteti na dikton tashmë jo vetëm restaurimin fizik të monumenteve, por edhe shpjegimin: përse duhen ndërmarrë këto hapa. Përgjegjësia për monumentet nuk kufizohet në një rreth të ngushtë specialistësh dhe nëpunësish, por zgjerohet në banorë objektesh, administrues të tyre dhe gjithë shoqëria. Të gjithë ne jemi rojtarët e monumenteve.

Arta Dollani
Drejtore e Përgjithshme e IMK

DO NOT COPY

files for setting up the historical Centres of Berat and Gjirokastra, the archaeological Center of Butrint, the Durres amphitheater and the tombs of Selca, as " World Assets."

As a result, the archaeological Center of Butrint was declared by UNESCO to be a "World Asset" in 1992. Another important event was the announcement of Gjirokastra as a World Asset in 2005, then followed by Berat in 2007.

In December 2015, the Ministry of Culture, under the auspices of the Minister Mirela Kumbaro, presented, for the first time, the creation of Web GIS's map, a unified database containing all the materials of the archives of ICM. This database standardizes the way of categorizing and analyzing the information and the correct classification of monuments within an organized structure. Regarding the current list of monuments of culture, the number of these objects now totals 1,892.

The Institute of Cultural Monuments continues its intensive work in the detection and studying of the values of buildings in the entire territory of Albania.

Despite the diametric alienation of Albanian reality, the well-articulated mission and defined purpose have not changed.

The newly launched program of "Education through Culture" has its own place in the education of topics related to monuments of culture. It is a positive challenge for us all to take care of the monuments, provide for both the dissemination of knowledge, and a clear and concise explanation of the necessity of why monuments should be protected, in order to shape the conscience of society.

Actuality already dictates not only the physical restoration of monuments, but also the explanation .... why we should undertake these steps. Responsibility for monuments is not limited to a narrow circle of specialists and staff, but expands to residents on these objects, their administration and to the whole society. We are all guardians of monuments.

Arta Dollani
General Director of ICM

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY



PASQYRA E LËNDËS

Personalitetet 23

Hasan Ceka 24
Skënder Anamali 26
Jovan Adami 28
Gani Strazimiri 30
Selim Islami 32
Viktori Puzanova 34
Theofan Popa 36
Koço Zheku 38
Akademikë e Profesorë në fushën e studimit dhe restaurimit të Monumenteve të Kulturës 40

Projektet 43

Porta e Luanit, Butrint 44
Monumenti i Agonotetëve 48
Fontana e Apollonisë, Nimfeu 52
Monumentet Antike, Lezhë 56
Kalaja e Rozafës, Shkodër 60
Kalaja e Gjirokastrës 64
Ura e Mesit, Shkodër 68
Ura e Vokopolës, Berat 70
Vendvarrimi i Skënderbeut, Lezhë 72
Kisha e Shën Marisë-Leusë, Përmet 78
Kisha e Shën Mari Vllahernës, Berat 84
Kisha e Marmiroit, Vlorë 88
Kisha e fjetjes së Shën Marisë-Zervat, Gjirokstër 92
Kisha e Shën Kollit-Perondi, Berat 98
Kisha e Shën Marisë-Kosinë, Përmet 102
Kisha e Shën Todrit, Berat 106
Xhamia e Beqarëve, Berat 108
Teqja e Sheh Dyrit, Tiranë 110
Banesa e Rexhep Karaj-Bulqizë, Peshkopi 112
Mulliri i Bajram Currit, Shoshan 114
Banesa e Xhemile Hasës, Peshkopi 116
Banesa e Kazafer Asllanit-Ostren i vogël, Dibër 118
Kompleksi i Markajve, Peshkopi 120
Kompleksi i Sali dhe Aqif Kadriut-Bellovë, Peshkopi 122

DO NOT COPY

TABLE OF CONTENTS

DO NOT COPY

Personalities 23

Hasan Ceka 24
Skënder Anamali 26
Jovan Adami 28
Gani Strazimiri 30
Selim Islami 32
Viktori Puzanova 34
Theofan Popa 36
Koço Zheku 38
Academics and Professors in the field of study and restoration of Cultural Monuments 40

Projects 43

The Lion's Gate, Butrint 44
Monument of Agonothetes, Apollonia 48
The Fountain of Apollonia, Nymphaeum 52
The Ancient Walls, Lezha 56
Rozafa Castle, Shkodra 60
The Castle of Gjirokastra 64
The Bridge of Mesi, Shkodra 68
Vokopola Bridge, Berat 70
The Burial Place of Scanderbeg, Lezha 72
The St. Mary's church-Leusa, Përmet 78
The St. Mary Church Vllaherna, Berat 84
The Marmiroi Church, Vlora 88
The Church of "The Dormition of St. Mary" in Zervat, Gjirokastra 92
The Church of St. Kollit-Perondi, Berat 98
The St. Mary's Church-Kosina, Përmet 102
The Church of St. Theodore, Berat 106
The Mosque of Celibates, Berat 108
The Tekke of Sheh Dyrit, Tirana 110
The house of Rexhep Karaj-Bulqiza, Peshkopi 112
The mill of Bajram Curri, Shoshan 114
The house of Xhemile Hasa, Peshkopi 116
The house of Kazafer Asllani, Ostren i vogël 118
The residential complex of Markajve, Peshkopi 120
The residential complex of Sali and Aqif Kadriu-Bellova, Peshkopi 122

Banesa e Lipe Kotes, Korçë 126
Banesa e Dhimitraq Treskës, Korçë 128
Banesa e Piktorit të popullit Vangjush Mio, Korçë 130
Pazari i Krujës 134
Muzeu Etnografik, Berat 138
Muzeu Etnografik, Elbasan 142
Banesa e Skëndulajve, Gjirokastër 144
Banesa e Zekatëve, Gjirokastër 148
Shëtitorja e Shkodrës 152

Restaurimi i objekteve të artit 157

Mozaikët e bazilikës paleokristiane të Linit, Pogradec 158
Mozaikët e bazilikës paleokristiane të Elbasanit, Elbasan 160
Mozaiku i Orfeut, Durrës 162
Shën Simoni, ikonë, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 164
Kryqëzimi, ikonë, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 166
Ngjitja në Qiell, ikonë, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 168
Mbledhja e Taksiarkëve të Mëdhenj, ikonë, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 170
Mandili i Shenjtë, ikonë, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 172
Shën Mëria me Krishtin, ikonë, Dhuvjan, Ikonat e fondit të Muzeut Historik Kombëtar 174
Pallati i Trikonkës, Butrint 176
Dhoma me maska, mozaikët, Butrint 178
Tavolina e Ndre Mjedës, Shkodër 180
Mozaikët e banesës romake në sektorin G të Apollonisë, Apolloni 182

Arkitektë të frymëzuar nga Trashëgimia Kulturore 185

Ark. Agron Jano 186
Ark. Aleko Papakozma 190
Ark. Arben Arapi 194
Ark. Arben Golemi 196
Ark. Maks Velo 198
Ark. Maksim Mitrojorgji 200
Ark. Pirro Stefa 204
Ark. Robert Kote 206

DO NOT COPY

The house of Lipe Kote, Korça 126
The house of Dhimitraq Treska, Korça 128
The house of the famous painter Vangjush Mio, Korça 130
The Bazaar of Kruja 134
The Ethnographic Museum, Berat 138
The Ethnographic Museum, Elbasan 142
The house of Skëndulaj, Gjirokastra 144
The house of Zekate, Gjirokastra 148
The Promenade of Shkodra 152

The restoration of Artworks 157

The mosaics of the Paleochristian basilica on the Cape of Lin, Pogradec 158
The mosaic floor of the Paleohristian basilica at Scampis, Elbasan 160
The mosaic of Orpheus, Durrës 162
St. Symeon, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 164
Crucifixion, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 166
Ascension, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 168
Synaxis of the Angels, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 170
Holy Mandylion, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 172
Virgin and Child, Icon from the storage environments of the Albanian National Museum 174
The Triconch Palace, Butrint 176
The mosaic floor in the east vestibule that led into the south gallery of the domus, Butrint 178
The table of Ndre Mjeda, Shkodër 180
Roman residence in sector G, Apollonia 182

Architects inspired by Cultural Heritage 185

Arch. Agron Jano 186
Arch. Aleko Papakozma 190
Arch. Arben Arapi 194
Arch. Arben Golemi 196
Arch. Maks Velo 198
Arch. Maksim Mitrojorgji 200
Arch. Pirro Stefa 204
Arch. Robert Kote 206

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY



PERSONALITETE
PERSONALITIES

Hasan Ceka (1900 - 1998)



Një nga themeluesit e arkeologjisë shqiptare, specialist për periudhën e antikitetit dhe në fushën e numizmatikës, profesor. Lindi në Elbasan, ku kreu shkollën e mesme. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Vjenës për arkeologji (1930). Po këtë vit u kthye në atdhe, ku punoi për krijimin e një koleksioni arkeologjik dhe përfaqësoi shtetin shqiptar pranë misioneve të huaja në Butrint e në Apoloni. Nga 1947 e derisa doli në pension (1974) zhvilloi veprimtari të gjerë kërkimore e studimore. Apolonia ishte qyteti ku gërmoi e studioi për 40 vjet. Autor i dhjetëra artikujve me tematikë të gjerë historike-arkeologjike, botuar edhe jashtë vendit. Si njohës i greqishtes së vjetër dhe latinishtes dha ndihmesë

One of the founders of Albanian archeology, was a specialist in the period of antiquity and a professor in at the field of numismatics. Born in Elbasan, where he finished secondary school studies, he studied at the University of Vienna, for archeology in 1930. That same year he returned to Albania, where he worked for the creation of an archaeological collection and represented the Albanian state at the foreign missions of Apollonia and Butrint. From 1947 until his retirement in 1974, he carried out extensive research and study. Apollonia was the city where he excavated and studied for 40 years. He was the author of dozens of articles on the wide historical-archaeological topic, many of which were also published abroad. As a connoisseur of the old Greek and Latin language he gave basic assistance in preparation for the publication of the

DO NOT COPY



Hasan Ceka dhe Prof. Bllavacki në gërmimet në Apolloni
Hasan Ceka and Prof. Bllavacki during the excavations in Apollonia



Hasan Ceka gjatë gërmimeve në Apolloni
Hasan Ceka during excavations in Apollonia

themelore në përgatitjen për botimi të vëllimit "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë". Kujdes të veçantë tregoi për krijimin e kabinetit numizmatik, i cili shërbeu për kurorëzimin e punës së tij studimore me botimin e veprës "Probleme të numizmatikës ilire" (1965), dhe "Në kërkim të historisë ilire" (1998).
(Burimi: Muzafer Korkuti, F.E.Sh.).

volume " Illyrians and Illyria of the ancient authors. He paid special attention to the creation of the cabinet of numismatics, which served as the coronation of his study work with the publication of the work "Issues on Illyrian numismatics " (1965), and "In Search of Illyrian history" (1998). (Source: Korkuti, A.E.D.)

DO NOT COPY



Gjatë gërmimeve në Apolloni
During excavations in Apollonia

Skënder Anamali (1921–1996)



Arkeolog, specialist i periudhës së antikitetit të vonë dhe i mesjetës së hershme, profesor. Lindi në Shkodër, ku kreu shkollën e mesme; ndoqi studimet e larta në Fakultetin e Letërsisë e të Filozofisë në Universitetin e Padovës (Itali). Më 1947 filloi punën si arkeolog në Institutin e Shkencave në Tiranë dhe bashkë me Hasan Cekën hapën muzeun e parë arkeologjik (1948). Ndërmori gërmime të pavarura në qytetin e Amanties, në Apoloni dhe në Durrës. Veprimtaria e tij u përqendrua në gjurmimin, zbulimin dhe studimin e kulturës së antikitetit të vonë e të mesjetës së hershme. Bëri gërmime sistematike në varrezën mesjetare të Krujës, të Komanit, Buklit, Shurdhahut, në bazilikën e Linit, në kalanë e Pogradecit, në kalanë e Stelushit, në bazilikën e Ballshit etj. Rezultatet shkencore të gërmimeve u pasqyruan në mbi 70 artikuj e studime të botuara edhe jashtë vendit, ku përcakton përbërësit e kulturës arbërore,

Archaeologist, specialist, professor of Late Antiquity period and of the early Middle Ages. Born in Shkodra, where he completed the high school studies. He pursued studies in the Faculty of Literature and Philosophy at the University of Padua (Italy). In 1947 he began working as an archaeologist at the Institute of Science in Tirana and together with H. Ceka they opened the first archaeological museum (1948). He undertook independent excavations in the city of Amantia, Apollonia and Durrës. His activities focused on tracing, detecting and studying the culture of Late Antiquity and the early Middle Ages. He made systematic excavations at the medieval cemetery of Kruja, that of Koman, Bukli, Shurdhah, in the Basilica of Lin, the castle of Pogradec, the castle of Stelushi, in the Basilica of Ballsh etc. The scientific excavation results were reflected in over 70 articles and studies, published also abroad, which define the elements of Arbëria culture, S.A. is the author of the monograph on the Illyrian city of Amantia. Editor of the volume "Corpus of Latin inscriptions in Albania", " Illyrians and Illyria of the ancient authors. "



Pranë monumentit të Agonotetëve, Apolloni
Near the monument of Agonothetes Apollonia



Gjatë ekspeditave në terren
During field expeditions

DO NOT COPY

procesin e lindjes e të zhvillimit autokton të bartësve të saj. S.A. është autor i monografisë për qytetin ilir të Amanties, bashkëredaktor i vëllimit "Korpusi i mbishkrimeve latine në Shqipëri", "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë" (1965), bashkautor i veprave "Historia e Shqipërisë" vëll. I (1959) dhe "Historia e popullit shqiptar" vëll. I (2002). S.A. ishte anëtar i "Shoqatës Ndërkombëtare për Epigrafi Greke dhe Latine" me seli në Paris. Dha ndihmesë në ngritjen e disa muzeve arkeologjikë. (Burimi: Muzafer Korkuti, F.E.Sh.)

(1965), co-author of the works "History of Albania" Vol. I (1959) and "History of the Albanian people" Vol. I (2002). S.A. He was a member of the "International Association for Greek and Latin epigraph" based in Paris. He gave assistance in setting up several archaeological museums (Source: Muzafer Korkuti, A.E.D.)

DO NOT COPY



Gjatë gërmimeve në Bazilikën e Linit, Pogradec
During the excavations at the Basilica of Lin, Pogradec

Jovan Adami (1892-1951)



Inxhinier ndërtimi, arkeolog. Lindi në fshatin Progër të Devollit. Shkollën e mesme dhe të lartën i kreu në Zalcburg (Austri), ku u diplomua më 1920. Po atë vit u kthye në atdhe. Punoi në ndërtime të ndryshme dhe më pas si inxhinier bashkie në Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe në Ministrinë e Ekonomisë. Të kësaj periudhe janë shumë punë projektuese e zbatuese të tij si: planimetria e parë e Shkodrës, rruga Peqin-Elbasan, Korçë-Vithkuq, Qafëthanë-Pogradec, disa rrugë rurale etj. Pas luftës vijoi punën në sektorin e ndërtimeve. Puna në terren për bonifikimet dhe ndërtimin e rrugëve, urave etj., në krahina të ndryshme të vendit i dha mundësi të njihej me shumë gjurma e rrënoja të lashtësisë dhe kështu iu kthye pasionit për arkeologjinë. Në fillim të vitit 1948 filloi punë në Institutin e Shkencave, në

Engineer, archaeologist. Born in the village Progri of Devoll. He completed the high school and university studies in Zalcburg (Austria), where he graduated in 1920. The same year he returned home. He was active in various construction works and later as municipal engineer in Vlora, Shkodra, Elbasan, Korça and the Ministry of Economy. Many projecting and implementing works belong to this period, such as: the first layout of Shkodra, Peqin-Elbasan road, Korça- Vithkuq road, Qafëthana-Pogradec road, some rural roads, etc. After the war he continued working in the construction sector. Fieldwork for land improvement and construction of roads, bridges, etc. in different regions of the country gave him the opportunity to recognize many traces of ancient ruins and so turned his passion for archeology. In early 1948 he started working at the Institute of Science, Department of Archaeology, where he gave a special contribution in the field of identification and study of roads and bridges to Albania from antiquity until



Rilevime monumentesh në terren
Surveys of monuments in the field

DO NOT COPY

degën e arkeologjisë, ku dha ndihmesë të veçantë në fushën e evidentimit e të studimit të rrugëve dhe urave të Shqipërisë nga antikiteti deri në mesjetën e vonë. Studimet e tij janë përmbledhur në librin " Rrugë dhe objekte arkeologjike në Shqipëri" (1983), botuar nën kujdesin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. (Burimi: Ilir Gjipali, F.E.Sh.)

the late Middle Ages. His studies are summarized in the book "Roads and archaeological sites in Albania" (1983), published under the auspices of the Institute of Cultural Monuments. (Source: Ilir Gjipali, A.E.D.)

DO NOT COPY



Rilevime monumentesh në terren
Surveys of monuments in the field

Gani Strazimiri (1915–1993)



Arkitekt, bashkëpunëtor i vjetër shkencor. Lindi në Maqellarë (Peshkopi). Kreu shkollën e mesme artistike në Tiranë, dega pikturë. Nisi studimet e larta për arkitekturë në Universitetin e Torinos (Itali), por i ndërpreu për shkak të pushtimit fashist, u kthye në atdhe në v. 1940 dhe mori pjesë në Luftën ANÇ. Në vitin 1945–1950 ndoqi studimet e larta për arkitekturë dhe u diplomua në Universitetin "Lomonosov" të Moskës. Në vitin 1950–1956 punoi si arkitekt në ndërmarrjen "Projekti", ku projektoi objekte shoqërore dhe pallate banimi në stilin neoklasik. Në vitin 1957–1965 qe përgjegjës i grupit të kulturës materiale, që u krijua me nismën e tij në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë. Prej vitit 1965 derisa doli në pension (1975) qe drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe kryeredaktor i revistës "Monumentet". Veprimtarinë kryesore e zhvilloi në fushën e vlerësimit dhe mbrojtjes së monumenteve historike e të kulturës. Ka

Architect, senior scientific fellow. Born in Maqellara (Peshkopi). He completed the High School of Arts in Tirana, painting branch. He began studies in architecture at the University of Turin (Italy), but stopped because of the fascist invasion, returned home in 1940, took part in the NL War. During 1945-1950 he pursued architecture studies and graduated from the University "Lomonosov" in Moscow. During the years 1950-1956 he worked as an architect in the enterprise "Project", where he designed social objects and apartment buildings in neoclassical style. During the years 1957-1965 he was the responsible head of the material culture grup, created by his own initiative in the Institute of History and Linguistics. From the year 1965 until his retirement (1975) he was the director of the Institute of Cultural Monuments and chief editor of the magazine "Monuments". His main activities covered the field of evaluation and protection of historical and cultural monuments. He studied the architecture of museum cities and the evolution of the Albanian vernacular architecture of the houses in the Middle Ages, before and after the Ottoman invasion, highlighting the original elements



Gjatë ekspeditave në terren
During field expeditions



Gjatë ekspeditave në terren
During field expeditions

DO NOT COPY

studiuar arkitekturën e qyteteve-muze si dhe evolucionin e banesës qytetare shqiptare gjatë Mesjetës para e pas pushtimit osman, duke nxjerrë në pah elementet origjinale kombëtare të arkitekturës së tyre. Si drejtues shkencor dhe administrativ i IMK zbatoi kritere bashkëkohore për identifikimin, vënien në mbrojtje, restaurimin e propagandimin e veprave të spikatura të traditës shqiptare të ndërtimeve. Falë punës së tij u arrit që në v. 1961 të viheshin në mbrojtje në cilësinë e qyteteve-muze, qendra historike e Beratit dhe e Gjirokastrës, si dhe IMK të vihej në lidhje me institutet analoge e me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së monumenteve të kulturës. Nën drejtimin e tij IMK u bë qendër e vlerësimit të monumenteve shqiptare. Ka qenë pedagog i historisë së arkitekturës në UT. Instituti i Monumenteve të Kulturës në Tiranë mban emrin e tij. Është dekoruar me Urdhrin "Mjeshtër i Madh". (Burimi: Emin Riza, F.E.Sh.)

of the national architecture. As scientific leader and administrative director of ICM, he applied contemporary criteria for the identification, protection implementation, restoration and propagation of prominent works of the Albanian construction tradition. Thanks to his work, in 1961, the historical centers of Berat and Gjirokastra were put under protection in the quality of museum cities and ICM could also be associated with analog institutes of international organizations operating in the field of protection of monuments of culture. Under his direction, ICM became the center of the assessment of the Albanian cultural monuments. He was professor of history of architecture at University of Tirana.
The Institute of Cultural Monuments in Tirana bears his name. He is awarded the title "Mjeshtër i Madh".
(Source: Emin Riza, A.E.D.)

DO NOT COPY



Gani Strazimiri me kolektivin e Institutit të Monumenteve të Kultures
Gani Strazimiri with the employees of ICM

Selim Islami (1923–2001)



Arkeolog, një ndër themeluesit e arkeologjisë shqiptare, profesor. Lindi në Pandelejmon të Sarandës. Kreu shkollën Normale të Elbasanit dhe studimet e larta në Universitetin "Lomonosov" të Moskës (1946–1951). Filloi punën në Institutin e Shkencave, më pas në Institutin e Historisë, në Institutin e Arkeologjisë, ku punoi deri në fund të jetës. Në v. 1956–1966 qe përgjegjës i sektorit të arkeologjisë në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë. Drejtoi punimet në tumat e Matit (1952–1956) e më pas në qendra të tjera si: Gajtan, Pazhok, Xibër, Zgërdhesh, Butrint etj. Në v. 1958–1960 drejtoi kërkimet e ekspeditës arkeologjike shqiptaro-sovjetike në Apoloni. Është autor i një vargu artikujsh shkencorë; bashkautor i veprave "Historia e Shqipërisë" vëll. I (1959) dhe "Historia e popullit shqiptar" vëll. I (2002); redaktor përgjegjës i përmbledhësit "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë" dhe i librit "Les Illyriens" (Tiranë, 1985). Në v. 1981–1985

Archaeologist, one of the founders of Albanian archeology, professor. Born in Pandelejmon, Saranda. He completed the Normal school in Elbasan and the university studies at "Lomonosov" University in Moscow (1946-1951). He started working at the Institute of Science, then at the Institute of History under the Institute of Archaeology, where he worked until the end of life. During the years 1956-1966 he was head of the sector of archeology at the Institute of History and Linguistics. He directed the excavation works at the Tombs of Mat (1952-1956) as well as in other centers such as Gajtan, Pazhok, Xibër, Zgërdhesh, Butrint, etc. During the years 1958-1960 he directed the archaeological Soviet - Albanian research expedition in Apollonia. He is the author of a series of scientific articles; co-author of the works "The History of Albania" Vol. I (1959) and "History of the Albanian people" Vol. I (2002); Chief - Editor of compilation " Illyrians and Illyria of the ancient authors ", the book "Les Illyriens" (Tirana, 1985). During the years 1981-1985 he was the editor of "Illyria" magazine. Besides the research studies on the Illyrian town, the basic object of his studies



Me kolegët arkeologë ne Çukën e Ajtoit
With the colleagues of archaeology in Çuka e Ajtoit



Gjatë zbulimeve arkeologjike
During archaeological excavations

DO NOT COPY

qe kryeredaktor i revistës "Iliria". Krahas kërkimeve e studimeve për qytetin ilir, objekt themelor i studimeve të tij ishte historia politike e shtetit ilir. Si pedagog i jashtëm ka dhënë lëndën e arkeologjisë dhe të historisë së lashtë në UT. Me veprimtarinë shkencore e drejtuese dha ndihmesë të veçantë për ndriçimin e problemeve themelore të arkeologjisë e historisë antike të vendit tonë. (Burimi: Muzafer Korkuti, F.E.Sh.)

was the political history of the Illyrian state. As external examiner he taught the subject of archeology and ancient history at University of Tirana. Through his scientific and management activity he gave special contribution to lightening the fundamental problems of archeology and ancient history of our country. (Source: Muzafer Korkuti, A.E.D.)

DO NOT COPY



Gjatë gërmimeve në Apolloni
During the excavations in Apollonia

Viktori Puzanova (1893–1967)



Studiuese e artit mesjetar shqiptar, me kombësi ruse. Lindi në qytetin Rostov-mbi-Don. Studioi për art në Sant-Peterburg, ku jetoi deri v. 1917. Në v. 1941 u vendos në Shqipëri. Është ndër themelueset e sektorit të artit mesjetar në Institutin e Shkencave; më pas pedagoge në Universitetin e Tiranës (1957–1967). Ka botuar studimet: "Piktori shqiptar i shekullit të XVI Onufri nga Neokastra (Elbasan)" (1953), "Mbi punimet e piktorit Nikolla në kishën Shën Mëri Vllaherna" (1957), "Shënime mbi artin shqiptar të shekullit të XVIII" (1957); "Prapë mbi artin shqiptar të shekullit të XVIII" (1958); "Manastiri "Shën Mëria e Apolonisë" në Pojan" (1961); "Paraqitje të skenës së lindjes së Krishtit në pikturën mesjetare të Shqipërisë" (bashkautore, 1966); "Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë

Researcher of Albanian medieval art, with Russian nationality. Born in the city of Rostov-on-Don. She studied art in St. Petersburg, where she lived until 1917. In 1941 she settled in Albania. She is one of the founders of medieval art Sector at the Institute of Science; then a professor at the University of Tirana (1957-1967). She has published the following studies: " Onufri, The albanian painter of the XVI-th century, from Neokastra (Elbasan)" (1953), "Works of the painter Nikola in the church Shën Mëri Vllaherna" (1957), "Notes on Albanian art of the eighteenth century" (1957) ; "Again, on the Albanian art of the eighteenth century" (1958); "Monastery " Madonna of Apollonia" in Pojan" (1961); "Introduction of the nativity scene of Christ in the medieval painting of Albania" (co-author, 1966); "Some features of monumental painting in Albania during XIII-XIV centuries" (1967). V. P. has realized 32 fragments or fresco frames which are preserved now in the Museum of Medieval Art in Korca; The National Gallery of Art in



Gjatë ekspeditës Shqiptaro-Sovjetike, 1958
During the Albanian-Soviet expedition, 1958

DO NOT COPY

shekujve XIII–XIV" (1967). V.P. ka realizuar 32 kopje fragmentesh ose kuadro freskash, që ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë; në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë ruhen pesë vepra origjinale të saj. (Burimi: Maks Velo, F.E.Sh. Dhorka Dhamo, F.E.Sh.)

Tirana preserves five original works of hers. (Source: Maks Velo, A.E.D.)

DO NOT COPY



Gjatë ekspeditave në terren
During field expeditions

Theofan Popa (1913–1985)



Epigrafist, studiues i artit mesjetar. Lindi në Elbasan. Studioi në seminarin teologjik në Manastir (1926–1936) dhe më pas ndoqi dy vjet studimet e larta në Athinë po në degën teologjike. Është autor i shumë artikujve studimorë për monumente kulturore mesjetare e sidomos për piktorët Onufri, K. Shpataraku etj. Ka botuar librat: "Piktorët mesjetarë shqiptarë" (1961), "Ikona dhe miniatura mesjetare" (1974), të pajisura me ilustrimet e nevojshme dhe tekst të ngjeshur, me vlera të rëndësishme kërkimore shkencore. Vepra kryesore e tij "Mbishkrime të kishave në Shqipëri" (1998) ka rëndësi dokumentare të shumëfishtë dhe përbën sintezën e veprimtarisë së tij të disa dekadave në gjetjen, grumbullimin, përpunimin dhe sistemimin e mbishkrimeve kishtare të Shqipërisë.
Në v. 2006 u botua dhe vepra tjetër e tij "Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, shek. VI–XIV".(Burimi: Dhorka Dhamo, F.E.Sh.)

Epigraphist, scholar of medieval art. Born in Elbasan. Studied at the theological seminary in Manastir (1926-1936) and two years later followed studies in Athens, theological branch. He is the author of many scholarly articles on medieval cultural monuments, especially for painters Onufri, K. Shpataraku etc. He has published the books: "Albanian medieval painters" (1961), "Icons and medieval miniatures" (1974), equipped with the necessary illustrations and concise text, with a significant scientific research. His main work "Church Inscriptions in Albania" (1998) has a multiple documentary manner and represents the synthesis of several decades of his activity on finding, collecting, processing and systematization of Albanian Church inscriptions. In 2006 was published his other work "Miniatura and medieval paintings in Albania, c. VI-XIV ".
(Source: Dhorka Dhamo, A.E.D.)





Theofan Popa gjatë ekspeditave në terren
Theofan Popa during field expeditions

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Theofan Popa gjatë ekspeditave në terren

Theofan Popa during field expeditions

Koço Zheku (1922-2012)



Studiuesi dhe restauratori i shquar i monumenteve të kulturës është një shembull i qartë i përkushtimit dhe vlerësimit të monumenteve, si tregues të prekshëm të historisë mijëravjeçare të etnosit tonë iliro-arbëresho-shqiptar. Ai është një nga personalitetet më të vjetra dhe më me përvojë në lëmin e studimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ku me aktivitetin e tij profesional mbuloi disa disiplina gjurmuese dhe studiuese: të etnografisë, arkeologjisë dhe restaurimit. Koço Zheku ka dhe një aktivitet shumë të pasur botues sidomos në fushën e studimeve etnografike. Me shumë interes janë studimet e tij për banesat fshatare të Mulletit, Linxës, Pojanit, Krujës, Tomoricës etj. Në fushën e arkeologjisë me vlerë janë studimet për guroret antike, për ndërtimet e fortifikuara, monografia për qytetin antik të Lisusit etj. Por të jashtëzakonshme dhe të pakrahasueshme janë restaurimet që na ka lënë për monumentet antike: muret rrethuese dhe Porta e Luanit në Butrint, Monumenti i Agonotetëve dhe Fontana në Apolloni, muret e fortifikimit antik të Lezhës etj. Ato

Prominent researcher and restorator of monuments of culture, a clear example of dedication and appreciation of monuments, as tactile indicator of thousands of years of history of our Illyrian- Arbëresh -Albanian ethnos. He is one of the oldest and most experienced personalities in the field of study and protection of cultural heritage, where, with his professional activity he covered investigative disciplines and research, ethnography, archeology and restoration. Koco Zheku has a very rich publishing activity, especially in the field of ethnographic studies. Of great interest are his studies of rural dwellings of Mullet, Linxë, Pojan, Kruja, Tomorrica etc. In the field of archeology are worth his studies on ancient stone quarries, on fortified constructions, monography on the antic city of Lissus, etc. But, quite extraordinary and incomparable are the restorations of ancient monuments he has left us to: the surrounding walls and the Lion Gate in Butrint, Monument of Agonothets and Fontana in Apollonia, the ancient fortification walls in Lezha etc. They already have become symbols of the relevant archaeological sites with radiation and public recognition from a very vast domestic and foreign public. Koco Zheku is the first Albanian who admired, documented and published the works of medieval painters, brothers Constantine and Athanasios



Gjatë zbulimeve arkeologjike
During archaeological finds

DO NOT COPY

tashmë janë bërë simbolet e qendrave arkeologjike përkatëse me një rrezatim dhe njohje nga një publik shumë i gjerë vendas dhe i huaj. Koço Zheku është i pari shqiptar që admiroi, dokumentoi dhe publikoi veprat e piktorëve mesjetarë, të vëllezërve korçarë Kostandin e Athanas Zografi në manastiret e Malit të Shenjtë, në manastirin e Filotheut, të Ksiropotamit, të skitit të Shën Anës etj. Monografia mbi piktorët korçarë në Malin e Shenjtë është një tjetër vepër e rëndësishme dhe e ilustruar që i shtohet literaturës shqiptare të historisë së artit. Koço Zheku ka dhënë ndihmesën sa parësore, aq edhe të rëndësishme edhe në fushën e gjurmimit dhe studimit të banesës popullore. Ai u përkushtua kryesisht në banesën fshatare në Shqipërinë Qendrore dhe atë Jugore. Veprimtaria e tij e gjerë dhe njëherazi në përputhje me kriteret studimore-restauruese është bashkëshoqëruar me veprimtarinë botuese. Së pari me botime artikujsh në revista shkencore si dhe në botime të veçanta monografike, ku po veçojmë: "Lisi në shekuj", (1988), "Kostandin dhe Athanas Zografi" (2002), "Monumente të restauruar në Apoloni" (2005), "Bylisi dhe Gllavinica" (2007), "Tirana në rrjedhën e shekujve" (2007) etj.

Zografi from Korça in the monasteries of the Holy Mountain, in the monastery Philotheus, Ksiropotami, of the skiti of St. Anna etc. Monograph of Korça's painters in the Holy Mountain is another important and illustrated work added to Albanian literature of art history. Koço Zheku has given his prior and important contribution in the field of research and study of traditional dwellings. He committed himelf mainly in rural dwelling of Central and Southern Albania. His wide activity, at the same time in accordance with restoration study criteria is accompanied with publishing activity, too. Firstly with publications of articles in scientific journals as well as in special monographic editions, where we highlight: "Lissus forever" (1988), "Constantine and Athanasios Zografi" (2002), "Monuments restored in Apollonia" (2005) "Byllis and Gllavinica" (2007), "Tirana in the course of centuries" (2007), etc.

DO NOT COPY



Koço Zheku jatë anastilozes të monumentit të Agonotetëve, Apolloni
Koço Zheku during anastilosa of the Agonothetes monument, Apollonia

AKADEMIKË E PROFESORË NË FUSHËN E STUDIMIT DHE RESTAURIMIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

ACADEMICS AND PROFESSORS IN THE FIELD OF STUDY AND RESTORATION OF CULTURAL MONUMENTS

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

Emin RIZA

Aleksandër MEKSI

Pirro THOMO

Hasan NALLBANI

Apollon BAÇE

Gjerak KARAISKAJ

Ali MUKA

Valter SHTYLLA

Lorenc BEJKO

DO NOT COPY

DO NOT COPY

50 VJET IMK

PROJEKTE *PROJECTS*

DO NOT COPY



PORTA E LUANIT

Porta e Luanit, Butrint, e zbuluar gjatë gërmimeve të viteve 1928-1935 nga misioni italian i drejtuar nga L. M. Ugolini ndodhet në anën verilindore, në afërsi të bregut të liqenit të Butrintit dhe i ka shërbyer qytetit të Butrintit qysh nga shek. IV p. Kr. Përmasat madhështore i japin një pamje monumentale kësaj porte.

Nga porta origjinale ruhen në gjendjen fillestare korridori dhe gjithë fasada e pamjes së brendshme të saj, pasi pamja kryesore ka pësuar ndërhyrje transformuese në periudha të mëvonshme. Pjesa e sipërme e fasadës së rindërtuar u gjet në gjendje të rrënuar.

Për ruajtjen e këtij monumenti në gjendjen siç doli nga gërmimet arkeologjike u morrën masa provizore, duke përforcuar gurët e tavanit të korridorit me një konstruksion mbajtës me shtylla druri. Më tej u vendos të studiohej mundësia e restaurimit të saj, meqënëse për vlerën historike dhe arkeologjike që mbart, ajo zë një vend të rëndësishëm në radhën e monumenteve që ruhen akoma në qytetin e lashtë të Butrintit. U bë një studim i hollësishëm i gjendjes në të cilën paraqitej konstruksioni i portës dhe i elementeve arkitektonike që ishin shtuar nga ndërhyrjet e fazave të mëvonshme. Si rezultat i këtij studimi u arrit në përfundimin që ndërhyrja në këtë monument të kufizohej në rivendosjen e elementeve konstruktive dhe arkitektonike të dëmtuara, dhe në rindërtimin e pjesës së sipërme të murit të fasadës, i cili

THE LION'S GATE

The Lion's Gate in Butrint was discovered in excavations during the years of 1928 to 1935 by the Italian mission led by L.M Ugolini. Located on the northeast side, near the shore of Butrint Lake, the Lion's Gate has stood proudly in Butrint city since the 4th Century BC. Its magnificent proportions give it a monumental appearance.

The original gate is preserved in its original conditions, the corridor and the interior elevation, because the main elevation has suffered major transformations and interventions in subsequent periods. The upper part of the rebuilt facade was found in a dilapidated condition.

Provisional interventions were taken for the preservation of this monument in the state that it was found during archaeological excavations, by reinforcing the stones of the ceiling of the corridor with a structural system of wooden pillars.

The decision was made to make it possible to restore it, because of the great archaeological and historical values it carries, as it plays an important role in the long line of monuments that are still preserved in the ancient city of Butrint.

A detailed study was made of the structural situation of the gate and of all the architectural elements that were added by the subsequent interventions in different phases. As a result of this study it was concluded that the intervention for this monument would be limited to the restoration of



Planimetria e Portës së Luanit
The plan of the Lion's Gate



Pamja kryesore (gjendja ekzistuese)
The main elevation (the existing situation)

DO NOT COPY

u gjet i rrëzuar. Pjesa që ruhet nga rindërtimi i fasadës së hyrjes, kryer në kohën antike, do të lihej në gjendjen që doli nga gërmimet, kurse muri i kullës mesjetare, pjesa që mbështetej mbi tavanin e portës, meqënëse duhej të prishej detyrimisht gjatë punimeve të restaurimit, nuk u gjet me vend që të ringrihej.

Në fazën e parë të punimeve u gërmuan shtresat e dheut të depozituara në pjesën e sipërme të mbulesës së portës dhe në sipërfaqen e korridorit, duke rënë në gjurmët e murit antik, i cili ishte në gjendje tejet të dëmtuar. Në përputhje me detyrën kryesore, që qe ruajtja dhe rivendosja në vend e të gjithë materialit dhe elementeve origjinale, punimet e fazës së dytë filluan së pari me ngjitjen e blloqeve të thyera, si dhe me përgatitjen e atyre elementeve që qenë shumë të dëmtuara ose mungonin. Mbas përfundimit të përgatitjes së elementëve vijuan punimet e rindërtimit, duke vendosur fillimisht ancakët ekzistues dhe ato që u ribënë. Më tej, u vendos arkitrau i fasadës dhe me radhë blloqet e gjata të tavanit, deri tek arkitrau kryesor. Në vijin vazhdoi rindërtimi i pjesës së murit në fasadën kryesore dhe rivendosja e gurëve të fasadës së brendshme. Si rezultat i punimeve restauruese të realizuara, u arrit mënjanimi i dëmtimit të mëtejshëm dhe rrezikshmëria e shëmbjes së monumentit.

structural and architectural elements that were damaged and the reconstruction of the upper wall of the facade that had gradually collapsed.

The portion that was preserved by the reconstruction of the facade on the entrance, that was originally constructed in ancient times, would be left in the state that was evident at the time of the excavation, however it was decided that the wall of the medieval tower, the part that rested over the roof of the gate, since it had to be demolished during the restoration intervention, it was determined that it would not be rebuilt.

DO NOT COPY



Pamja e brendshme (gjendja ekzistuese)
The interior elevation (the existing situation)



Foto e gjendjes ekzistuese dhe gjatë punimeve të restaurimit
Photo of the existing situation and during restoration work







Pamje, prerje, detaj i strukturës (projekt i restaurimit)

Elevatiom, section, structural detail (the restoration project)





Pamje nga sipër e portës (gjendja ekzistuese)

The view from above the gate (the existing situation)





Foto të gjendjes ekzistuese dhe gjatë punimeve të restaurimit

Photo of the existing situation and during restoration work



Prerja tërthore (projekti i restaurimit)

The cross section (the restoration project)

DO NOT COPY



DO NOT COPY



Pamja kryesore (projekti i restaurimit)
The main elevation (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Koço Zheku. Rilevoi: Koço Zheku. Punimet u kryen nga: Ateljeja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1962.

Bibliografi: Zheku, K., "Restaurimi i Portës së Luanit, Butrint", Monumentet, 1971, 1.

MONUMENTI I AGONOTETËVE

Në vitin 1930, në qytetin antik të Apollonisë u zbulua një ndërtesë publike nga arkeologu Leon Rei, e cila bënte pjesë në kompleksin e gjerë arkitektonik, ndërtuar rreth shekujve të parë të erës sonë, ku përfshiheshin ndërtimet më të rëndësishme të qytetit të Apolonisë dhe që u quajt "Monumenti i Agonotetëve". Është ndërtesë që i përket shek.II e.s në qendër të Apollonisë dhe ka qenë selia e Këshillit të qytetit. Sipas mbishkrimit kushtues, u ngrit prej pretorit, Agonotetit (drejtues i ceremonive dhe i garave) dhe kryepriftit të Apollonisë, në kujtim të të vëllait. Ai përfaqësonte një monument përkujtimor dhe shërbente njëkohësisht për mbledhje dhe aktivitete administrative e shoqërore.

Gjatë ekspeditave në terren, monumenti u gjet i rrënuar. U bë i mundur rikonstruksioni grafik i pjesshëm i monumentit me anë të studimit të hollësishëm të të gjitha pjesëve të gjetura dhe të dokumentuara në vend. Faza e parë e punimeve, e kryer në vitin 1970, u përqendrua vetëm në materialin e rrëzuar të pamjes kryesore dhe në përfundim të kësaj faze u dokumentua e plotë gjendja e tij, duke dalë në përfundimin se pjesa më e madhe e gjetjeve i përkisnin frontonit kryesor. Kjo fazë vijoi me mbështetjen provizore në tokë të blloqeve të gurëve sipas radhës duke arritur ringritjen e frontonit.

Në fazën e dytë, projekti i restaurimit parashikonte rishtyllëzimin e pamjes kryesore të monumentit nëpërmjet

MONUMENT OF AGONOTHETES

In 1930, in the ancient city of Apollonia, a public building was discovered by the archaeologist Leon Rey. The building was part of a wide architectural complex, built around the early centuries of our era, which included the most important buildings of the city of Apollonia and was called " The monument of Agonotetëve". It represented a memorial monument and served simultaneously for meetings and administrative social activities.

During the field expeditions (surveys), the monument was found ruined. A partial graphic reconstruction of the monument was made possible through a detailed study of all the parts found and documented in place (in situ). The first phase of work, carried out in 1970, focused only on the scattered materials of the main facade that had fallen down. At the end of this phase, a complete documentation was made of the actual conditions of the monument, making it possible to come to the conclusion that most of the materials found belonged to the front elevation. This phase continued with the temporary layout of the stone blocks in the ground making it possible to restore (rebuild) the front elevation of the monument.

In the second phase, the restoration project aimed at restoring the colonnade of the monument through the anastylosis and consolidating the walls of the perimeter of the building. This work was carried out in the years 1974-1978 and was divided into several stages. The work





Monumenti i Agonotetëve (gjendja ekzistuese)

The Monument of the Agonothetes. Plan (the existing situation)

DO NOT COPY

metodës së anastilozës dhe konsolidimin e mureve perimetrale të ndërtesës. Këto punime u kryen në vitet 1974-1978 të ndara në disa etapa. Punimet në etapën e parë ringritën bazamentin mbështetës të kolonave në pjesën që ishte prishur. Në vazhdim punimet u përqendruan në ringritjen e mureve me blloqe në të dy qoshet ekstreme të pamjes kryesore dhe konsolidimin e mureve perimetrale. Në vazhdim, punimet e kryera në vitin 1976, kishin si synim rishtyllëzimin e fasadës kryesore. Punimet filluan me vendosjen e arkitraut të kolonadës dhe më tej me rindërtimin e frontonit të tempullit që ruante shumicën e elementëve origjinale. Me përfundimin e punimeve restauruese që u kryen dolën në pah vlerat e vërteta të këtij monumenti dhe sot është një dëshmitar i vërtetë i vlerave të shquara të qytetit të Apollonisë.

in the first phase was to restore the supporting basement of the columns in the parts where it was broken. The work that followed focused on restoring the walls with blocks on the two extreme corners of the main elevation and consolidating the perimeter walls. In addition, the work performed in 1976, aimed at reconstructing the colonnade of the main facade. The work began with placing the (architrave) lintel of the colonnade, continuing with the rebuilding of the frontal temple, which had most of the original elements preserved. The completion of restoration interventions revealed the true values of the monument and today this monument is a true witness of the outstanding values of the city of Apollonia.

DO NOT COPY





Riformulimi, detaj i fasadës
Elevation detail



Planimetria e përgjithshme
General plan



Frontoni i Monumentit të Agonotetëve

Pediment of the Monument of Agonothetes



Fotomontazh i rindërtimit të Monumentit të Agonotetëve

The photomontage of the reconstruction of the Monument of Agonothetes



Pamja kryesore (projekti i restaurimit)

Main elevation (project of restoration)



Planimetria e Monumentit

Plan of the Monument of Agonothetes



Pamje gjatë procesit të rindërtimit të kolonadës qendrore

View of the central colonnade during the reconstruction process

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Koço Zheku. Rilevoi, Koço Zheku. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e Koço Zhekut, 1970, 1974-1978.

Bibliografi: Zheku, K., "Monumenti i Agonotetëve, Rikonstruksioni i pamjes kryesore", Monumentet, 1972, 4.
Zheku, K., "Rishtyllëzimi i pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve në Apoloni", Monumentet, 1979, 18.

FONTANA E APOLLONISË, NIMFEU

Punimet sistematike të gërmimit në Apolloni, nga viti 1963 e deri në vitin 1968, nën drejtimin e Hasan Cekës, nxorrën në dritë "Fontanën e Apolonisë". Fazat e para të gërmimit të monumentit zbuluan një fontanë monumentale, një rezevuar uji të pijshëm me një zgjidhje arkitektonike të një çezme monumentale, e cila furnizohej me ujë nga disa burime të vogla që buronin në pllajën e kodrës.

Fontana e Apolonisë është një kompleks arkitektural me shumë interes si nga ana konstruktive ashtu dhe arkitektonike. Vendin kryesor e zë korpusi qendror ku janë vendosur rezervuarët e ujit. Një zgjidhje monumentale është arritur në këtë monument me vendosjen në fasadën e korpusit kryesor të një kolonade të përbërë nga pesë shtylla të stilit dorik të ngritur mbi një stilobat të shkallëzuar.

Ky monument u gjet i dëmtuar dhe pjesërisht i rrëzuar nga një tërmet i fuqishëm. Përveç rrëzimeve e dëmtimeve, janë shkaktuar dhe cedime e rrëshqitje të terrenit të kodrës. Gërmimet arkeologjike u shoqëruan dhe me punime me karakter konservimi dhe restaurimi. Punimet restaururese kanë patur si qëllim kryesor rikompozimin arkitektonik dhe ndalimin e dëmtimit të mëtejshëm të monumentit.

Fillimisht u bë një studim i hollësishëm i gjendjes në të cilën u zbulua ky monument, më pas u plotësua dokumentacioni

THE FOUNTAIN OF APOLLONIA, NYMPHAEUM

The systematic excavation works in Apollonia, from 1963 until 1968, under the direction of H. Ceka, brought to light "The Fountain of Apollonia". The early stages of the excavations of the monument discovered (unearthed) a monumental fountain, a potable (drinkable) water reservoir with an architectural solution of a monumental fountain, which supplied water from the small springs arising from the hill.

The Fountain of Apollonia is an architectural complex of great interest for both its structural and architectural characteristics. The central block is where the water reservoirs are situated. The monumental character was realized by placing five Doric columns above an indented stylobate, in the main facade of the central block.

This monument was found to be very damaged and had been partially destroyed by a powerful earthquake. In addition to the collapses and damage to the monument itself, it also suffered some cessions and slidings of the surrounding hill terrain. The archaeological excavations were associated with conservation and restoration interventions. The goals of the restoration were the architectural recomposition and cessation of any further deterioration of the monument.



Gjendja ekzistuese
The existing situation



Faza e I-rë (çlirimi nga dherat)
Fontana (after the release from earth, Phase I)

DO NOT COPY

grafik dhe fotografik i gjithë elementeve konstruktive dhe arkitektonike të zbuluara, mbi bazën e të cilave u hartua projekti i restaurimit. Punimet restauruese u përqendruan kryesisht në korpusin kryesor për konsolidimin dhe pjesërisht rishtyllëzimin e elementeve arkitektonike. Fillimisht u rindëruan shkallët e fasadës, më tej u ringritën në vendin e tyre trupat e kolonave, pilastrave dhe gurët e parapetit të basenit kryesor. Për të arritur qendrueshmërinë statike u ripërgatitën gjithë elementet lidhëse prej hekuri, për zëvendësimin e lidhësave origjinale të gjetur të thyer apo të oksiduar. Me përfundimin e punimeve të restaurimit u përfitua një ringjallërim i unitetit arkitektonik dhe në këtë mënyrë u arrit që ky monument i rëndësishëm të na paraqitet sërish me pamjen e tij origjinale.

A detailed study of the situation in which this monument was found preceeded the graphic and photographic documentation of all the structural and architectural elements that were found. The project of restoration was compiled based on all these studies and surveys. The restoration interventions were focused on the consolidation of the main corpus and the restoration of architectural elements.

Initially the staircase of the facade was rebuilt. Then the columns and pilasters and the stones of the parapet of the main reservoir were restored to their proper place.

In order to achieve the static stability, all of the metallic elements were remade, and all of the broken and oxidized elements were replaced. After the restoration interventions of this monument we now have the monument again in its original condition.

DO NOT COPY



Gjendja ekzistuese
The existing situation



Gjendja ekzistuese
The existing situation



Fontana (pas çlirimit nga dherat, faza e I-rë)
Fontana (after the release from earth, Phase I)



Pamja kryesore e Nimfeut (projekti i restaurimit)
The main view of Nymphaeum (the restoration project)



Nimfeu (mbas fazës së II-të të ndërhyrjes), muri jugor (gjendja ekzistuese, pas restaurimit)
The Nymphaeum (Phase II after the intervention). The Nymphaeum. The southern wall (the existing situation, after restoration)



Aksonometri e Nimfeut (projekti i restaurimit)
Axonometric view of the Nymphaeum (the restoration project)

DO NOT COPY



DO NOT COPY



Nimfeu, pamje gjatë punimeve
The Nymphaeum, views during the interventions



Nimfeu, pamje pas restaurimit
The Nymphaeum, the view after restoration

Projekti i restaurimit: Koço Zheku. Rilevoi: Koço Zheku. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1968.

Bibliografi: Zheku, K., "Punimet e restaurimit në Fontanën e Apolonisë", Monumente të kulturës në Shqipëri, Tiranë, 1975.

MURET ANTIKE

Gjatë ekspeditave arkeologjike (1968-1969) u ndërmorën gërmime sistematike në këtë truall të lashtë me histori shumëshekullore dhe u bë një përcaktim i hollësishëm topografik i zonës së qytetit antik. Si rrjedhim, arritën të fiksohen qartë disa mbeturina muresh rrethuese.

Në sistemin e fortifikimit të Lisit antik, tërheqin vëmendjen hyrjet e shumta, deri më sot janë fiksuar 10 të tilla, nga të cilat 8 janë të jashtme dhe 2 janë të brendshme. Ato paraqesin tipet më të thjeshta të hyrjeve të njohura në fortifikimet iliro-epiriote. Përmasat e portave variojnë nga 1,60 m deri në 4,10 m. Ndër to, Porta e Brendshme paraqitet me zgjidhje planimetrike me variant më të zhvilluar. Muret antike të Lisit janë ndërtuar me gurë të nxjerrë nga gurore të hapura brenda territorit të banimit, nga formacione gëlqerore, ndërsa për vendosjen e tyre në vend dhe pozicionimin e gurëve janë përdorur dy mënyra: copëtimi dhe prerja e shtresave. Muret mbrojtëse janë të vendosur mbi tokë të fortë ose direkt mbi shtresa shkëmbore. Themeli i këtyre mureve është i përbërë nga

THE ANCIENT WALLS

During the archaeological excavations of 1968 to 1969) systematic excavations on this site with ancient history were made which resulted in a very detailed topographical survey of the area of the ancient city. Consequently, they clearly discovered some remnants of surrounding walls. In the system of the fortification of the ancient Lis, what attracts one's attention are the numerous entries. Currently 10 have been found, 8 of which are exterior gates and 2 are internal ones.

They represent the simplest type of the entries known in Epirus Illyrian fortifications. Dimensions of doors range from 1.60 m to 4.10 m. Among them, the Interior Gate represents the most developed plan type .

The ancient walls of Lis were built with stones extracted from the quarries excavated within the residential territory, from limestone formations. The methods of putting them in place and the positioning of the stones were done in two ways: by fragmentation and cutting the layers. The Walls are built on either solid ground or



Porta e Madhe (planimetria)
The Great Gate (the general view)



Porta e Madhe (gjendja ekzistuese, pas restaurimit)
The Great Gate (the existing situation, after restoration)

DO NOT COPY

një rresht gurësh të zgjedhur me sipërfaqe mbështetëse të madhe. Në këtë structure evidentohen edhe gurët e vegjël, të përdorur në faqet e dukshme të mureve si mbushës të boshllëqeve, ndërmjet blloqeve në muret e tipit poligonal. Punime restauruese dhe konservuese janë kryer në të gjitha portat e qytetit antik. Porta e Brendshme e Lisit, në krahasim me portat e tjera, u gjet edhe më e dëmtuar. Pra, krahas gërmimeve arkeologjike, doli nevoja e hartimit të një projekti restaurimi për pjesët e ambienteve të zbuluara. Punimet e restaurimit kishin për qëllim rivendosjen e blloqeve të gurëve, elementeve konstruktive dhe arkitektonike të rrëzuara, si dhe konsolidimin e bazamentit. Gjatë këtyre punimeve u pat parasysh ruajtja e pacënuar dhe e qartë e gjurmëve të kohërave mijëvjeçare në të, duke i dhënë monumentit pamjen e tij origjinale, që ka pasur në një kohë të caktuar. Në përfundim të punimeve restaururese, muret dhe portat e qytetit antik të Lisit paraqiten në gjendje mjaft mirë të perceptueshme dhe me interes për studiuesit.

directly over the rocky layers .
The foundation of these walls is composed of a row of stones chosen for having a large supporting surface. It is worth mentioning that small stones are also used in the walls for filling the gaps between the blocks in the polygonal types of walls. The restoration and the conservation interventions were carried out in all the gates of the ancient city.
The interior gate of Lisi, compared to other gates, was the most damaged. So, in addition to archaeological excavations, there was an obvious need to draft a restoration project for the uncovered parts of the monument. The restoration intervention aimed at re-placing the blocks of stone, the fallen architectural and structural, as well as the consolidation of the foundation. The intervention also aimed at preserving the millennial traces in it, giving to the monument the look it had in ancient times. After the restoration, the walls and the gates of the ancient city of Lis are in very good shape and they attract the attention of researchers.



Porta e Brendshme (para dhe pas ndërhyrjes)
The Internal gate (before and after the intervention)



Porta e Brendshme (fragmente të mureve)
The Internal gate (fragments of walls)





Porta e Brendshme (gjendja ekzistuese, pas restaurimit)
The Internal gate (the existing situation, after restoration)

DO NOT COPY



Porta e Vogël (pamje, projekti i restaurimit)
The Minor Gate (view, the restoration project)





Porta e Vogël (planimetria, projekti i restaurimit)
The Minor Gate (the plan, the project of restoration)



Porta e Mesit (para dhe pas restaurimit)
The Middle Gate (the existing situation and after restoration)



Porta e Mesit (gjendja ekzistuese)
The Middle Gate (the existing situation)



Porta e Vogël (pas restaurimit)
The Minor Gate (after restoration)

DO NOT COPY





Porta Jug-Lindore (planimetri dhe pamje pas ndërhyrjes)
The East Gate (plan and view, the restoration project)



Projekti: Projekti i restaurimit: Koço Zheku. Rilevoi: Koço Zheku. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e Koço Zhekut, 1969-1970.

Bibliografi: Zheku, K., "Restaurimi i Portës së Brendshme në qytetin e Lisit", Monumentet, 1974, 7-8.
Zheku, K., "Teknika dhe materialet e ndërtimit në muret rrethues të qyteteve ilire të njohura në vendin tonë", Monumentet, 1980, 19.
Zheku, K., "Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike", Monumentet, 1971, 2.



Porta e Gaviarit (gjatë punimeve)
The Gaviari Gate (during the intervention)



Porta Juglindore (gjendja ekzistuese)
The East Gate (the existing situation)

DO NOT COPY

KALAJA E ROZAFËS

Kalaja e Shkodrës është ndërtuar mbi një kodër shkëmbore që rrethohet pjesërisht nga lumenjtë Buna dhe Drinasa. Pozicioni i saj strategjik ka kushtëzuar ekzistencën e një vendbanimi prehistorik mbi majën e kodrës. Është përdorur në fillim nga Ilirët e më pas, mbi të njëjtën bërthamë, u ndërtua kështjella, që vjen deri në ditët e sotme. Forma e sotme e kalasë i përket shek. XIV. Trajta e kalasë është pothuaj vezake, ndahet në tre oborre të rrethuara me mure të larta dhe me kulla mbrojtëse. Në pjesën më të lartë të kodrës ndodhet citadela, e cila ka qenë bërthama fillestare e qytetit mesjetar, ndërsa pjesa tjetër ndahet nga një mur tërthor në oborre të mëdhenj. Në citadelë dallohen tre faza ndërtimi që konsistojnë kryesisht në rritjen e trashësisë së mureve, gjë që dëshmon për kohën e gjatë të përdorimit të saj. Ndërtesat brenda kështjellës kanë qenë të shumta dhe lidheshin me njëra-tjetrën me anë të një rrjeti të dendur rrugicash, të cilat nuk u ruajtën pas pushtimit të saj në 1479 nga pushtuesit osmanë. Ndër to mund të përmendim godinat kryesore të qytetit, cisterna të shumta, banesa, kisha, kapitaneria etj.

Për herë të parë, punimet e restaurimit në kalanë e Shkodrës u kryen në vitet '70 dhe u përqendruan në hyrjen kryesore dhe në vendosjen e derës së jashtme të kësaj

ROZAFA CASTLE

The castle of Shkodra was built on a rocky hill surrounded partly by the Buna and Drinasa Rivers. It's strategic position, no doubt, contributed to the existence of a prehistoric settlement on the top of the hill. It was used in the beginning by the Illyrians, and then, on the same place, the castle was built. The castle we see today belongs to the 14th Century. Its shape is basically oval, and is divided into three courtyards that are surrounded by high walls and defensive towers. In the highest part of the hill is located the citadel, which used to be the initial core of the medieval city, while the rest is divided by a transverse wall in the large courtyards. On the citadel we notice three construction phases that consist mainly of the increased thickness of the walls, which testifies that it was used for a long time. The buildings within the castle are numerous and were connected to each other by a dense network of roads, which were not preserved after its conquest in 1479 by the Ottomans. Among them we can observe the major city's buildings, the numerous water tanks, houses, churches, etc. For the first time, in the fortress of Shkodra, restoration interventions were carried out in the 1970s and were focused on the main entrance and the placement of the front gate of this entrance. Because the castle had



Planimetria e kalasë së Shkodrës
The plan of the fortress of Shkodra



Oborri i III-të (gjendja ekzistuese)
The 3rd courtyard (the existing situation)

DO NOT COPY

hyrjeje. Mbas dëmtimeve që ajo kishte pësuar në periudha të ndryshme të historisë së saj, ishte e domosdoshme që punimet e restaurimit të kryheshin sipas një rendi të caktuar. Fillimisht u realizua restaurimi dhe konsolidimi i pjesëve më të dëmtuara dhe që paraqisnin rrezik shembje. Më tej, gjatë viteve '80 u ndërmorrën punime restauruese të vazhdueshme të cilat konsistonin në punime çlirimi e konsolidimi në kishën e Shën Stefanit, restaurimi i ambienteve të kapitenerisë dhe kthimin e saj në muze, çlirimi i mureve nga rrënojat, konservimi e restaurimi i mureve perimetralë të kalasë, punime restauruese në oborrin e tretë etj. Gjatë kryerjes së punimeve restauruese janë gjetur edhe objekte me vlerë historike.

suffered different damages, the restoration project had to follow a particular established order. First the most damaged parts which were about to fall, were restored and consolidated. Then in the 1980s, restoration interventions were carried out in the Saint Stephan church, removing the later additions and consolidating it, the restoration of the captain's office and adapting it into a museum, also the prescrvation of the perimeter walls and the third courtyard. During the implementation of the restoration project, objects of historical value were found.

DO NOT COPY



Porta e oborrit të III-të (projekti i restaurimit)
The gate of the 3rd courtyard (the restoration project)



Planimetria e godinës së kapitanerisë (projekt i restaurimit)
The plan of the captain's office (the restoration project)



Prerje e godinës së kapitanerisë (projekti i restaurimit)
The section of the captain's office (the restoration project)



Oborri i III-të pas restaurimit
The 3rd courtyard after restoration



Oborri i III-të (projekti i restaurimit)

The 3rd courtyard (the restoration project)



Vizatim

Drawing





Kisha-xhami e Shën Stefanit (projekti i restaurimit)

The church-mosque of St. Stephen (the restoration project)





Pamje të kalasë së Rozafës pas restaurimit

The view of the castle of Rozafa after the restoration interventions

DO NOT COPY



Muret perimetralë të kalasë (projekti i restaurimit)
The perimeter walls of the castle (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Gjerak Karaiskaj. Rilevoi: Bashkim Penxha, F. Guralumi. Përpunoi: Edmond Haxhiraj. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1979, 1982.

Bibliografi: Kamsi, V., "Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj", Monumentet, 1971,1. Kamsi, V., "Fortifikimi i hyrjes të kështjellës së Shkodrës", Monumentet, 1972, 3. Karaiskaj, Gj. 5000 Vjet fortifikime në Shqipëri. Tiranë, 1981.





Pamje të kalasë së Rozafës pas restaurimit
The view of the castle of Rozafa after the restoration interventions

DO NOT COPY

KALAJA E GJIROKASTRËS

Kalaja e Gjirokastrës është e ndërtuar mbi një shkëmb që ka formën e një kurrizi peshku, dhe prej nga ku kontrollohet një pjesë e madhe e luginës së Drinosit. Ajo të krijon përshtypjen e një anije gjigande të gdhendur në shkëmb, silueta e të cilës të bën përshtypje që larg.

Kalaja e Gjirokastrës është zanafilla e qytetit, i cili u rrit me formimin e pazarit rrëzë mureve të saj. Muret e kalasë ndjekin konturin shkëmbor të terrenit dhe rrethojnë një sipërfaqe të përzgjatur dhe të çrregullt mbi platformën e kodrës, duke u përforcuar nga shtatë kulla me formë poligonale. Kalaja ka tre hyrje, në anën veriore, në anën perëndimore dhe porta e tretë, e quajtur "Porta e Vezirit". Në konstruksionin e kalasë, të bie në sy sistemi i galerive të mbuluara me qemere të larta, që mbështeten mbi muret rrethuese dhe mbi një sistem harkadash që ngrihen mbi pilastra masive. Formën e saj të sotme, kalaja e ka marrë në periudhën e Ali Pashë Tepelenës, i cili e ktheu atë në një fortesë dhe e zgjeroi më tej.

Duhet theksuar se kalaja e Gjirokastrës është një nga ndërtimet mbrojtëse më të arrira dhe një nga veprat inxhinierike më të guximshme të arkitekturës ushtarake. Punimet e para të restaurimit në të janë kryer në vitin 1961, me ndërhyrjet e bëra në kullën pranë hyrjes veriore dhe në

THE CASTLE OF GJIROKASTRA

The Castle of Gjirokastra is built on a rock that has the shape of a fish spine, and from which you can control a large part of the valley of Drinos. It creates the impression of a gigantic ship carved in the rock, whose silhouette is striking from a distance. The Castle of Gjirokastra represents the beginning of the city, which grew up with the formulation of the bazaar at the lowest part of its walls. The walls of the castle follow the contours of the rocky terrain and they are reinforced by seven towers with polygonal shapes. The castle has three entrances, on the north side, the west side and the third gate, called "The Gate of Vizier". In the construction of the castle, the flaring system of galleries is covered with high vaults, which are supported by the surrounding walls and by a system of arcades of massive pilasters. The castle has been in its present form since the time of Ali Pasha, who turned it into a fortress and expanded it further.

It should be noted that the castle of Gjirokastra is one of the most successful defensive constructions and one of the most daring engineering works of military architecture. The first restoration interventions were done in 1961; the interventions near the northern entrance on the tower and the interventions of the clock tower. The most intensive





Pamje të kalasë së Gjirokastrës (gjendja ekzistuese dhe gjatë punimeve të restaurimit)
The view of the castle of Gjirokastra (the existing situation and during restoration work)

DO NOT COPY

kullën e sahatit. Punime më intensive u kryen me rastin e zhvillimit të festivaleve folklorike në kala në vitet '70, kur u prishën disa ndërtime në sheshin veriperëndimor dhe u restaurua muri jugor. Në vitet '80 u hartua një projekt restaurimi për të ndërhyrë në terrenin përreth mureve të kalasë për të evituar çarjet në shkëmbinjtë mbi të cilët mbështetej kalaja. Gjithashtu, janë bërë ndërhyrje të vazhdueshme restaurimi në pjesë të kalasë dhe mureve të saj.

interventions on the castle were carried out during the folk festival in the 1970s, when several buildings in the northwestern square were demolished and the southern wall was restored. In the 1980s, a restoration project was initiated to strengthen the surrounding terrain to avoid the cracks of the foundational rocks on which the castle rested. Also, there have been continuous restoration interventions in different parts of the castle and on the part of its walls.

DO NOT COPY



Planimetria e kalasë së Gjirokastrës
The plan of the castle of Gjirokastra



Fragment i planimetrisë së kalasë së Gjirokastrës (projekti i restaurimit)
Detail of the plan of the castle of Gjirokastra (the restoration project)





Pamje të kalasë së Gjirokastrës (gjendja ekzistuese dhe gjatë punimeve të restaurimit)
The view of the castle of Gjirokastra (the existing situation and during restoration work)



Ndërhyrje në muret e kalasë (projekti i restaurimit)
The intervention in the walls of the castle (the restoration project)





Pamje të galerive në kalanë e Gjirokastrës
The view of the galleries in the castle of Gjirokastra

DO NOT COPY



Plani i galerive dhe ndërhyrje restauruese
The plan of the galleries and the restoration intervention



Fragment i planimetrisë (projekti i restaurimit)
Detail of the plan (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Gjerak Karaiskaj. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës.
Bibliografi: Karaiskaj, Gj. 5000 Vjet fortifikime në Shqipëri. Tiranë, 1981, fq. 245-258.





Pamje të kalasë së Gjirokastrës
Views of the castle of Gjirokastra

DO NOT COPY

URA E MESIT

Ura e Mesit, e merr emrin nga fshati Mes pranë saj, e cila lidh Shkodrën me Drishtin dhe me krahinën e Cukalit. E ndërtuar në vitin 1768 nga veziri i Shkodrës, Mehmet Pashë Bushatlliu (plaku), ajo është një nga urat më të mëdha në Shqipëri, e realizuar me 13 harqe me hapësira të ndryshme, me një gjatësi totale prej 103 m.

Ndërtimi i urës ka kaluar në dy faza, gjë që konstatohet nga gjurmët në teknikën e ndërtimit. Fazës së parë i takon harku kryesor me tri harqe anash tij, dy në krahun e majtë dhe një në të djathtë. Në qendër të kompozimit të fazës së parë ndodhet harku kryesor gjysmërrethor me hapësirë-drite 21.5 m nën të cilin kalon shtrati i lumit Kir. Nga ana konstruktive hapësirat e dritës në harqet e urës janë realizuar me harqe dyfish.

Me zgjatimin e urës në fazën e dytë, pjesës së vjetër i shtohen 5 harqe nga e majta dhe 4 nga e djathta. Traseja e kësaj pjese është e shtruar me kalldrëm të rëndomtë me gurë lumi. Nga pikëpamja konstruktive, Ura e Mesit nuk ka paraqitur probleme. Herë pas here në këtë monument janë kryer punime, kryesisht infrastrukture si: riparim i kalldrëmit, riparime të parapetit e pastrim nga vegjetacioni dëmtues. Ndërhyrja më e dukshme është ajo e realizuar në thembrën e djathtë të qemerit të madh, ku u mbush një zgavër që rrezikonte qemerin, si dhe ndërtimi i një sistemi drenazhi gjatë gjithë pjesës së majtë të urës, i cili mbronte qemeret e kësaj ane nga vërshimi i lumit Kir.

THE BRIDGE OF MESI

The bridge of Mesi, gets its name from the nearby village of Mes, which connects Shkodra with Drisht and the province of Cukali. Built in 1768 by the Grand Vizier of Shkodra, Mehmet Pasha Bushatlli (the old), it is one of the largest bridges in Albania, realized with 13 arches with different light spaces, with a total length of 103 m. The bridge is constructed in two phases which is very easily identified by the traces found. In the first phase was built the main arch with three arches on its sides, two on the left and one on the right. In the center of the composition of the first phase is a semicircular arched span with a 21.5 m light space, under it lays the bed of the Kir river. The light spaces of the bridge arches are realized by double arches.

In the second phase the bridge was extended with five arches on the left and four on the right. The river route (track) of this section is paved with common cobblestones. Structurally speaking, we can say that the Mesi bridge is in good condition. Restoration interventions were performed occasionally on this monument, mainly to the infrastructure, such as pavement repair, restoration of the parapet, and cleaning of harmful vegetation. The most obvious intervention was realized in the heel of the big archway, where a big gap was filled that threatened the archway stability, and the construction of a drainage system throughout the left part of the bridge, which protected the archways of this side of the bridge from the Kir river.



Pamje të urës (gjendja ekzistuese)
The general view of the bridge (the existing situation)



Pamje e urës pas restaurimit
The views of the bridge after restoration

DO NOT COPY

SHKODËR



Pamje (projekti i restaurimit)
The elevation (the restoration project)



Genplani dhe prerje tërthore (projekti i restaurimit)
The general plan and the cross section (the restoration project)



Planimetri (projekti i restaurimit)
The plan (the restoration project)

DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Valter Shtylla. Rilevoi, Tushoi, Përpunoi: Agim Qyshka. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1987.

Bibliografi: Shtylla, V., "Ura të vjetra mesjetare në vendin tonë", Mjeshtrat dhe arkitektura popullore, Tiranë, 1976.
Shtylla, V., "Disa ura të vjetra prej guri në vendin tonë", Monumentet, 1976, 11.
Shtylla, V. Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri. Tiranë, 1998, fq. 142.

URA E VOKOPOLËS

Ura e Vokopolës, e ndërtuar në 1763 sipas mbishkrimit, ndodhet në fshatin Vokopolë, mbi përroin e Çoragjafit dhe ka qenë pjesë e rëndësishme në lidhjen e luginës së Osumit me luginën e Vjosës. Kjo është urë guri me qemer të madh, me segment rrethor dhe me dy dritare shkarkuese gjysmërrethore, e gjatë 43m. Muret ballore janë të punuar me gurë plloçarë të zinj e gëlqerorë kave, fugat horizontale janë të valëzuara dhe llaçi nuk duket fare ndër to. Kjo urë është me kalldrëm me brezat tërthorë sigurues. Kalldrëmi i saj është i realizuar me pllaka gurësh të zinj, të vendosur këlliç, ndërsa qemeri është i ndërtuar me dy rreshta gurësh.

Kjo urë u përmbyt nga prurjet e lumit dhe u dëmtua pjesa e majtë e saj, u shkatërrua kalldrëmi dhe gjithë nënshtresa poshtë tij, duke zbuluar qemerët nën të. Projekti i restaurimit i hartuar konstistoi në mbushjen e gërryerjes së rrezikshme, duke risjellë këtë pjesë të urës në gjendjen fillestare. Sot e kësaj dite, ky monument qëndron solid dhe në siluetin e tij origjinal.

VOKOPOLA BRIDGE

The bridge of Vokopola, built in 1763 according to the inscription, located in the village of Vokopola over the stream of Çoragjafi has played an important role in connecting the Osumi river with the valley of Vjosa. This is a stone bridge with a large archway, which is flanked with two semicircular arched openings on both sides, and extends over 43 m long. The frontal walls are built with local limestones, making the joints wavy so that you cannot see the mortar between them.

This bridge is cobbled with transversal courses for giving increased strength to it. Its pavement consists of black stone tiles, while the archway was built with two courses of stones.

At one time, the left part of the bridge was damaged by a river flood, the stone paved surfaces and the layers beneath them were also damaged, leaving the archways exposed.

The goals of the restoration project were: to fill the gaps of the dangerous erosion, bringing this part of the bridge to its original state. To this day, this monument is solid and its original architecture.





Pamje të urës (gjendja ekzistuese)
View of the bridge (the existing situation)





Pamje të urës pas restaurimit
View of the bridge after restoration

DO NOT COPY



Ura e Vokopolës (projekti i restaurimit)
The bridge of Vokopola (the restoration project)



Ura e Vokopolës (projekti i restaurimit)
The bridge of Vokopola (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Valter Shtylla. Rilevoi, Përpunoi: E. Haxhiraj. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1981.

Bibliografi: Shtylla, V. Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri. Tiranë, 1998, fq. 116,165.

DO NOT COPY

VENDVARRIMI I SKËNDERBEUT

THE BURIAL PLACE OF SCANDERBEG

Varrimin e Heroit tonë Kombëtar Skënderbeut në katedralen e Shën Kollit në Lezhë, në vitin 1468, na e bën të ditur Marin Barleti në shek. XV. E ndërtuar në shek. XIV, katedralja e Shën Kollit, në vitet '80 të shek. XVI u kthye në xhami (Xhamia Selime), e cila më tej u shkatërrua në shek. XVII për t'u rindërtuar në fund të shek. XVIII. Këto faza ndërhyrjesh paraqiten në muret dhe shtresat e dyshemesë së saj. Prej tyre, faza më e rëndësishme historike, pa dyshim është ajo e shek. XIV-XV.

Qëllimi i ndërhyrjes është ruajtja e fazës me vlera të rralla historike (ajo e shek. XIV-XV), prandaj projekti i Vendvarrimit të Skënderbeut si ide qendrore kishte vënien në pah dhe vlerësimin e vlerave historike të fazës së parë të monumentit, kishës së Shën Kollit, i cili u realizua me një ndërtimi të ri, të trajtuar me një kolonadë rreth e rrotull, brenda të cilit do ruheshin pjesët origjinale të monumentit.

Realizimi i këtij projekti përfshinte dy procese, atë të restaurimit të monumentit dhe atë të ngritjes së ndërtimit të ri mbrojtës e vlerësues. Prandaj u ruajtën dhe u restauruan muret perimetrale, duke hequr çdo shtresë të re të bërë mbas shek. XIV, dhe u hoqën suvatimet e reja në mënyrë që të lexohet qartë teknika e ndërtimit të muraturës. Muratura paraqitej në gjendje të dëmtuar, prandaj u morrën masa si: përforcimi i themeleve dhe i mureve.

The funeral of our national hero Skanderbeg in the St. Nicholas Cathedral, in Lezha, in 1468, was described in writing by Marin Barleti in the 15th Century. The Cathedral of St. Nicholas was built in the 14th Century, and in the 1680's was transformed into a mosque. (The Mosque Selime), which was further destroyed in the 17th Century was rebuilt at the end of the 18th Century. These phases of interventions are seen on its walls and its floor layers. The most important of these historical phases is without a doubt, the 14th to 15th Century phase .

The purpose of the intervention is the preservation of the historical phase with rare values (in the 14th to 15th Century). The main goal of the project of restoration for the burial place of Scanderbeg was the evaluation of the historical values of the first phase of the monument, the church of St. Nicholas. The original parts of the monument were preserved under a colonnade construction.

The realization of this project involved two phases, the restoration of the monument and the construction of the new building. So the perimeter walls were preserved and restored. Then it each of the new layers added after the 14th Century were removed. Additionally the plaster that was added later than that was removed in order to clearly read the masonry construction and the techniques of the construction of the walls. It was found that the masonry





Pamje të Kishës së Shën Kollit gjatë punimeve
The general view of the Church of St. Nicholas during the work

DO NOT COPY

Dyshemeja u shtrua me pllaka të daltuara që ngjan me shtresën origjinale të saj. Gjithashtu u restaurua dhe një pjesë afresku e ruajtur në pjesën e absidës. Monumenti i restauruar u përfshi brenda ndërtimit të ri, i trajtuar me një kolonadë që mban sipër një kornizë të dalë.

Para realizimit të përkujtimores u realizuan gërmime arkeologjike, të cilat vazhduan edhe gjatë punimeve të restaurimit dhe ndërtimit të saj. Këto gërmime zbuluan muret perimetralë të anës jugore dhe lindore të rrethimit të qytetit të Lisit, që shtrihej nga kodra deri buzë lumit dhe një nga portat kryesore të hyrjes së qytetit me kullat e saj mbrojtëse. Vlerësimi i rrugës antike të zbuluar është bërë edhe gjatë shtrirjes së saj në pjesën e platformës, ndërsa muri mesjetar i rrethimit të dytë të qytetit është në sfond të përkujtimores.

walls were in very bad shape, so one of the interventions was the reinforcing of the basement and the walls. The floor was restored and textured with chiseled tiles resembling its original layer. Also a fresco was restored and preserved in the apse space. The restored monument was inscribed in the new building,

Archaeological excavations were carried out during the construction of the new building work and the restoration of the church. These excavations uncovered the perimeter of walls on the southern and eastern side of the siege of the Lisi city, that was expanded from the hills to the river's edge and one of the main entry gates of the city with its defense towers.

DO NOT COPY



Plani i kishës së Shën Kollit
The plan of The Church of St. Nicholas



Prerje gjatësore
Longitudinal section



Kisha e Shën Kollit (projekti i restaurimit)
The St. Nicholas Church (the restoration project)



Plani i gërmimeve
The plan of excavations



Gërmime arkeologjike rreth Vendvarrimit të Skënderbeut

The digging around the burial place of Scanderbeg





Pamje të Kishës së Shën Kollit gjatë punimeve

The general view of the Church of St. Nicholas during the work

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Pamje të Vendvarrimit të Skënderbeut pas restaurimit

The views of the burial place of Scanderbeg after restoration





Projekti i Vendvarrimit të Skënderbeut

The project of the burial place of Scanderbeg



Projekti i Vendvarrimit të Skënderbeut

The project of the burial place of Scanderbeg



Planimetria e Kishës së Shën Kollit

The layout of the Church of St. Nicholas

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Latif Lazimi. Rilevoi: Latif Lazimi, Bashkim Penxha, Agim Qyshka, S. Terezi. Vizatoi: Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës, 1978-1981, nën drejtimin e autorit, Koço Zhekut dhe Th. Karanxhës.

Bibliografi: Lazimi, L., "Përkujtimorja e Skënderbeut në Lezhë", Restaurimi, 1984, 1. Lazimi, L., "Përkujtimorja e Skënderbeut", Monumentet, 1984, 2.
Prendi, F., "Vendvarrimi i Skënderbeut", Lissus, Tiranë, 1967, 1.

KISHA E SHËN MARISË, LEUSË

THE ST. MARY'S CHURCH, LEUSA

Kisha e Shën Marisë në fshatin Leusë të Përmetit është një monument me vlera të veçanta arkitektonike dhe artistike, si të pikturës murale, ashtu edhe në objekte të tjera të interierit të gdhendura në dru, si ikonostasi, froni peshkopal, amvoni etj. Mbishkrimi bën fjalë për ndërtimin dhe pikturimin e kishës më 1812, ndërsa ikonostasi është i gdhendur në vitin 1817.

Oborri i kishës është i rrethuar me mure dhe ka shërbyer edhe si varrezë e fshatit.

Kisha përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore dhe hajati, i cili zhvillohet gjatë gjithë pamjes veriore. Naosi i përket tipit bazilikal trenefësh me kupolë, narteksi përmban jinekonitin që del në formë ballkoni të brendshëm pjesërisht në narteks dhe pjesërisht në naos, hajati është i hapur në pjesën ballore me një harkadë të gurtë mbi kolona të ulta prej guri dhe kambanorja, që ngrihet në qoshen veriperëndimore të narteksit, ka formën e një muri masiv, i cili përmban në pjesën e sipërme kamaren për vendosjen e kambanës.

Monumenti paraqiste dëmtime serioze të strukturës mbajtëse, si cedime, çarje, dekompozime të elementeve konstruktive, të cilat të çojnë në humbjen e aftësisë mbajtëse të monumentit dhe sjellin dëmtime të pikturës murale.

Për vetë problematikën e ndërlikuar që paraqiste ky monument, studimi dhe ndërhyrjet restauruese kishin një karakter kompleks, që përfshinte anën gjeoteknike, hidroteknike, statike, morfologjike si dhe konservimin e veprave të artit. Kriteri bazë i ndërhyrjeve të konsolidimit

The St. Mary's Church which is located in the village of Leusë-Permet is a special monument with architectural and artistic value. Endowed within it are mural paintings, as well as other interior objects carved in wood, like the iconostasis, the episcopal throne, the amvioni etc.

An inscription refers to the construction and painting of the church in 1812, while the iconostasis was carved in 1817. The courtyard of the church is surrounded by walls and has also served as the cemetery for the village.

The church building itself, consists of the central nave, the narthex on the west side, and the-colonnaded courtyard which runs along the northern elevation. The naos (nave) belongs to the basilica type with three aisles and a dome. The narthex contains jinekonitin (pulpit) rising up as an internal balcony in the narthex and partly in the central nave. The vestibule is open at the front with an arcade of stones supported by short stone columns. The belfry, which arises in the northwest corner of the narthex forms massive wall, which in the upper part contains the niche to place the bell.

The monument has suffered serious damage to its retaining walls due to the separation, cracks and decomposition of constructive elements that have made the building structurally weak, as well as damage to the mural paintings.

Due to the complex problems that accompany this monument, the study and the restoration interventions have had a complex character, which have included the geotechnical study, the hydro-technique study, the







Gjendja para restaurimit, problematika që përfshin anën gjeoteknike, statike, morfologjike dhe konservimi i veprave të artit

Issues before restoration regarding geo technic, static, morphologic and the conservation of the works of art

DO NOT COPY

statik të propozuara ishte shëndoshja e konstruksionit ekzistues për të rifituar aftësitë mbajtëse të humbura dhe ndihmën me elemente konstruktive të reja, gjithmonë duke respektuar dhe duke mos ndryshuar skemën konstruktive dhe tiparet morfologjike fillestare. Këto ndërhyrje konsistonin në: shëndoshjen e elementeve konstruktive ekzistuese, përforcimin e zonave ku ndërhyrjet e shëndoshjes nuk ishin të mjaftueshme, zëvendësimin e elementeve tërësisht të dëmtuar, konservimin e plotësimin e elementeve arkitektonike dhe atyre dekorative. Gjithashtu, përsa i përket pikturës murale u ndërmorrën këto masa: injektim në vendet e fryra, përforcim me llaç në zonat ku kishte rënie suvaje, qepje e bordurave, heqje e rivendosje e fragmenteve të dëmtuara, pastrim i pikturës nga pluhurat e myqet, ribërja e strukturës së tavanit dekorativ etj. Fragmentet më me interes të gjetura gjatë sondazheve janë ruajtur *in situ* dhe janë të ekspozueshme për vizitorin.

Me realizimin e punimeve të restaurimit u arrit që monumenti jo vetëm të shpëtojë dhe të fitojë jetëgjatësi, por dhe të evidentohen vlerat e vërteta arkitektonike dhe artistike të tij, si dhe t'i rikthejë banorëve të fshatit dhe krahinës përreth një tempull të denjë lutjesh e faljesh.

structural study (structural integrity and stability) , morphology and conservation of artworks. The basic criteria of the structural interventions was the consolidation of the existing building for recovering the loss of the structural capabilities of the buiding by introducing new structural elements but at the same time preserving the old structural scheme and old morphological features.

These interventions consisted of: consolidation of the existing structural elements, reinforcing the aereas where the consolidation work was not enough, the replacement of the totally damaged elements,conservation and restoration of architectural and decorative elements. The interventions in the mural painting consisted of : injections in the areas where plaster has bubbled out due to increased moisture, reinforcing the mortar in areas with falling plaster, hemming the edges, removal and restoration of damaged fragments, cleaning the dust and moulding from the paintings and restoring the structure of the decorative ceiling.

The most interesting fragments found during surveys have been preserved 'in situ' and are on display for the visitors. The implementation of the restoration work has achieved the goal of saving the monument and extending its longevity, but it has also served to help identify its true architectural and artistic values, as well as to restore to the villagers and the surrounding region a house worthy for prayer and worship.

DO NOT COPY






Gjendja para restaurimit, problematika që përfshin anën gjeoteknike, statike, morfologjike dhe konservimi i veprave të artit

Issues before restoration regarding geo technic, static, morphologic and the conservation of the works of art



Planimetria e kishës (projekti i restaurimit)
Church plan (restoration project)



Plani i themeleve (projekti i restaurimit)
Foundation plan (restoration project)





Ikonostasi (para dhe pas restaurimit)
Iconostasys before and after the restoration

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Prerje gjatësore e kishës (projekti i restaurimit)
Longitudinal section (restoration project)



Prerje tërthore e kishës (projekti i restaurimit)
Transversal section (restoration project)





Piktura murale (para dhe pas restaurimit)
Mural paintings before and after the restoration







Pamje të kishës pas restaurimit
Photos of the church after the restoration



Plani i strukturave (projekti i restaurimit)
Structural plan (restoration project)



Plani i tirantave (projekti i restaurimit)
Plan of structural tie-rods (restoration project)



Fasada kryesore e kishës (projekti i restaurimit)
Main Front Facade of the church (restoration project)

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i konsolidimit dhe restaurimit: Prof. Dr. Pirro Thomo, Ing. Jorgjia Bej Msc. Projekti dhe ekzekutimi i konservimit të veprave të artit: Mustafa Arapi, Ali Ago. Studimi gjeoteknik: Prof. Dr. Luljeta Bozo, Ing. Bekim Bilaj. Punimet u kryen nga: Shoqëria "AD- STAR" dhe Dega e Monumenteve të Beratit në vitin 2000. Financimi u krye nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (KOASH).

Bibliografi: THOMO, P., "Leusë-Përmet, Kisha e Shën Marisë", Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri, fq. 37-50, Tiranë, 2005.

THOMO, P., "Restaurimi i kishës së Shën Marisë në Leusë të Përmetit", Monumentet, 2008.

KISHA E SHËN MARI VLLAHERNËS

Kisha e Shën Mari Vllahernës është kisha më e vjetër që ruhet sot në qytetin e Beratit. Ndodhet brenda qendrës së banuar të lagjes Kala. Në gjendjen e sotme kisha ruhet në gjendje mjaft të transformuar, me një mbivendosje të qartë fazash ndërtimi, nga një meremetim i kryer në vitin 1578, kur pikturohet nga Nikolla i Onufrit. Në gjendjen fillestare kisha i përkiste tipit me kryq të brendashkruar me kupolë me katër mbështetje të brendshme. Në anën perëndimore naosi paraprihej nga një narteks i njëkohshëm me të. Sot ruhen dy pilastrat kuadratike nga lindja dhe nga një sondazh është gjetur mbështetja veriperëndimore e gjurmë të tjera të nënstrukturave. Gjithashtu, ruhet e plotë ana lindore e kishës, ndërsa anët veriore dhe jugore ruhen deri në nivelet e kornizave të frontoneve të krahëve të kryqit. Në plan kisha shmanget nga forma drejtkëndore, shmangie normale për arkitekturën bizantine.

Për sa i përket kohës së ndërtimit, nga forma arkitektonike dhe teknika e ndërtimit kjo kishë është datuar në shek. XIII, ndërsa kisha në gjendjen që është sot i përket transformimeve të shek. XVI. Ndërtesa rrezikohej në muret anësore dhe nga cedimi juglindor. Nisur nga gjendja e monumentit, u hartua projekti i restaurimit, i cili parashikonte stabilizimin e mureve, rregullimin e mbulesës si dhe restaurimin e pikturës murale. Fillimisht u bënë sondazhe për të gjykuar saktë gjendjen e objektit. Më tej nisën ndërhyrjet me përforcimin e bordurave, u bë

THE ST. MARY CHURCH VLLAHERNA

The church of St. Mary Vllaherna is the oldest church which is now in the city of Berat. It is situated inside the walls of the inhabited castle. At this point in time, the transformation of the church building is well preserved, with a clear overlapping of the construction phases, from an intervention in 1578 when it was adorned with colorful murals by Nicholas Onufri. In its original first design, the church belonged to the cross shape type with a cupola with four internal supports. On the western side the central nave is preceded by a simultaneous narthex. Two squared pilasters are preserved in the east of the building and from a survey there were found traces of the supporting elements of the structural system of the church.

Also preserved, is the whole eastern part of the church, while the northern part and the southern part are preserved up to the levels of the frontones of the church wings.

Its plan does not have the formal rectangular shape but is deviated, which is something normal for the byzantine architecture. As far as the construction phases are concerned, according to its architectural shape and construction techniques the initial building of this church is dated in the 15th Century, while the current church building is more closely associated with the transformations of the 16th Century.

Based on its existing conditions, the project of restoration was compiled which aimed for the restoration of the mural





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
The view of the building (the existing situation)

DEMO COPY

e mundur lidhja e dy pilastrave dhe konsolidimimi i tyre, u pajatua gjithë harku paraapsidal para se të niste puna për stabilizimin e pilastrit juglindor. Gjithashtu u realizua dhe pajantimi i jashtëm i gjithë objektit.

paintings, reinforcing of the walls and the consolidation of the columns.

DO NOT COPY



Planimetria e kishës (gjendja ekzistuese)
The plan of the church (the existing situation)



Fasada lindore (gjendja ekzistuese)
The east facade (the existing situation)



Fasada jugore (gjendja ekzistuese)
The southern facade (the existing situation)



Fasada veriore (gjendja ekzistuese)
The northern facade (the existing situation)





Pamje të objektit (gjatë ndërhyrjeve të restaurimit)
The views of the building (interventions of restoration)



Planimetria e kishës
The plan of the church



Prerje gjatësore e objektit
The longitudinal section



Prerje tërthore e objektit (projekti i restaurimit)
The cross section (the restoration project)

DO NOT COPY





Piktura murale
The mural paintings



Fasada veriore (projekti i restaurimit)
The northern facade (the restoration project)



Fasada jugore (projekti i restaurimit)
The southern facade (the restoration project)

DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Sulejman Dashi, Genc Samimi. Punimet u kryen nga: Atelieja e Beratit në vitin 1979.

Bibliografi: Meksi, A., "Tri kisha bizantine të Beratit", Monumentet, 1972, 4. "Kronikë e punimeve restauruese në vitin 1979", Monumentet, 1980, 20.



Fasada lindore (projekti i restaurimit)
The east facade (the restoration project)



Pamje e kishës së Shën Mari Vllahernës pas restaurimit
The view of the church of St. Mary Vllaherna after the restoration

KISHA E MARMIROIT

Kisha e Marmiroit ndodhet mbi një çukë të vogël në afërsi të Orikut. Kisha ndodhet në majën e kodrës dhe gjendet në këndin juglindor të një oborri, ku, si mure rrethuese janë shfrytëzuar edhe vetë muret e saj. Për vendin shkëmbor në të cilin është ndërtuar dhe përmasat e vogla, kisha bën një efekt mjaft piktoresk dhe duket si një bllok i vetëm. Njihet me emrin e Marmiroit, i cili del në burimet historike në vitin 1307. Brenda oborrit, në të cilin hyhet nëpërmjet një porte në anën jugore, gjenden mure të rrënuara. Kisha përbëhet nga naosi me planimetri në formë kryqi të lirë dhe narteksi i rrënuar në anën perëndimore të tij. Objekti ka tri hyrje: veri, jug dhe perëndim. Në brendësi ka formë kryqi me krahë jo të barabartë. Krahët perëndimorë dhe lindorë janë më të gjatë se të tjerët. Në murin lindor del jashtë absida gjysmërrethore e ndriçuar nga një dritare e vogël. Në anën e jashtme krahët e kryqit përfundojnë me frontone. Narteksi me planimetri drejtkëndore ruhet me mure të rrënuara dhe duken qartë lidhjet me murin e naosit, çka flet për njëkohshmërinë e ndërtimit të tyre. Trajtimi i godinës është i thjeshtë, mungon tërësisht dekoracioni, faqet e mureve janë të rrafshëta. Teknika e ndërtimit të mureve është e zakonshme, me gurë të skuadruar vetëm në qoshet dhe me copa tjegullash apo tullash. Përkujdesje është treguar për absidën dhe për portën jugore mbuluar me arkitra dhe një hark të rremë.
Kisha u gjet në gjendje mjaft të rënduar, me pjesë gjysmë të rrënuara. Gjithashtu, të çara të mëdha dalloheshin në të

THE MARMIROI CHURCH

The Marmiroi church is located on a small hillock near Oriku, and is situated in the southeast corner of a yard, where the surrounding perimeter walls are also used as its own building walls. Due to the rocky place in which it was built and the small size, the church has a very picturesque effect and presents itself as a unified single block. It has been known by the name Marmiroi, in historical sources since 1307. Inside the courtyard, where you enter through a gate on the south side, there are demolished walls. The church is composed of a central nave with a free cross-shaped plan and the ruined narthex in the western side. The building has three entrances: north, south and west. Its interior has the shape of a cross with unequal wings.. The western and eastern wings are longer than the others. A semicircular apse stands out in the eastern wall, lighted by a small window.
The narthex has a rectangular plan as we understand by the preserved ruined walls. It's connection with the walls of the naos is obvious, which shows the similarity of their construction. The architecture of the building is simple, completely void of ornamentation, The surfaces of the walls are flat. The technique of building the walls is common, with squared stones and with pieces of roof tiles or bricks. Interventions have been made for restoring the apse and the southern gate covered with an architrave and a false arch. The church was discovered to be in very poor condition, with damaged portions and

DO NOT COPY



Pamje të kishës (gjendja ekzistuese)
The views of the church (the existing situation)



Kisha e Marmiroit (genplani)
The church of Marmiroi (the general plan)

katër anët. Duke marrë parasysh rrezikshmërinë në të cilën gjendej monumenti, si nga dëmtimet strukturore ashtu edhe ekspozimi ndaj faktorëve atmosferikë, u vendos ndërhyrja në monument duke përforcuar anën konstruktive të tij dhe duke e çliruar nga shtesat, në mënyrë që të dilnin në dukje vlerat e vërteta të kishës. Përveç përforcimeve, ishin të nevojshme edhe disa plotësime të mureve, kompletimi i tamburit e i kupolës si dhe drejtimi i murit verior. Kisha e Marmiroit, pas restaurimit, nga një rrënojë e destinuar për të humbur, zuri vendin që i takon ndër monumentet e arkitekturës bizantine në vendin tonë, me tërë mundësinë për t'u vlerësuar.

large exposed cracks throughout the building. Taking into consideration the state of the monument, its structural stability, the environmental factors, and the danger of collapse, a decision was made to intervene by reinforcing the structural system of the monument and by removing the unimportant later additions. Despite the previous interventions completions of walls were made, the completion of the drum of the cupola and the effort was undertaken to make the northern wall upright and plumb. The implementation of the restoration project made it possible for the monument to play an important role in the byzantine architecture of our country.



Fasadat e kishës (gjendja ekzistuese)
The facades of the church (the existing situation)



Pamje të kishës (gjatë punimeve)
The view of the church (the existing situation and during the works)

DO NOT COPY



Fasadat e kishës (projekti i restaurimit)

The facades of the church (the restoration project)





Projekti i restaurimit i vitit 1967

The project of restoration of 1967

DO NOT COPY



DO NOT COPY



Pamje të kishës pas restaurimit

View s of the church (after the restoration)

Projekti: Projekti i restaurimit: Aleksandër Meksi. Rilevoi: Gjerak Karaiskaj, Valter Shtylla. Vizatoi: Faruk Zarshati. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e Aleksandër Meksit dhe Leonard Sulit në vitin 1967.

Bibliografi: Meksi, A. Arkitektura mesjetare në Shqipëri. Tiranë, 1983, fq. 125-128. Meksi, A., "Restaurimi i kishës së Marmiroit", Monumentet, 1971, 2.

KISHA E FJETJES SË SHËN MARISË, ZERVAT

Kisha e Fjetjes së Shën Marisë në fshatin Zervat të Gjirokastrës është një nga monumentet më të rëndësishme të periudhës pasbizantine që ruhen në këtë krahinë, me vlera të veçanta artistike dhe arkitektonike. Ajo paraqet një interes të veçantë si për tiparet tipologjike e morfologjike, ashtu dhe për sa i përket studimit të fazave ndërtimore dhe datimit të tyre.

Kisha përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore, hajati në anën jugore, kambanorja që lartësohet mbi murin perëndimor të narteksit dhe një portik i dytë përpara hyrjes veriore të narteksit.

Nga një vështrim i kujdesshëm i kishës vërehen shumë gjurmë që të shpien në përfundimin se monumenti përbëhet nga disa faza ndërtimore dhe se pamja e sotme është si rezultat i ndërhyrjeve të vazhduara në të. Për sa i përket kronologjisë së fazave ndërtimore, mund të themi se faza e parë i përket periudhës bizantine, faza e dytë do të ketë si kufi të fundit 1583, që përmban mbishkrimi i parë, ndërsa viti 1606 i mbishkrimit të dytë konsiderohet si viti i përfundimit të fazës së tretë. Ndërsa ndërtimi i hajatit duhet t'i përkasë shek. XVIII.

Duke u bazuar në gjendjen e ndërtesës dhe në studimin arkitektoniko-artistik të monumentit, u hartua projekti i restaurimit duke u plotësuar dorë pas dore me zbulimin e gjurmëve dhe të elementeve të reja. Nga ana konstruktive ndërhyrjet u përqendruan në konsolidimin e konstruksionit mbajtës, themeleve, muraturave dhe qemereve, për t'u rikthyer qëndrueshmërinë statike. Ndërsa nga ana arkitektonike dhe tipologjike kriteri i zbatuar është

THE CHURCH OF "THE DORMITION OF ST. MARY" IN ZERVAT

The Church of the Dormition of Saint Mary in the village of Zervat in Gjirokastra, is one of the most important monuments of the Post-Byzantine period preserved in the area, with special artistic and architectural value. It is of special interest not only for its typology and morphology, but also for the study of the construction phases and their dating.

The church consists of the naos, a narthex on the western side, and a gallery in the south, connected by a portico in front of the northern entrance of the naos, a belfry that rises over the western wall of the narthex and a second portico in front of the northern entrance to the narthex.

From a careful look at the church, many traces are evidenced, leading to the conclusion that the monument comes from different phases of construction and that its present appearance is the culmination of interventions at various times. With regard to the chronology of the building phases, there is now no doubt that the first phase belongs to the Byzantine period. The end of the second phase can be fixed as the year 1583, since that is the date on the first inscription. We can consider 1606, the year on the second inscription, as the end of the third phase. While the construction of the colonnaded courtyard must belong in the 18th century. (1700's)

Based on the condition of the building and the architectural and artistic study of the monument, a project for restoration was prepared. It proceeded step by step and took final form with the discovery of traces and other new elements. Structurally, the interventions were



Pozicioni i sondazheve
Survey





Foto të sondazheve
Survey Photos

DO NOT COPY

ruajtja dhe evidentimi i gjithë fazave kryesore për të bërë të mundur ndjekjen e gjithë historisë së zhvillimit të monumentit. Krahas punimeve të arkitekturës u kryen dhe ndërhyrjet konservuese në pikturën murale që konsistojnë në konsolidimin e saj dhe në pastrimin nga kripërat, nxirjet etj, të cilat nxorrën në pah vlerat artistike të kishës.

concentrated on consolidating the supporting construction, the foundations, the masonry and the vaults, in order to return them to a condition of structural integrity, which had been weakened by time and damage.

With regard to architecture and typology, the main criterion implemented was the preservation and evidence of all the main building phases, to make it possible to trace all the history of the development of the monument. Removing the covering, which was necessary for consolidating the construction, also brought to light many other important elements. Numerous traces of the tiles of the first phase were discovered, as well as the arms of both the cross and the cupola, the height of the roofs of later phases, fragments of cornices in saw-tooth form that ended up in the masonry of the arms of the cross, as well as many other elements of different building phases.

The main criterion of the mural painting consisted in consolidating it and cleaning it from the salts and mould.



Plani i strukturave (projekti i fazës së I-rë)
Structural plan (project of the first phase)



Plani i çatisë (projekti i fazës së I-rë)
Roof plan (project of the first phase)



Foto të sondazheve
Survey Photos

DO NOT COPY



Fasada jugore (projekti i fazës së I-rë)
South Elevation (project of the first phase)



Fasada lindore (projekti i fazës së I-rë)
East Elevation (project of the first phase)





Fasada lindore (para dhe pas restaurimit)
East Elevation (before and after the restoration)

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fazat ndërtimore të kishës (projekti i përpunuar)
Construction phases of the church



Fasada jugore (projekti i përpunuar)
South Elevation (elaborated project)



Fazat ndërtimore të kishës
Construction phases of the church



Plani i çatisë (projekti i përpunuar)
Roof plan (elaborated project)



Fasada jugore (projekti i përpunuar)
South Elevation (elaborated project)





Piktura murale (para dhe pas ndërhyrjes)
Mural painting (before and after the restoration)

DO NOT COPY



DO NOT COPY



Kisha e Fjetjes së Shën Marisë-Zervat, Gjirokastër
The Dormition of Saint Mary Church-Zervat, Gjirokastra

Projekti: Udhëheqësi i projektit dhe i zbatimit: Prof. Dr. Pirro Thomo. Projekti statik: Msc. në restaurim Leonidha Papa. Projekti i konservimit të pikturës murale: Prof. Dr. Hasan Nallbani. Konservimi i ikonostasit dhe ikonave: Mustafa Arapi. Punimet u kryen nga: Shoqëria "AD- STAR", financuar nga Qendra Evropiane e Monumenteve Bizantine dhe Pasbizantine në kuadrin e programeve të KOASH-it, viti 2002.

Bibliografi: THOMO, P., "Zervat-Gjirokastër, Kisha "Fjetja e Shën Marisë"", Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri, Tiranë, 2005.

THOMO, P. Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut. Tiranë, 1998, fq. 110-114.

THOMO, P., "Konsolidimi dhe restaurimi i Kishës "Fjetja e Shën Marisë" në Zervat të Gjirokastrës", Monumentet, 2009-2010, 51.

KISHA E SHËN KOLLIT, PERONDI

Kisha e Shën Kollit ndodhet në fshatin Perondi, pranë Kuçovës. Njoftimin më të vjetër për të e kemi në vitin 1399 (1432), si manastir i Shën Kollit të Pentarhondëve.
naosi me një ikonostas druri me vlerë, i vitit 1786.
Përpara restaurimit rrethohej me hajate të mbyllura nga të tre anët. Nga studimi i hollësishëm doli në pah se pjesa qendrore i përkiste një ndërtimi të periudhës bizantine. Sondazhet e kryera përcaktuan tri periudha kryesore ndërtimi. Synimi kryesor gjatë hartimit të projektit të restaurimit ishte vënia në dukje e bazilikës dhe e kambanares bizantine, e vetme në vendin tonë. Për realizimin e këtij synimi duhet të hiqeshin shtresat mbi narteks dhe hajatin e vonë. Përveç saj duhet të kryhej edhe meremetimi i elementëve arkitektonike të veçanta. Punimet e restaurimit do të konsistonin në heqjen e çatisë të hajatit dhe të kishës me qëllim nxjerrjen e të dhënave të reja, ndërtimin e një muri kufizues mes anës perëndimore dhe nefit qendror, ndërtimin e kornizave e çative të reja, restaurimin e dritareve, restaurimin e kambanares, restaurimin e dyshemesë etj. Punimet e restaurimit filluan me heqjen e çative të hajatit dhe të kishës, të cilat nxorrën në dukje fragmente afreskesh mbi tavane; më tej u vijua me heqjen e çatisë dhe me heqjen e shtresave të tullave në murin verior e jugor, duke nxjerrë formën e tij të vjetër. Ndërhyrjet vijuan me restaurimin e nefit qendror, të dritareve, pastrimim e mureve nga jashtë etj. Më në fund u restaurua kambanarja e kishës dhe u kalua në ndërhyrjet restauruese në interier.
Në përfundim të punimeve monumenti na paraqitet si një bazilikë bizantine me kambanare unikale, duke evidentuar

THE CHURCH OF ST. KOLLIT - PERONDI

The church of St. Kolli is located in the village Perondi near Kucova. The oldest record of this church is in the year 1399 (1432), as the monastery of
St. Kollit of Pentarhondëve.
The St. Kolli church is a three-aisled basilica of the Hellenistic type. The altar space is separated from the central nave by an old wooden iconostasis, built in the year 1786. Before the restoration the church was surrounded by closed porches on three sides. A detailed study revealed that the central part of the building belonged to the Byzantine period. The surveys conducted have determined three main construction periods. The main goal during the restoration project was to draw attention to the basilica and the tower of the Byzantine period, the only one of this type in Albania.
To achieve this goal the layers above the narthex and the late porch had to be removed and the special architectural elements had to be repaired. In order to achieve new data the roof of the porch and the roof of the church had to be removed. Further restoration interventions were: building a wall between the west side and the central nave, the building of new frames and new roofs, the restoration of windows, the restoration of the belfry and the floor. The restoration interventions began with the removal of the roof of the porch and the church, where fragments of frescoes on the ceilings were discovered; it was followed by removal of the roof and layers of bricks in the northern and southern wall, bringing those walls back to their original form. The interventions continued with the restoration of the central nave, the restoration of





Pamje e objektit (gjendja ekzistuese)
The view of the building (the existing situation)

DO NOT COPY

njëkohësisht të gjitha fazat e mëvonshme ndërtimore.

the windows etc. and the cleaning of the walls from the outside. Later the belfry of the church was restored and then the restoration began on the interior spaces of the church.

The restoration project made it possible to have a restored byzantine basilica with a unique belfry, with each of the latest phases of construction documented in details.



Planimetria e katit përdhe ku dallohen fazat ndërtimore
The ground floor plan with all the construction phases



Planimetria e katit të I-rë (gjendja ekzistuese)
1st Floor Plan (the existing situation)



Prerje gjatësore e objektit (gjendja ekzistuese)
Longitudinal section of the monument (the existing situation)



Prerje tërthore e objektit (gjendja ekzistuese)
Cross section of monument (the existing situation)



Fasada veriore (gjendja ekzistuese)
The Northern Elevation (the existing situation)



Fasa jugore (gjendja ekzistuese)
The Southern Elevation (the existing situation)

DO NOT COPY



Fasada perëndimore (projekti i restaurimit)
The Western Elevation (the restoration project)



Fasada lindore (projekti i restaurimit)
The Eastern Elevation (the restoration project)



Fasada veriore (projekti i restaurimit)
The Northern Elevation (the restoration project)



Fasada jugore (projekti i restaurimit)
The Southern Elevation (the restoration project)





Pamje të objektit gjatë punimeve restauruese
The views of the building during restoration works

DO NOT COPY



DO NOT COPY



Projekti i restaurimit: Aleksansër Meksi. Punimet u kryen nga: Instituti i Monumenteve të Kulturës nën drejtimin e autorit, 1970.

Bibliografi: Meksi, A., "Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë", Monumentet, 1973, 5-6.

Pamje të objektit pas restaurimit

The views of the building after the restoration

KISHA E SHËN MARISË, KOSINË

THE ST. MARY'S CHURCH, KOSINA

Kisha e Shën Marisë në Kosinë (Përmet) i përket gjysmës së parë të shek. XII dhe është e njohur për vlerat arkitektonike që mbart. Në ndërtimin planimetrik paraqet një variant të rrallë të kishave të tipit në formë kryqi të brendashkruar me kupolë dhe me narteks, i cili të kujton atë të quajtur "tip Nerezi". Ky monument kishte pësuar një sërë ndryshimesh, të cilat ia kishin tjetërsuar pamjen, duke ia fshehur vlerat shkencore dhe estetike. Duke pasur parasysh vlerat e monumentit, u vendos që të ndërhyhej për restaurimin e tij. Ndërhyrja restauruese filloi me një sërë punimesh me karakter çlirues, që në vetvete paraqesin sondazhe të mirëfillta, të domosdoshme për të përshtatur saktë trajtat fillestare të kishës, dhe sidomos shkallën e ruajtjes së tyre dhe elementeve përbërëse nën shtresat e mëvonshme. Fillimisht u bë zhveshja e tamburit të kupolës nga suvatimi i vonë, i cili rezultoi të ishte me dritare dhe nike. Gjithashtu, nga pastrimi i çatisë doli në dukje forma e vjetër me krahët e kryqit për naosin, çatitë e mjediseve këndore në nivel të ulët. Nga pastrimi i mbushjeve të mbulesës së narteksit u dalluan ndërhyrjet

The church of St. Mary in Kosinë (Permet) belongs to the first half of the 12th Century and is known for its architectural values that it carries. In the plan the building represents a rare type of the inscribed cross shaped church with a cupola and the narthex, which reminds you of the type called "Nerezi". This monument had undergone a number of changes which diminished its reputation, by hiding the scientific and aesthetic values.

After taking into consideration the values of the monument, it was decided to restore it. The restoration's interventions began with detailed surveys, and reversing improper remodels. This kind of intervention was indispensable to restoring the original architecture of the church by preserving its compounding elements under the layers which were added later.

First, the most recent plaster layer was separated from the cupola drum, which revealed windows and niches. The old forms of the cross wings of the naos, the roofs of the angular spaces at a lower level were discovered after cleaning the roof. The interventions done to the narthex





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)

The views of the building (the existing situation)

DO NOT COPY

në të.

Duke pasur të qartë ndryshimet që monumenti kishte pësuar në kohë u hartua projekti i restaurimit, i cili paraqiste zhveshjen nga mbivëniet e vona, ndërtimin e çative me tjegulla në nivelet e dikurshme, ripunimin e kornizave dhëmbësharrë. Për sa u përket dyerve të murit perëndimor të narteksit, ai u la për një kohë në gjendjen që ruhej, sepse do të duhej të riformonin një sipërfaqe të madhe. Korniza që e përfundonte atë u bë e thjeshtë dhe në përputhje me ecurinë e kornizave veriore e jugore të narteksit. Pas çlirimeve të bëra, punimet vijuan me identifikimin e kornizave, mbulimin e çatisë, hapjen e mbushjeve të dyerve, pastrimin e muraturës nga llaçrat dhe rindërtimin e dritareve. Me punimet restauruese u përfituan mjaft të dhëna për arkitekturën e monumentit dhe teknikën e ndërtimit të tij, u nxorrën të dhëna për ndërtimin e kupolës, qemereve, mureve dhe zbukurimores së këtyre të fundit.

were visible after cleaning its cover.

Since the changes that the monument had been prone to were very clear, the architectural restoration project's first goal was to reverse the improper remodels, the construction of the tile roofs up to the previous level heights. The doors of the west wall of the narthex were preserved the way they were for a long time, because it needed a big surface to reformulate. Its ending cornice was made the same way as the northern and southern cornices of the narthex. Further interventions were: the identification of the cornices, the covering of the roof, the cleaning of the walls' masonry from the mortar, and the reconstruction of the windows. The restoration interventions discovered a lot of new data regarding the architecture of the monument and its construction technique and also for the construction of the cupola, walls and their decorative elements.

DO NOT COPY



Planimetria e kishës (gjendja ekzistuese)
The general plan of the church (The existing situation)



Prerje gjatësore (gjendja ekzistuese)
The longitudinal section (the existing situation)



Fasada jugore (gjendja ekzistuese)
The southern facade (the existing situation)



Fasada jugore (projekti i restaurimit)
The southern facade (restoration project)



Fasada lindore (gjendja ekzistuese)
The eastern facade (the existing situation)



Fasada lindore (projekti i restaurimit)
The eastern facade (the restoration project)





Piktura murale dhe kisha, pas restaurimit
The wall paintings and churche after restoration

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Aleksandër Meksi. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1983.

Bibliografi: Thomo, P., "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI-XIV, Studime historike, Tiranë, 1972, 4.
Meksi, A., "Restaurimi i kishës së Kosinës në Përmet", Restaurimi, 1985, 2.

KISHA E SHËN TODRIT

Kisha e Shën Todrit, në lagjen Kala të qytetit të Beratit, është një kishë njënefëshe, e ndërtuar në mesin e shekullit XVI. Sipas gjurmimeve të bëra, rezulton se ajo është rindërtuar mbi rrënojat e një kishe më të hershme, e cila i përkiste periudhës së antikitetit të vonë. Nga kjo periudhë e hershme ruhet një fragment kolone paleokristiane, e cila ndodhet në dritaren e absidës.

Kisha përbëhet nga naosi, altari dhe hajatet që e rrethojnë nga tre anë. Këtu ndodhet edhe kopja e Epitafit të Gllavenicës, krijim i shquar arti i vitit 1373, në të cilën pasqyrohet Krishti i vdekur, i shoqëruar me mbishkrime në greqisht. Kisha është pikturuar nga Onufri. Fragmente pikturash ruhen kryesisht në absidë në të cilën paraqitet Shën Todri, Shën Vasili i madh dhe Shën Laurenti. Ngjitur faqes veriore të kishës së Shën Todrit ka qënë një kishë tjetër. Sot ajo nuk ka çati, muri verior, perëndimor dhe pjesërisht lindor është rrënuar në një lartësi rreth 1.5 m. Në hapësirën e dritares janë hequr disa gurë.

Muri verior i kishës së Shën Todrit, i ekspozuar ndaj faktorëve atmosferikë, kishte krijuar bark rreth 12 cm. Gjithashtu dherat brenda kishës ishin të pasistemuara. Duke qenë se kisha ngjitur ishte e zbuluar, u bë e nevojshme ndërhyrja dhe mbulimi kësaj pjese.

Ndërhyrjet restauruese u përqendruan në konsolidimin e murit verior, i cili përmbante afreske. Faqja e brendshme u ruajt, ndërsa faqja e jashtme u rindërtua duke përdorur përforcime të brendshme. Gjithashtu u rindërtua konstruksioni i çatisë, si dhe u hoq një nef shtesë në veri të kishës, i cili nuk mbarte vlera në vetvete.

THE CHURCH OF ST. THEODORE

The church of St. Theodore, in the neighborhood of Berat Castle, is a one nave church, built in the middle of the sixteenth century. According to the inquiries that were made, it turned out that it was rebuilt on the ruins of an earlier church, which belonged to the late antiquity. From this early period, there has been preserved a fragment of an early Christian column, which is located in the window of the apse.

The church consists of the central nave, the altar and the porches which surround it on three sides. The church has a copy of the Epitaph of the Gllavenicas, a remarkable work of art done in 1373, in which was portrayed the dead of Christ, accompanied by Greek inscriptions. The church is painted by Onufri. The fragments of mural paintings are stored mainly in the apse in which you see St. Theodor, St. Vasil the Great and St. Laurenti.

Adjacent to the northern site of the Church of St. Theodore was another church. Today it has no roof, the northern wall, the west and the east walls partly demolished at a height of about 1.5 meters. Stones were removed from the space where the window is now. The northern wall of the church of St. Theodore, because it was exposed to harsh atmospheric conditions, had a curve about 12 cm. Also the soils within the church were disaggregated. Since the adjacent church that was discovered was uncovered it became necessary to intervene and cover that part.

The restoration interventions were focused on the consolidation of the northern wall, where the frescoes were. The interior surface was preserved, while the exterior





Pamje të kishës (gjendja ekzistuese dhe gjatë punimeve tërestaurimit)

The Church of St. Theodore (the existing situation)

DO NOT COPY



Kisha e Shën Todrit (gjendja ekzistuese)
The Church of St. Theodore (the existing situation)



Kisha e Shën Todrit (projekti i restaurimit)
The Church of St. Theodore (the restoration project)



Pikturë murale në kishën e Shën Todrit
The mural painting in the church of St. Theodore

surface was rebuilt using the internal reinforcements. Also the structural system of the roof was rebuilt, and an additional nave in the north of the church, which had no special values was removed.



Kisha e Shën Todrit (projekti i restaurimit)
The Church of St. Theodore (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Emin Riza. Rilevoi, Vizatoi, Faruk Zarshati. Punimet u kryen nga: Instituti i Monumenteve të Kulturës Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1966.

Bibliografi: Meksi, A., Baçe, A., Riza, E. Berati, Historia dhe arkitektura. Tiranë, 2011, fq. 266. Meksi, A., Thomo, P., "Arkitektura pasbizantine në Shqipëri, kishat njënefëshe", Monumentet, 1980, 19.



Pamje e kishës së Shën Todrit pas restaurimit
The view of the church of St. Theodore after restoration

DO NOT COPY

XHAMIA E BEQARËVE

Xhamia e Beqarëve, e ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX ndodhet në pjesën e poshtme të lagjes Mangalem të Beratit, buzë rrugës kryesore të qytetit, peizazhi i së cilës kurorëzohet me siluetin dinamik të kalasë së qytetit të Beratit. Siç tregon qartë vetë emërtimi i xhamisë, ajo i ka shërbyer rufetit të Beqarëve të kallfave të esnafeve të ndryshme të qytetit. Ndërtimi i xhamisë së Beqarëve në Berat është financuar nga shoqata e zejtarëve beqarë, për ekzistencën e së cilës në vendin tonë gjejmë të dhëna që në shek. XVII. E ndërtuar në terren të pjerrët ajo rezulton me gjysmëkat dhe me zgjidhje arkitektonike të thjeshtë. Pjesa kryesore, faltorja, ka formën e një kubi. Në pjesën veriore është ndërtuar hajati, i cili në të tre krahët kufizohet me harkadë me kolona guri.

Si pasojë e cedimit të terrenit në pjesën qëndrore të portikut tre pjesësh në anën e përparme të objektit, dy kolonat e mesit kishin pësuar ulje, të cilat fillimisht u punteluan për të siguruar ndërtesën. U hartua projekti i restaurimit, i cili kishte për qëllim përforcimin e ndërtesës, mënjanimin e dëmtimeve, rikrijimin e tërësisë strukturale të tij dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme.

Ndërhyrjet nisën me përforcimin e ndërtesës në mënyrë që të përballonte shtytjet që do të lindnin nga heqjet e pjesëve të murit. Më tej u vijua me riformulimin e murit të prishur duke rivendosur gurët e faqes së jashtme në të njëjtat pozicione. Gjithashtu u ndërmorrën punime restaurimi që konsistonin në rimbulimin e çatisë dhe konsolidimin e harkut qendror të fasadës jugore. Pas përfundimit të

THE MOSQUE OF CELIBATES

The Mosque of Celibates was built in the first half of the 19th Century and is located at the lowest part of the Mangalem neighborhood in Berat, by the city's main road, the landscape of which is crowned with the dynamic castle of Berat. As it clearly shows by its name, the mosque has served the rufet celibates of various city guilds. The construction of the mosque of the Celibates in Berat is funded by the association of the single craftsmen, whose existence in our country, is evidenced in the 17th Century. Building the mosque on steep terrain affected the plan which has a simple semi-floor. The main part, the praying chamber has the shape of a cube. In the northern part, the porch was built, which has arcades of stone columns on its three sides. As a result of the the cession of the terrain in the central part of the porch in the front of the building, the two columns in the middle had been structurally damaged. The first step was to strengthen the two columns in order to increase the stability of the building. The restoration project aimed to strengthen (reinforce) the building, to restore the damages, to recreate its structural integrity and to prevent any further damages. The interventions began with the strengthening of the building in order to bear the different increased structural loads that would arise from the removal of the parts of the wall. Then the interventions followed with the reformation of the demolished wall and replacing the stones of the exterior wall in the same positions. Also the roof and the central arch of the southern facade were





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
The views of the building (the existing situation)



Pamje të objektit (gjatë punimeve të restaurimit)
The views of the building (during the restoration work)

DO NOT COPY

punimeve konsoliduese dhe restauruese të arkitekturës, filloi marrja e masave për konservimin e pikturës murale.

restored.
After the implementation of the architectural restoration project, care was taken of the mural paintings, by preserving and restoring them.



Fasada kryesore dhe prerje (projekti i restaurimit)
The main facade and section (the restoration project)



Fasada perëndimore (projekti i restaurimit)
The western facade (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Sulejman Dashi. Vizatoi: A. Qyshka. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1977.

Bibliografi: Meksi, A., "Restaurimi përforcues në Xhaminë e Beqarëve në Berat", Monumentet, 1979, 18.
Meksi, A. Xhamitë e Shqipërisë. Tiranë, 2015.



Fasada Jugore dhe Veriore (projekt i restaurimit)
The Southern and Northern facade (the restoration project)



Pamje e objektit pas restaurimit
The view of the building after the restoration

DO NOT COPY

TEQJA E SHEH DYRIT

Teqja e Sheh Dyrit ndodhet në rrugën e "Barrikadave" në Tiranë dhe ngrihet në pjesën fundore të oborrit. Ajo është shpallur monument kulture në vitin 1963 për vlerat e saj tipologjike. Teqja i përket sektit "Kadri" dhe mendohet se faza e parë e ndërtimit i përket fundit të shek. XVIII apo fillimit të shek. XIX.

Studimi i hollësishëm nxorri në pah tri faza ndërtimi të monumentit. Faza e parë përfshinte mjedisin e teqes, faza e dytë përfshinte ndarjet e sallës së teqes dhe formulimin arkitektonik të dritareve të këtyre mjediseve, ndërsa faza e tretë ka të bëjë me një ndarje të brendshme. Gjithashtu, krahas këtyre fazave, janë kryer edhe ndërhyrje të pjesshme, si mbulimi i shtresës përdhese të mjediseve të katit përdhe me dërrasa, zgjerim dritaresh apo ndërtimi i një blloku murature për të mundësuar ndërtimin e një kanali tymtërheqës për oxhakun e një mjedisi.

Në momentin e ndërhyrjeve restauruese, Teqja e Sheh Dyrit ruante në thelbin e saj kompozicional tiparet themelore të tipit të banesës tiranase. Ndërhyrjet restauruese u përqëndruan fillimisht në prishjen e suvatimeve për të pasur mundësinë e vëzhgimit të teknikës së ndërtimit, zëvendësimin e elementeve të degraduara dhe restaurimin e çatisë.

Në vitin 1983 u bënë ndërhyrje të tjera si pasojë e uljeve të shtyllave të drurit që mbanin strukturën e katit të parë. Këto shtylla u zëvendësuan me të reja. U kryen punime për largimin e ujërave mbitokësore nga struktura e ndërtesës,

THE TEKKE OF SHEH DYRI

The tekke of Sheh Dyrit is located in the "Barrikada" street in Tirana and is built at the rear part of the yard. It was declared a cultural monument in 1963 for its typological values. The tekke regards "Kadri" sect and they say that the first phase of the building belongs to the end of the 18th Century or the beginning of the 19th Century. A detailed study brought to light three phases of construction of the monument. The first phase included the tekke, the second phase included the divisions of the tekke hall, and the architectural formulation of the windows of these premises, while the third phase was the construction of the interior divisions. Also, along these stages, partial interventions were performed, as the restoration of the pavements of the ground floor premises, with boards, the window expansions or the construction of a masonry block to enable the construction of a chimney. At the time of the restoration interventions, the tekke of the Sheh Dyri preserved the compositional features of the characteristic type of the Tirana house. The restorative interventions was focused initially on the spoilage of the plaster in order to have the opportunity to observe the techniques of construction, the replacement and the restoration of degraded elements of the roof.

In 1983, other interventions were performed as a result of the deterioration of the wooden columns that supported the structure of the first floor. These pillars were replaced with new ones. There was also an intervention for the



Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
The views of the building (the existing situation)



Genplani i objektit (projekti i restaurimit)
The general plan of the object (the restoration project)

DO NOT COPY

ndërhyrje restauruese në pjesë të suvatimeve të dëmtuara si dhe punime mirëmbajtjeje në strukturën e çatisë dhe mbulesën e saj.



Planimetria e katit përdhe (projekti i restaurimit)
The plan of the ground floor (the restoration project)



Projekti i restaurimit Emin Riza. Rilevoi, Vizatoi, Tushoi: Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1983.

Bibliografi: Riza, E., "Restaurimi i teqes së Sheh Dyrit - Tiranë", Monumentet, 2002.

drainage system of the building, the restoration of the plaster as well as maintenance interventions for the roof structure and its cover.



Planimetria e katit të I-rë (projekti i restaurimit)
The plan of the 1st Floor (the restoration project)



Detaj i rrethimit (projekti i restaurimit)
The detail of the railing of the courtyard (the restoration project)



Pamje e objektit pas restaurimit
The viewof the building after restoration

DO NOT COPY

BANESA E REXHEP KARAJ, BULQIZË

Banesa është një ndërtim tre katësh prej guri i mbuluar me tjegulla dhe përbëhet nga kati përdhe (katoi), që përdorej për strehimin e bagëtive; kati i parë (dhoma e grave) dhe kati i dytë (dhoma e miqve), ku është dhe telizi i veshur me dërrasë. Banesa është e padatuar, por nga të dhënat gojore mendohet se ndërtimi i saj i përket mesit të shek. XIX.

Problemet që paraqet objekti janë në elementët e drurit, dyert, dritaret, telizi, suvatë, shtresat e dyshemeve të drurit etj. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të objektit, u hartua projekti i restaurimit, i cili parashikonte fillimisht restaurimin e pjesës së mbetur të murit rrethues dhe të murit në hyrjen e objektit. Ndërhyrjet e parashikuara përfshinin kontrollin e gjithë çatisë, rindërtimin e tymarit të oxhakut dhe shtimin e një baxhe në pjesën veriore. U ndërtuan të reja dyert e katoit, dera e oborrit dhe e banesës. Më tej punimet restauruese vijuan me zëvendësimin e dërrasave të dëmtuara të dyshemesë, riparimin e shkallëve prej druri, bërjen e kanateve të reja të dritareve, restaurimin e gjithë elementeve drusorë të telizit, si dhe suvatime të përgjithshme të ambienteve të brendshme. Gjithashtu u rindërtuan shkallët e jashtme prej druri dhe u plotësua me parmakë. Punimet e restaurimit u përqëndruan edhe në qëndrueshmërinë statike të objektit dhe në restaurimin e elementëve arkitektonikë.

THE HOUSE OF REXHEP KARAJ-BULQIZA

The home is a building of three-stories in stone, covered with tiles and includes a ground floor (katoi-crib), used for the livestock housing; The first floor is where the women's rooms are and the second floor, the guests' rooms, is where the teliz-sele covered in boards is located. There is no inscription for the house, but they say that it was built in the middle of the 19th Century.

The problems that the monument had were: the wooden elements, the doors, the windows, the teliz-sele, the plaster, the layers of the wooden floors etc. Based on the existing condition of the building, the restoration project was developed, which originally foresaw the restoration of the left surrounding walls and the wall at the entrance of the house. The interventions provided and included the control of the entire roof, the chimney reconstruction and the addition of a skylight in the north. They built the new doors on the crib, the yard gate and the main door of the house. Further the restoration works have continued with the replacement of the damaged floor boards, the wooden stairs, repair and making of new window frames, the restoration of all elements of timber of the teliz-sele and plastering the interior. They also rebuilt the outer wooden stairs and completed the railings. The restoration work was focused on the static stability of the monument and the restoration of the architectural elements.

DO NOT COPY



Foto të objektit (gjendja ekzistuese)
The view of the building (the existing situation)

PESHKOPI



Planimetria e katit të I-rë dhe të II-të (projekti i restaurimit)
The plan of the I-st and II-nd floor (the restoration project)



Planimetria e katoit dhe prerje tërthore (projekti i restaurimit)
The plan of the crib and cross section (the restoration project)

DO NOT COPY



Fasada lindore dhe jugore (projekti i restaurimit)
The eastern and southern facade (the restoration project)

Fasada veriore (projekti i restaurimit)
The northern facade (the restoration project)



Genplani i objektit (projekti i restaurimit)
The general - plan (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Leonard Suli. Përpunoi dhe tushoi: S. Mata. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e autorit në vitin 1977.

Bibliografi: Thomo, P. Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore. Tiranë, 1981.
Thomo, P., Muka, A. Vendbanime dhe banesa popullore shqiptare, V. 1. Tiranë, 2004.
Arkivi IMK



Foto e objektit (pas restaurimit)
The view of the house after the restoration

MULLIRI I BAJRAM CURRIT, SHOSHAN

THE MILL OF BAJRAM CURRI, SHOSHAN

Monumenti lidhet me disa momente kryesore të jetës së heroit të popullit Bajram Currit dhe njihet nga popullsia e Malësisë së Gjakovës me emrin "Mulliri i Currit". I pozicionuar pranë brigjeve të Valbonës, midis fshatrave Shoshan, Koçanaj e Margegaj, mulliri u ndërtua me kontribut të përbashkët dhe u shfrytëzua për bluarjen e drithit nga banorët e këtyre fshatrave. Në këtë mulli u strehua edhe Bajram Curri për disa vite.

Ndërtesa është dykatëshe, e realizuar me mure guri të lidhura me llaç të bollshëm gëlqereje të një cilësie të lartë. Në katin përdhe janë hajati, dhoma e mullisit dhe ambienti ku janë vendosur dy mullinjtë e bluarjes; ndërsa në katin e parë, ku ka qëndruar Bajram Curri, ka katër ambiente: divanhania, "dhoma e mirë", një dhomë e vogël dhe një nyje sanitare. Zgjidhja funksionale e objektit është shumë e qartë, ndërsa ajo arkitektonike mjaft modeste.

Para restaurimit, monumenti ruante muret perimetralë, një pjesë të konstruksionit të çatisë, një pjesë nga dyshemeja e katit të sipërm, si dhe një pjesë me shtyllë druri, kurorëzuar nga një jastëk druri në katin përdhe, mbi të cilin mbështetej një tra tërthor, dhe mbi të trarët e dyshemesë. Muret e brendshme ndarëse nuk ruhen në asnjë nga të dy katet, por studimi i hollësishëm dhe vëzhgimet në terren bënë të mundur hartimin e projektit të restaurimit.

This monument is associated with several key moments of Bajram Curri, the the real-life hero of the people of the Mountains of Gjakova. The local population there recognizes the mill by the name "The Mill of Curri". Located near the shores of Valbona, between the villages of Shoshan, Koçanaj of Margegaj, the mill was built for one common input and was used to grind the grain from the residents of these villages. For several years Bajram Curri also took shelter in this mill.

The building is two-story, built with stone walls and plenty of lime mortar of a high quality. On the ground floor is the porch, the room of the miller and the space that accommodates the two grinding mills. Also on the ground floor, where Bajram Curri, stayed, there are four living spaces: divanhane-the upper floor corridor, "the living room", "dhoma e mirë" -the best room, a small room and a bathroom.

The functional zoning of the building is very clear, while its architectural design is quite modest. Before the restoration, all that were left from the monument were: the perimeter walls, a part of the construction of the roof, a part of the flooring of the upper floor, and a piece made of wooden pillars, crowned by a cushion of wood on the ground floor, on which rested a transverse beam, and above that the flooring beams.



Pamje të gjendjes ekzistuese
The view of the existing situation



Grafikë e mullirit të Bajram Currit
Surement of monuments in ground



Pamje e objektit (pas restaurimit)
View of the mill of Bajram Curri

DO NOT COPY

Punimet e restaurimit u përqendruan në rindërtimin e çatisë, të dyshemesë dhe tavaneve të katit të sipërm, të mureve ndarës të brendshme si dhe në pajisjen e monumentit me të gjitha elementet arkitektonike dhe funksionale. Ky projekt synonte që t'i riktheheshin monumentit vlerat funksionale e arkitektoniko-konstruktive dhe estetike që ka pasur në kohën kur në të ka qëndruar Bajram Curri. Me restaurimin që iu bë monumentit, ky i fundit rifitoi vlerat arkitektonike, funksionale dhe estetike që pati humbur.



Planimetritë e mullirit (projekti i restaurimit)
The plans of the mill (the restoration project)



Konstruksioni i çatisë dhe detaje konstruktive (projekti i restaurimit)
The structural project of the roof and the structural details (the restoration project)

There were no interior dividing walls left in either of the 2 floors. The detailed studies and the field surveys made it possible to design the restoration project. The restoration interventions were focused on the reconstruction of the roof, of the floor and the ceiling of the upper floor, the walls dividing the interior spaces and the restoration of all the architectural and functional elements of the monument. This project aimed to return to the monument all the architectonic, structural, and functional importance that it had while Bajram Curri lived there. All the above was made possible with the implementation of the restoration project.



Prerje gjatësore e mullirit (projekti i restaurimit)
The longitudinal section of the mill (the restoration project)



Fasada e mullirit (projekti i restaurimit)
The facade of the mill (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Dhimitër Kotani. Rilevoi, Tushoi, Përpunoi: F. Karapici, Dh. Kotani, K. Qatipi. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1980.

Bibliografi: Kotani, Dh., "Mulliri i Bajram Currit dhe restaurimi i tij", Restaurimi, 1984, 1.

DO NOT COPY

BANESA E XHEMILE HASËS

Banesa shtrihet thuajse në periferi të lagjes "Priftakë", buzë rrugës së shtruar me kalldrëm. Banesa është dykatëshe, dykthinëshe, e ndërtuar me mure qerpiçi, e cila mbështetet në pjesën e poshtme mbi një bazament me muraturë guri. Ambientet e katit të sipërm paraprihen nga galeria prej druri, e cila del konsol tej mureve perimetralë. Në galeri janë diferencuar hapësirat e shërbimit nga ato të ndenjes, të cilat dallohen në pamjen e jashtme për nga trajtimi, numri dhe vendosja e dritareve. Banesa nga ana perëndimore paraprihet nga oborri, i cili është i qarkuar me mure rrethuese pjesërisht prej qerpiçi. Problematika që paraqiste banesa në prag të restaurimit kishte të bënte me dëmtimin e tjegullave të çatisë, që sillte depërtimin e reshjeve në brendësi, duke shkaktuar dëmtime të elementeve konstruktive e arkitektonike të banesës, si dhe me degradimin e elementeve drusore për shkak të mosmirëmbajtjes. Gjithashtu, muret rrethuese dhe porta e oborrit ishin të shembura në një masë të konsiderueshme. Projekti i restaurimit parashikonte restaurimin e shkallëve të jashme prej guri, e çatmave në tërësi, dyshemeve, dyerve, dritareve, shkallëve të brendshme prej druri, galerisë prej druri, si dhe të gjithë elementeve karakteristike të banesës. Gjithashtu, punimet e restaurimit u zgjeruan edhe në oborrin e banesës, duke restauruar muret rrethuese sipas gjurmëve ekzistuese. Muret rrethuese u mbuluan me çati me tjegulla vendi si dhe u restaurua porta e oborrit.

THE HOUSE OF XHEMILE HASA

The house is situated almost on the suburbs of the "Priftakë" neighborhood, alongside the cobbled road. The house is two story, with two rooms, built with adobe walls, which rests on a pedestal with masonry stone. The upper floor of the premises is preceded by a wooden gallery, which is cantilevered beyond the perimeter walls. In the gallery the service spaces are differentiated from the living spaces, which differ in appearance to the treatment, number and placement of windows. The house on its western side has the courtyard which is surrounded by the perimeter adobe walls. The problems posed prior to the house restoration had to do with damage to roof tiles, which in turn allowed precipitation to infiltrate the interior spaces, causing damage to the architectural and structural elements of the house, and also damaging the wooden elements for lack of maintenance. Also, the surrounding walls and the courtyard gate had considerable damage. The restoration project provided the restoration of the outer stone stairs, the floors, doors, windows, interior wooden stairs, the wooden gallery and all the characteristic elements of the house. Also, the restoration work was extended into the courtyard of the house, restoring the surrounding walls according to the existing footprint. The walls were covered by a new roof built with local tiles, and also the court gate was restored.





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
The views of the building (the existing situation)

DO NOT COPY





Planimetritë e objektit (projekti i restaurimit)
The plans of the building (the restoration project)



Fasada anësore dhe kryesore (projekti i restaurimit)
The lateral facade and the main facade (the restoration project)



Fasada anësore dhe e pasme (projekti i restaurimit)
The lateral facade and rear facade (the restoration project)

DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Leonard Suli. Vizatoi, S. Mata. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1977.

Bibliografi: Thomo, P., Muka, A. Vendbanime dhe banesa popullore shqiptare, V. 1, Tiranë, 2004, fq. 249.
Arkivi IMK



Pamje e objektit (pas restaurimit)
The view of the building after restoration

BANESA E KAZAFER ASLLANIT, OSTREN I VOGËL

Banesa është e vendosur në qendër të fshatit Ostren i Vogël dhe është një ndërtim kullë trekatëshe me shkallë të jashtme. Kati i parë është i ndërtuar me mure guri, breza druri dhe llaç balte, ndërsa dy katet e tjera janë ndërtuar me mure qerpiçi, llaç balte e breza druri. Hyrja në katin e poshtëm bëhet nëpërmjet një dere të mbuluar me hark guri, në katin e parë ngjitesh me një palë shkallë guri dhe në katin e dytë me një palë shkallë druri. Në katin e sipërm ndodhen dhoma e miqve, dhoma e fjetjes dhe ambienti sanitar.

Banesa u gjet në gjendje mjaft të degraduar dhe kishte nevojë për ndërhyrje konservuese dhe restauruese. Projekti i restaurimit përfshinte plotësimin e mungesave në muraturën e katit përdhe, restaurimin e çatisë, ndërtimin e një dyshemeje të re me trarë me thupra, vendosjen e dritareve të reja sipas modelit origjinal, meremetimin e gjithë elementeve prej druri të degraduar, suvatime të brendshme dhe restaurimin e shkallëve prej druri, etj. Gjatë restaurimit u tregua kujdes i veçantë për ruajtjen e vlerave dhe elementeve origjinale të banesës.

THE HOUSE OF KAZAFER ASLLANI, OSTREN I VOGËL

The house is located in the center of the "Ostren i vogël" village, and is a three-story building of the tower typology and has a staircase on its exterior. The first floor is built with stone walls, wooden courses and clay mortar, while the other two floors were built with adobe walls, by wooden bands and mortar clay. You enter the ground floor through a door covered by a stone archway. You reach the first floor by a stone staircase, and the second floor by a wooden staircase. In the upper floor you find the guest room, the bedroom and the bathroom. The house was found in very poor condition and needed restoration interventions. The restoration project included the completion of the gaps in the masonry walls of the ground floor, the restoration of the roof, the building of a new floor with new beams tied together by withe, new windows replicating the original windows, the restoration of all the wooden elements that had deteriorated, the interior plaster and the restoration of the wooden stairs, etc. During the implementation of the restoration project special care was taken to preserve the values of the original elements of the house.

DO NOT COPY



Pamje e objektit (gjendja ekzistuese)
The view of the building (the existing situation)



Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
The views of the building (the existing situation)











Planimetria kati përdhe, kati I, kati II (projekti i restaurimit)
The plans of the ground Floor, 1sr Floor, 2nd Floor (the restoration project)

Fasadat e objektit (projekti i restaurimit)
The facades of the building (the restoration project)

DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Genc Samimi. Vizatoi: Faruk Zarshati. Përpunoi: Faruk Zarshati, Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e autorit në vitin 1975.

Bibliografi: Thomo, P., Muka, A. Vendbanime dhe banesa popullore shqiptare, V. 1. Tiranë, 2004.
Arkivi IMK



Pamje e objektit pas restaurimit
The view of the house after restoration

KOMPLEKSI I MARKAJVE

Kompleksi i Markajve ndodhet në fshatin Zerqan të Peshkopisë dhe është i përbërë nga disa ndërtime të periudhave të ndryshme, ku ndërtimi kryesor është kulla katërkatëshe e ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX. Në vazhdim të saj kanë qënë fillimisht katër të tilla, që lidheshin me njëra-tjetrën me anë të një çardaku të mbyllur në katin e tretë dhe të katërt. Në fazën e dytë është ndërtuar banesa dykatëshe me çardak e pozicionuar në anën perëndimore të kompleksit. Brenda mureve rrethuese të kompleksit ndodhen ambientet ndihmëse. Kompleksi ka dy porta oborri, një nga ana lindore dhe një te banesa me çardak e fazës së dytë.

Gjatë inspektimit në terren u përcaktua problematika te kulla katërkatëshe, e cila nuk ishte në gjendje të mirë teknike dhe paraqiste dëmtime në qoshen juglindore, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e monumentit, ndërsa banesa dykatëshe me çardak mbuluar me rrasa guri paraqiste nevojë për ndërhyrje restauruese në çati, suva, shtresa e në çardak. Projekti i restaurimit parashikoi ndërhyrjen në qoshen juglindore për të siguruar qëndrueshmërinë

THE COMPLEX OF MARKAJVE

The complex of Markajve is located in the village Zerqan, Peshkopi and is comprised of several buildings of different periods, where the main building is a four-story tower built in the first half of the 19th Century. There were initially four houses connected to each other through a closed cardak on the third and fourth floor. In the second stage, the two-story house was built with a cardak (lobby) situated on the western side of the complex. Inside the surrounding walls of the complex there are the auxiliary premises.

The complex has two gates, one on the east and one to the house with a cardak of the second phase.

During the field survey the need for intervention was determined for the four-story tower, which was not in good technical condition and had suffered damages in the southeast corner, threatening the stability of the monument. Meanwhile the two-story house with çardak-moound covered with stone slab presented the need for restoration interventions on the roof, plaster, and the layer in the çardak-moound. The restoration project also



Fasada të objektit (gjendja ekzistuese dhe projekti i restaurimit)

The facades of the building (the existing situation and the restoration project)





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)

The views of the building (the existing situation)



Genplani i Kompleksit të Markajve (projekti i restaurimit)

The general plan of the complex of Markajve (the restoration project)

DO NOT COPY

e objektit, restaurimin e gjithë elementëve të degraduar, duke respektuar teknikën origjinale, ndërtimin e shkallës së drurit dhe restaurimin e çardakut. Ndërsa në banesën dykatëshe u parashikua restaurimi i hajatit dhe i gjithë elementëve të tij, restaurimi i çardakut dhe i çatisë. Gjithashtu, u bënë ndërhyrje për restaurimin e portës së oborrit, mureve rrethuese, punime mirëmbajtjeje në hapësirat që kishin nevojë, fugatimi i faqeve të brendshme e i suvatimeve të jashtme. Gjatë punimeve të restaurimit një kujdes i veçantë iu kushtua respektimit të elementeve origjinale dhe teknikës së tyre të ndërtimit.

stated the need for intervention on the southeast corner in order to ensure the stability of the building and the restoration of all degraded elements, while respecting the original construction technique, and building the wood staircase and the restoring of the çardak-moound. While in the two-story house recommendations were made for the restoration of the hajat-colonnaded courtyard and all its elements, the restoration of the çardak-moound and the roof. Also, interventions were made for the restoration of the gate, the surrounding walls, maintenance work in areas in need, restoring the internal surfaces of the walls and the plaster on the exterior walls. A major effort was made in respecting the original elements and their original construction techniques.





Fasada të objektit (projekti i restaurimit)
The facades of the building (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Leonard Suli. Rilevoi: Bashkim Penxha, Sokol Zaloshnja. Përpunoi: Sokol Zaloshnja. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e autorit, 1987
Bibliografi: Arkivi IMK



Planimetritë dhe pamjet (projekti i restaurimit)
Plans and views (the restoration project)



Pamje e objektit pas restaurimit
The views of the building (after restoration)

DO NOT COPY

KOMPLEKSI I SALI DHE AQIF KADRIUT, BELLOVË

Ansambli ndërtimor i Sali dhe Aqif Kadrisë është monument kulture i kategorisë së I-rë. Është i pozicionuar në qendër të fshatit Bellovë, në një terren me pjerrësi relativisht të vogël. Ky kompleks përbëhet prej dy blloqesh kryesore dhe prej ambienteve ndihmëse, të qarkuar me mur rrethues. Kompleksi është dëshmi e një ekonomie fshatare mjaft komplekse, duke përfshirë: kullën e mikut me "sharapoll", shtëpinë e zjarrit, ambientet e tjera të punës, hambare, depo dhe kullën e barit. Banesa e parë ndodhet afër derës së oborrit, është trekatëshe, ku në katin përdhe strehoheshin bagëtia, duke qënë se dy katet e sipërme shërbenin për zhvillimin e jetës familjare. Mbi katin e sipërm ngrihet sharapolli, ose një kullë e vogël që shërben për vrojtim e mbrojtje. Çardaku i mbyllur në katin e tretë është mjaft origjinal dhe ruhet në gjendje të mirë, është i shtruar me dhé, pa tavan dhe ka oxhak të gdhendur.

Gjatë kohës, në këtë kompleks janë bërë ndërhyrje transformuese duke cënuar në njëfarë mase zhvillimin planimetrik fillestar dhe kanë ndikuar në arkitekturën e pamjes së jashtme. Përveç blloqeve kryesore në një fazë tjetër janë ndërtuar dhe disa ambiente ndihmëse njëkatëshe në brendësi të oborrit.

Për sa i përket gjendjes së monumentit, probleme paraqiste muratura prej qerpiçi dhe muratura prej guri në pjesën e sharapollit. Gjithashtu dëmtime u vunë re edhe në pjesën e mbulesave të çative dhe në konstruksionin e tyre. Nevojë

THE RESIDENTIAL COMPLEX OF SALI AND AQIF KADRIU, BELLOVA

The residential complex of Sali and Aqif Kadri is a cultural monument of the 1st category. It is positioned in the center of the village Bellova, on a sloping terrain. This complex is composed of two main blocks and auxiliary spaces, encircled by the surrounding walls. The complex is the evidence of the rural complex economy, including: the guest tower with sharapoll-turret, the fire house, spaces for working, the barns, the warehouses and the tower of the grass. The first house is located near the gate of the courtyard, a three-story building, where the cattle are housed on the ground floor, while the two upper floors serve as living quarters. On the upper floor is built the sharapoll-turret, or a small tower that serves for protection purposes (viewing in distance). The enclosed çardak-moound on the third floor is original and preserved in good condition, it is paved with soil, no ceiling and has a carved chimney.

The different transformations made over the course of the years have changed the initial plan and also have affected the exterior architecture of the complex. Except for the main buildings, 1-story auxiliary blocks in a later phase have been added inside the courtyard. The adobe walls, the stone walls and the roof layers and its structural system were damaged. The windows, doors, wall cabinets and all their architectural elements were also in need of an intervention. The restoration interventions were focused on restoring the stability of the complex of buildings





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
Views of the building (the existing situation)

DO NOT COPY

për ndërhyrje restauruese kishin edhe elementet, si dyert, dritaret, tymarët, dollapët e murit etj.
Ndërhyrjet restauruese u përqendruan në sigurimin e qëndrueshmërisë së objektit dhe restaurimin e të gjitha elementeve origjinale e karakteristike të banesës. Banesa është një tip i rrallë dhe me elemente të vjetër që i shtojnë vlerat arkitektonike monumentit.

and on the restoration of all the characteristic original elements of the house. The house is of a rare type and the old architectural elements add value to its architecture.

DO NOT COPY



Planimetritë e katit përdhe, të I-rë dhe të II-të (gjendja ekzistuese)
The plan of the 1st Floor, 2nd Floor, 3rd Floor (the restoration project)



Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
Views of the object (the existing situation)



Fasada veriore (projekti i restaurimit)
The northern facade (the restoration project)



Fasada jugore (projekti i restaurimit)
The southern facade (the restoration project)



Fasada lindore (projekti i restaurimit)
The eastern facade (the restoration project)



Aksonometri e kompleksit të banimit
The axonometric view of the residential complex



Fazat ndërtimore të kompleksit të banimit
Construction phases of the residential complex





Pamje të kompleksit pas restaurimit
Views of the complex after restoration

DO NOT COPY



Planimetria e katit përdhe (projekti i restaurimit)
The plan of the ground floor (the restoration project)



Planimetria e katit të I-rë (projekti i restaurimit)
The plan of the 1st Floor (the restoration project)



Planimetria e katit të II-të (projekti i restaurimit)
The plan of the 2nd Floor (the restoration project)



Planimetria e katit të III-të (projekti i restaurimit)
The plan of the 3rd Floor (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Leonard Suli, B. Spahiu. Rilevoi: Bashkim Penxha. Vizatoi dhe tushoi: Faruk Zarshati. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e autorit në vitin 1984.

Bibliografi: Thomo, P., Muka, A. Vendbanime dhe banesa popullore shqiptare, V. 1. Tiranë, 2004.
Arkivi IMK



Pamje të kompleksit pas restaurimit
The views of the complex after restoration

DO NOT COPY

BANESA E LIPE KOTES

Banesa e Lipe Kotes ndodhet në një nga lagjet e vjetra të qytetit të Korçës dhe daton në vitin 1842. Banesa është dykatëshe dhe hyrja qendrore, me mbulesë harku në katin përdhe mbrohet nga një harkadë me tre harqe. Ajo të fut në një korridor qendror, të shtruar me plloça guri, ku dalin dyert e mjediseve që ai ndërlidh. Kati përdhe përmban katër mjedise, dy nga të cilat përdoren për banim dhe dalin në ballë të ndërtesës, ndërsa dy të tjerat, të vendosura në pjesën e prapme, përdoren si qilarë. Dhoma në krahun e majtë ruante karakteristikat e saj origjinale në gjendjen fillestare, e shtruar me dysheme dhe e pajisur me tavan dërrase.

Ndërlidhja mes kateve bëhet me anë të një shkalle druri. Kati i sipërm ka të njëjtin kompozim planimetrik si kati përdhe. Dallohet trajtimi i veçantë dekorativ i ambientit qendror ose çardakut. Në kompozimin planimetrik e vëllimor është arritur një skemë simetrike, ku në qendër të kompozimit janë vendosur sallonet qendrore, nga të cilat shpërndahen hyrjet për në mjediset e tjera të banesës. Në pamjen e jashtme, skema simetrike realizohet me anë të theksimit të pjesës qendrore, ndërsa në të dy krahët dalin vëllime simetrike. Një skemë e tillë të kujton variantet e banesave më çardak në qendër, të përhapura në qytetet shqiptare, por ky rast mban në vetvete fillimet e një procesi transformimesh në banesë, që karakterizohet nga futja e koncepteve dhe tipareve të reja në arkitekturë.

Banesa kishte pësuar dëmtime serioze të gjendjes statike dhe transformime të gjendjes fillestare. Punimet e restaurimit synonin konsolidimin e konstruksionit dhe rikthimin në formën fillestare të disa njësive kompozicionale, duke qenë një nga shembujt e pakët të

THE HOUSE OF LIPE KOTE

The house of Lipe Kotes is located in one of the old quarters of the city of Korça and dates back to the year 1842. Its structure consists of two stories with a central entrance covered by an arch on the ground floor and protected by an arcade of three arches. As you pass through the door you enter the central hall, paved with stone slate, where the doors of the surrounding living areas connect.

The ground floor is composed of four rooms, two of which are used for residential living in the front of the building, while the other two, located on the back, are used as cellars. The original architectural characteristics of the room on the left wing of the building have remained intact.

A wooden staircase connects the two floors. The Upper Floor Plan has the same plan as the Ground Floor. A distinction of the upper floor is that it has special decorative motifs in the area of the çardak-mound.

The symmetrical scheme prevails in the plans and massing (volumetric composition) of the house. In its exterior design, the symmetry is realized by emphasizing the central part of the building, while symmetrical volumes are extended in both its wings.

The house had suffered serious damage and malformations to its original condition. The restoration work aimed at the consolidation of the structure and a return to the original shapes of some of the compositional units, since this house is one of the rare examples of this type remaining in Korça.

The porch with the triple arcade on the ground floor and the çardak upstairs, which had been enclosed as a result of previous remodels over the years, were opened and all the

DO NOT COPY



Foto e objektit para restaurimit
View of the building before the restoration



Mbishkrimi me datën 1842
Inscription with the 1842 date



Projekti i restaurimit: Planimetria e katit të I-rë
Architectural Project of Restoration: First floor plan

këtij tipi, të mbetura në qytetin e Korçës. U hap portiku me harkadën treshe në katin përdhe dhe çardaku në katin e sipërm, të mbyllura si pasojë e ndërhyrjeve transformuese ndër vite si dhe u restauruan gjithë elementet origjinale të banesës. Gjatë restaurimit u ruajtën shumë elemente arkitektonike e dekorative origjinale.

original elements of the house are restored. Many original architectural and decorative elements were preserved during the restoration.



Fasada kryesore para restaurimit
View of the house before the restauration



Fasada kryesore (projekti i restaurimit)
Main facade (the restauration project)





Detaje konstruktive dhe arkitektonike
Architectural and structural details



Projekti: Rilevimi: Prof. Dr. Pirro Thomo, Dhimitraq Koti. Projekti i restaurimit: Pirro Thomo. Punimet u kryen nga: Atelieja e Korçës nën drejtimin e autorit në vitin 1967.

Bibliografi: THOMO, P., "Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre",
Monumentet, 1982, 1.
THOMO, P. Korça, Urbanistika dhe Arkitektura. Tiranë, 2012.



Pamje e objektit pas restaurimit
View of the building after the restoration

DO NOT COPY

BANESA E DHIMITRAQ TRESKËS

Banesa e Dhimitraq Treskës është e datuar në vitin 1850, sipas datës së gdhendur mbi portën e hyrjes kryesore. Është një banesë që del me dy faqe drejtpërdrejtë në kryqëzimin e dy rrugicave, ashtu si edhe dy hyrjet për në banesë. Banesa e Dhimitraq Treskës është një ndërtim dykatësh me mure guri, gjë që i ka dhënë një karakter të mbyllur e masiv. Sipas të dhënave, kjo banesë ka qënë "mysafiranja" e banesës së vjetër të Vangjush Mios, dhe lidhet me të me anë të një avllie ku është hapur një portë, e cila ruan tiparet e saj origjinale. Pavarësisht se janë ndërtuar në distancë shumë të vogël kohore, ato ndryshojnë shumë mes tyre për nga pikëpamja tipologjike.

Në përgjithësi monumenti nuk ishte në gjendje të keqe, me përjashtim të murit perëndimor, por vlera e saj ishte cënuar nga dëmtimet e suvatimeve të jashtme të mëvonshme dhe nga volumet shtesë. Projekti i restaurimit u përqendrua kryesisht në pastrimin e suvatimeve të dëmtuara, rifugatimi i gurëve sipas gjurmëve ekzistuese, konsolidimi i murit perëndimor, plotësimin me dritare të ambienteve, prishjen e rikompozimin e ambienteve ndihmëse dhe ribërjen e avllisë perëndimore që e lidh atë me banesën e Vangjush Mios.

THE HOUSE OF DHIMITRAQ TRESKA

The house of Dhimitraq Treska is dated the year 1850, as inscribed on the main entrance of the gate. It's a two-story building with stone walls, and according to the records, this house has been called "mysafiranja" (or possibly a guest house) of the old residence of Vangjush Mio. The two buildings are connected by an open courtyard that has an opened door, with its original features well preserved. Despite the fact of the 2 structures being built within the same short time span, they differ dramatically in typological terms.

In general the monument was not in bad condition, with the exception of the western wall, but its value was affected by the external damages of the exterior plaster and the additional volumes. The restoration project was focused on the cleaning of the damaged plaster, the consolidation of the western wall, the completion of the decorations of the windows, the demolition and the redesign of the auxiliary premises and the relandscaping of the west yard which connects it with the house of Vangjush Mio.





Pamje të objektit dhe të portës (gjendja ekzistuese)

The views of the house and the main entrance (the existing situation)

DO NOT COPY

KORÇË



Fasada kryesore (projekti i restaurimit)
The main facade (the restoration project)



Fasada anësore (projekti i restaurimit
The lateral facade (the restoration project)



Planimetritë e banesës (projekti i restaurimit)
Plan of the house (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Pirro Thomo. Rilevoi dhe Vizatoi: Dh. Koti. Punimet u kryen nga: Atelieja e Korçës në vitin 1982.
Bibliografi: Thomo, P. Korça. Urbanistika dhe Arkitektura. Tiranë, 2012, fq. 111-113.
Arkivi IMK





Pamje e objektit pas restaurimit
The view of the building after restoration

DO NOT COPY

BANESA E PIKTORIT TË POPULLIT VANGJUSH MIO

Banesa e piktorit të popullit Vangjush Mio ndodhet në një nga lagjet e vjetra të "Varoshit" në qytetin e Korçës. Është një banesë dykatëshe, me planimetri në formën e shkronjës "L", që i përkiste fillimisht tipit të hapur me hajat në katin përdhe dhe me çardak në katin e dytë. Përbëhet nga "dhoma e miqve", "studioja" dhe "dhoma mbi pus", të cilat përfaqësojnë në vetvete dhe fazat e ndryshme ndërtimore të banesës.

Në prag të restaurimit, ndërtesa kishte arritur në gjendje mjaft të degraduar dhe nga ana tjetër, tiparet e saj fillestare i kishte të transformuara si pasojë e ndërhyrjeve të njëpasnjëshme ndër vite. Gjatë sondazheve dhe zhveshjes së objektit u zbuluan elemente e të dhëna të shumta që e bënin të lehtë dhe të sigurtë rikthimin në formën fillestare. Në këto rrethana, studimi për restaurimin e banesës u shty tej kufirit fillestar për një ndërhyrje të thjeshtë konservuese dhe konsolidimi statik të ndërtesës. Zbulimi i datës 1841, e cila i përkiste fazës së dytë ndërtimore, fitonte një rëndësi të veçantë, jo vetëm për faktin se është data më e vjetër e zbuluar deri më sot në qytetin e Korçës, por se ajo shërben si një pikë e sigurtë referimi për përcaktimin kohor të zhvillimit të banesës korçare dhe hidhte dritë mbi shtrirjen gjeografike të tipit të banesës me çardak, prandaj, kthimi i saj në gjendjen fillestare krijon një pikë referimi të sigurtë për studimet e mëtejshme rreth karakterit të banesës korçare në gjysmën e parë të shek. XIX.

Ripunimi i projektit fillestar konsistonte pikërisht në evidentimin e fazave të ndryshme ndërtimore dhe tipareve arkitektonike të çdo faze. Punimet restauruese u ndanë në

THE HOUSE OF THE FAMOUS PAINTER VANGJUSH MIO

The house of the folk painter, Vangjush Mio is located in one of the oldest quarters of "Varosh" in Korça. It's a two-story house, with a layout in the shape of the letter "L", which originally belonged to the type with an open porch on the ground floor and with a çardak-mound the second floor.

The rooms of the house consist of: The Guest Room, The Atelier Room and The Room over the Well, the rooms each representing the various stages of the construction of the house. Before the restoration, the building was badly deteriorated because the original features had been rather carelessly transformed as a result of a series of remodels over the years. During surveys and uncovering the site, elements and various data were discovered that made it easier and safer to return the house to its original condition. In these circumstances, the study for the restoration of the house was extended beyond the initial limit for a simple intervention and to merely maintain the static consolidation of the building.

The discovery of the date of 1841, as being attributed to the second phase of construction,gave it special significance, not only because that is the oldest discovered date in the city of Korça, but also because it serves as a pinpoint on a Timeline as a reference for determining the time when houses in Korça developed. Further, it helps to determine the geographical scope of the type of houses with a çardak. The return of its original condition creates a reliable benchmark for further studies about the character of the houses of Korça in the first half of the 19th century





Foto të vjetra të banesës dhe elemente të zbuluara nga sondazhet

Old photos of the building and elements discovered during the survey

DO NOT COPY

punime të konsolidimit të strukturave të dëmtuara dhe në punime vlerësuese të monumentit. U çlirua banesa nga shtesat dhe mbylljet e dritareve, oxhaqeve e nikeve. Gjithashtu, u realizua hapja e çardakut, rikonstruksioni i qoshkut, riformulimi i pamjes lindore etj. Gjatë punimeve të restaurimit, kujdes i veçantë iu kushtua ripërtëritjes së elementeve morfologjike të banesës.

(1800's). The revision of the initial project consisted specifically of the identification of the different phases of construction and architectural features of each stage. The restoration work was divided into (1) consolidating the damaged structures and (2) evaluating the monument. The various incongruent additions, the closures of windows of the chimneys and of the niches were all demolished and thereby eliminated from the original house structure. At that same time, the çardak was opened, the elevated platform (approx. 40 cm higher than the main floor) was reconstructed and the Eastern Elevation was restored to its original appearance. During the restoration work, special attention was paid to the morphology (the study of the proper forms and elements) of the original house.



Planimetria e katit të I-rë para dhe pas restaurimit
The plan of the first floor before and after the restoration



Detaje konstruktive dhe arkitektonike
Architectural and structural details of the project







Foto të vjetra të banesës dhe elemente të zbuluara nga sondazhet
Old photos of the building and elements discovered during the survey

DO NOT COPY





Prerje A-A, para dhe pas restaurimit

A-A Section of the building before and after the restoration





Fasada lindore, para dhe pas restaurimit

The eastern facade, before and after the restoration







Foto të Studios së Piktorit

Photos of the Painter's Atelier

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje të objektit pas restaurimit
View of the house after the restoration

Projekti i restaurimit: Rilevimi: Prof. Dr. Pirro Thomo, Dhimitraq Koti, Bashkim Penxha. Projekti i restaurimit: Prof Dr. Pirro Thomo. Punimet u kryen nga: Atelieja e Korçës nën drejtimin e autorit në vitin 1976.

Bibliografi: THOMO, P., "Restaurimi i shtëpisë së Vangjush Mios", Monumentet, 1979, 18.

PAZARI I KRUJËS

Pazari i Krujës është pjesë përbërëse e qytetit dhe ai fillon gjatë rrugës, aty ku sot është qendra e qytetit dhe zhvillohet sipas një vije të lakuar e përfundon deri pranë hyrjes kryesore të kalasë. Koha e fillimit të ndërtimit të këtij ansambli nuk dihet me saktësi. Nga ana tipologjike dyqanet e Pazarit të Krujës janë më të hershmit. Mendohet se pjesa më e madhe e këtij ansambli duhet t'i përkasë shekujve XVIII-XIX.

Rruga kufizohet nga të dy anët prej vargjeve të dyqaneve bashkëngjitur dhe kundrejt njëri-tjetrit. Terreni i pjerrët ka kushtëzuar ndërtimet në formë blloqesh prej dy a më shumë dyqanesh me shkallëzime, si dhe karakterin e ndryshëm të ndërtimeve të vargut të sipërm me atë të poshtmin, në kompozimin vëllimor të ambienteve e të formës së dyqaneve duke mbetur numri dhe funksioni i tyre i njëllojtë për të dy vargjet. Karakteristika konstruktive e këtij ansambli është ndërtimi me muraturë guri i pjesës fundore të dyqaneve, kurse konstruksioni i mureve të parmë të të cilëve është me skelet druri veshur me dërrasa. Konstruksioni i çatisë del me një strehë të gjerë dyfishe, ku radha e parë formohet nga zgjatimi i trarëve të tavanit, ndërsa e dyta nga zgjatimi i binarëve nën shtresën e petavrave.

Në prag të restaurimit, ky ansambël ishte në gjendje mjaft të keqe teknike dhe praktikisht thuajse tërësisht i braktisur. Të gjitha strukturat mbajtëse si dhe elemente të ndryshme, si taraba, qepena, dyer etj. ishin në degradim të plotë. Nga ansambli i këtij pazari kishin mbetur vetëm tri

THE BAZAAR OF KRUJA

The Bazaar of Kruja is part of the city and starts along the way where the center of the city is today and follows a curved line that ends up near the main entrance of the castle. The beginning of the construction of this ensemble is not precisely known.

Typologically, the shops of the Bazaar of Kruja are considered as the oldest. It is believed that the majority of the ensemble belongs to the 18th & 19th Centuries. The street is bordered on both sides by attached shops. The steep terrain has limited the construction in the form of blocks of two or more shops with indentations. This has contributed to the different characteristics in the architectural articulation of the first and second floor of the shops, while preserving the function and the number of the floors on both sides of the street. Among the structural details of this ensemble are the stone masonry walls of the lower parts of the shops, while the front walls of the shops are built in wooden frame with wooden boards. The roofs are built with a double-wooden shelter, the first row being formed from the extension of the beams of the ceiling, while the second row is formed from the extensions of the beams of the roof elements. Immediately prior to the restoration, this ensemble was in very bad shape and almost abandoned. All the bearing structural elements, like taraba-wooden shutters were completely deteriorated. The remaining sections from the bazaar were divided in three groups, while all the other sections were demolished down to the basement. Based on the above situation it was







Pamje të gjendjes ekzistuese
Views of the existing situation

DO NOT COPY

grupe, ndërsa pjesa tjetër ishte e rrafshuar deri në themel. Në këto kushte u vendos restaurimi i këtyre tre pjesëve.
Pas dokumentimit të imët grafik, përshkrimor e fotografik si dhe studimit të imët të karakterit dhe të zhvillimit në kohë të këtij ansambli, u hartua projekti i restaurimit. Bazuar në kushtet e gjendjes ekzistuese dhe në vlerat e këtij ansambli, projekti i restaurimit u udhëhoq nga këto kritere: rindërtimi i tre blloqeve të ansamblit duke respektuar kompozimin vëllimor dhe planimetrik, formulimin arkitektonik të elementeve, teknikën dhe materialet origjinale. I vetmi ndryshim në skemën planimetrike qe bashkimi në disa raste i dy apo tri dyqaneve në një njësi të vetme vëllimore.
Pazari i vjetër i Krujës, pas restaurimit, përbën një vlerë të rëndësishme për historinë e arkitekturës sonë, duke qenë tipologjikisht shembull i formave më të lashta të kësaj kategorie ndërtimesh.

decided the restoration of only these three groups.
After a detailed descriptive, graphic and photographic documentation was made, a finely detailed survey of the character and development in time of this ensemble was prepared for the restoration project. The criteria that led the restoration project were: the reconstruction of the three blocks of the ensemble respecting the original volumes and plans of the original composition, as well as the architectural elements and original construction techniques. The only change made to the original plan was the union of two or three shops in some cases.
The Bazaar of Kruja, after the restoration, now represents a very important monument in the history of our architecture as it is an example of the ancient types of this category of buildings.
The restoration interventions were implemented in 1965-1966.



Pazari i Krujës
The Bazaar of Kruja



Fasadat dhe planimetritë e dyqaneve (projekti i restaurimit)
The facades and the plans of the shops (the restoration project)







Fragment nga projekti i restaurimit
The excerpts from the restoration project

DO NOT COPY









Fragmente nga projekti i restaurimit

The excerpts from the restoration project





Pamje të Pazarit të Krujës pas restaurimit

The views of the Bazaar of Kruja after restoration

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Prof. Emin Riza. Rilevoi: Koço Zheku. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1965-66.

Bibliografi: Riza, E., "Ansamblet ndërtimore të pazareve dhe restaurimi i tyre", Monumentet, 1978, 15-16.

MUZEU ETNOGRAFIK

Muzeu Etnografik i Beratit (Banesa e Xhokaxhinjve) është një banesë karakteristike e tipit të banesës me çardak, e cila gjen përhapje të gjerë në të gjithë vendin. Në gjendjen e sotme banesa i përket variantit me çardak në një krah. Ajo shquan për trajtimin arkitektonik, i cili në pamjen kryesore zotërohet nga vëllimet e hapura të hajatit dhe çardakut, ndërlidhur me rampën karakteristike të shkallëve të gurta, mbi një sistem qemeresh. Ashtu si shumë banesa edhe kjo banesë ka pësuar një sërë transformimesh dhe në të dallohen dy faza ndërtimi. Në gjendjen origjinale banesa formohej në katin përdhe nga hajati dhe katoi, ndërsa në katin e sipërm nga çardaku në gjithë ballin kryesor, i cili ndërlidhej me dhomën e mirë, atë të zjarrit dhe ambientet e shërbimit. Ndërhyrjet e fazës së parë janë bërë me qëllim shtimin e një dhome zjarri të dytë, duke shtuar në drejtimin ballor volumin e dhomës së mirë të sotme dhe duke i marrë asaj një pjesë të sipërfaqes në drejtimin fundor. Ndërhyrjet e fazës së dytë kanë të bëjnë me zgjerimin e banesës në drejtimin e krahut, duke marrë kështu formën e shkronjës "L". Siç është karakteristikë e kësaj tipologjie, çardaku shoqërohet shpesh me një ose më shumë qoshqe, të cilat nga ana e jashtme mbrohen me mur me konstruksion të lehtë e të pajisur me dritare. Banesa ruan mirë pjesën origjinale të çardakut me dy qoshqe, si dhe odën e miqve, me tërësinë e elementeve konstruktive dhe arkitektonike të tyre.
Mbas inspektimit në terren, monumenti u gjet në gjendje

THE ETHNOGRAPHIC MUSEUM

The ethnographic Museum of Berat (The house Xhokaxhinjve) is a house characteristically designed with a çardak-mound, the type most widespread across the country. In its current configuration the house belongs to the type with a çardak-mound on one side. Its architectural values surely make this house stand out. The open volumes of the çardak and the porch articulate the main facade, which are interconnected by the characteristic ramp of the stone staircase, above a lintel system.
As is the case with many other vernacular houses, this particular house has also undergone a series of transformations and we can easily distinguish two phases of construction. In the original first phase, the house was formed by the ground floor from hajati-colonnaded courtyard and katoi-crib, while on the upper floor the çardak-mound was extended for the length of the house, and was also connected to the fireplace room and the service rooms.
The first phase of the interventions aimed at adding a second fire room, extending the frontal elevation of the house and the volume of the existing fireplace room by taking a part of the room from it at its end.
The interventions of the second phase dealt with the expansion of the house in the direction of the wing, taking the form of the letter "L" in the plan view. As is characteristic of this typology, the çardak-mound is often accompanied by one or more bay windows, which





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
Views of the building (the existing situation)

DO NOT COPY

të degraduar, pasi blloku i banimit në katin e sipërm ishte në gjendje të rrënuar, çatia kishte nevojë për ndërhyrje si dhe çardaku ishte tejet i dëmtuar. Synimi i projektit të restaurimit ishte ruajtja e fazave ndërtimore të banesës, pa përjashtuar heqjen e ndonje shtrese pa kriter. Fillimisht u ndërhy në pjesën më të degraduar, më tej u rindërtua dhoma e rrënuar në katin e dytë, u çlirua hajati e kafazi i shkallëve si dhe u kryen punime konsolidimi e plotësimi me elemente që mungonin në të gjitha ambientet e banesës, gjithnjë duke respektuar gjurmët origjinale. Pas restaurimit, kjo banesë u kthye në muze etnografik të qytetit, duke gjetur një funksion i cili përshtatet më së miri me vlerat e këtij monumenti.

are protected from the outside by a wall with a light construction and equipped with windows. The original part of the çardak-mound with two bay windows was well preserved, as well as the guest room, with all its structural and architectural elements. After the field survey, the monument was found to be in very poor condition, because the residential space on the upper floor was in a dilapidated state, the roof needed intervention and the çardak-mound was extremely damaged. The aim of the restoration project was to preserve the construction phases of the house, while not excluding the removal of any inappropriate layer.

The intervention began in the most damaged part of the house. Then the demolished room on the second floor was rebuilt, the hajati-colonnaded courtyard and the staircase frame were separated from the inappropriate additions, continuing with the consolidation and completion of all the missing architectural elements throughout the house by respecting the original traces of the house. After the restoration, this house became the ethnographic museum of the city, a function that is suitable to its value as a monument.



Fasada kryesore e Muzeut Etnografik të Beratit
The main facade of the Ethnographic Museum of Berat



Prerje e objektit (gjendja ekzistuese)
The section of the building (the existing situation)



Planimetria e katit të I-rë (gjendja ekzistuese)
1st Floor plan (the existing situation)

DO NOT COPY



Planimetria e katit të II-të (projekti i restaurimit)
2nd Floor plan (the restoration project)



Fasada kryesore (projekti i restaurimit)
The main facade (the restoration project)



Planimetria e katit të I-rë (projekti i restaurimit)
1st Floor plan (the restoration project)



Blloku anësor (projekti i restaurimit)
The lateral block (the restoration project)



Detaje (projekti i restaurimit)
Details (of the restoration project)





Pamje të objektit pas restaurimit
Views of the building after restoration

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje të objektit pas restaurimit
View of the building after restoration

Projekti i restaurimit: Prof. Emin Riza. Rilevoi: Emin Riza. Vizatoi: Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës nën drejtimin e autorit në vitin 1980.

Bibliografi: Samini, G., "Vlerat dhe restaurimi i një banese tipike me çardak në Berat", Monumentet, 1990-2, (40).
Baçe, A., Meksi, A., Riza, E. Berati, historia dhe arkitektura. Tiranë, 2011. fq. 174-180.

MUZEU ETNOGRAFIK

Muzeu Etnografik në Elbasan (banesa e Hajdar Sejdinit) është monument i kategorisë së I-rë dhe ndodhet në qendër të qytetit. Është një shtëpi karakteristike e tipit me çardak, që i takon shek. XVIII. Në planin kompozicional dhe në konceptimin funksional e arkitektonik, kjo banesë është e ngjashme me banesat me çardak të zonës së Beratit dhe të Shkodrës. Banesa përbëhet nga dy kate, ku kati përdhe është përdorur si magazinë e produkteve bujqësore dhe kati i parë ku jetonte familja. Kjo banesë në kohë kishte pësuar transformime, sidomos në krahun e majtë të saj, ku ishte ndërtuar një volum me tulla, i cili me përmasat e tij cënonte rëndë vlerat arkitektonike të banesës. Ky fakt sillte nevojën e hartimit të një projekti restaurimi ku të parashikohej kryerja e sondazheve, për të vendosur mënyrën e ndërhyrjes në shtesat e bëra në objekt. Vetë banesa paraqitej në gjendje të rëndë, sidomos nga ana konstruktive dhe dekoracioni. Çatmatë, dyshemetë, tavanet, dyert, dritaret dhe çatia ishin të rrënuara dhe tejet të degraduara. Projekti i restaurimit pati si synim sigurimin e qëndrueshmërisë së objektit dhe restaurimin e elementëve arkitektonike ekzistuese. Ndërhyrjet restauruese përfshinë dhe ambientet përreth banesës si: oborrin, pusin, muret rrethuese dhe portën kryesore. Pas restaurimit, kjo banesë u përshtat në muze etnografik, në të cilin ruhen rreth 900 objekte origjinale të kulturës popullore dhe etnografisë.

THE ETHNOGRAPHIC MUSEUM

The Ethnographic Museum in Elbasan (the house of Hajdar Sejdini) is a monument of the 1st Category and is located in the center of the city. It is a house characteristic of the type with a çardak which belongs to the 18th Century. Its concept in plan and the distribution of the functions, makes it looks like the houses with a çardak-mound in Berat and Shkodra. The house consists of two floors, where the ground floor is used as a warehouse for the agricultural products and the first floor where the family lived. Different transformations especially the one in its left side where a whole brick volume that was built, affected the architectural integrity of the building. Surveys and a restoration project were needed to establish the order of interventions. The house itself was in poor condition, especially the structural system and its decorations. The floor pavements, ceilings, doors, windows and roof were in a very bad shape. The restoration project aimed to strengthen the structural stability of the building and the restoration of the existing architectural elements. The interventions included the restoration and the facilities around the house like: the courtyard, the pit, the surrounding walls and the main gate. After the restoration, this house was adapted to become the ethnographic museum of the city, where about 900 original objects were belonging of the vernacular culture and ethnography.

DO NOT COPY





Pamje të objektit (gjendja ekzistuese)
Views of the building (the existing situation)

ELBASAN



Fasada kryesore (gjendja ekzistuese)
The main facade (the existing situation)



Prerje e pjesshme e objektit (gjendja ekzistuese)
Section of the object (the existing situation)



Planimetria e katit përdhe
The plan of the ground floor



Planimetria e katit të I-rë
The plan of the 1st Floor



Fragmente interieri (projekti i restaurimit)
The interior fragments (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Latif Lazimi. Rilevoi, Vizatoi, Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Instituti i Monumenteve të Kulturës Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1983-1985.

Bibliografi: Arkivi IMK



Pamje e objektit pas restaurimit
View of the building after restoration

DO NOT COPY

BANESA E SKËNDULAJVE

Banesa e Skëndulajve (përfunduar në 1823) ngrihet në qendër të lagjes "Palorto", ku mjedisi urbanistik karakterizohet nga ndërtime të ngjeshura, me orientim të detyruar. Është një nga banesat më të mëdha gjirokastrite që fillimisht ka pasur dy oborre dhe që vjen në ditët tona pothuaj e pacënuar. Banesa e Skëndulajve është një pikë referimi e saktë për të ndjekur tiparet dhe karakterin e banesës gjirokastrite në periudhën e lulëzimit të saj, 1800-1830.

Banesa e Skëndulajve ka programin maksimal të variantit më të zhvilluar të banesës gjirokastrite, atij me dy krahë. Sipas funksionit, ambientet e kësaj banese ndahen në kryesore, ndihmëse dhe ndërlidhëse dhe me një ndarje të qartë funksionale sipas kateve. Skema e kompozimit planimetriko-volumor formohet nga bllloqet e njësuar kompozicionale, të cilat, në rastin e dhënë vendosen në formën e shkronjës "U".

Gjendja teknike e monumentit, në prag të ndërhyrjes restauruese paraqiste probleme si: prerja dhe degradimi e strehës së odës së miqve, degradimi i murit fundor, degradimi i suvatimeve si dhe degradimi i elementeve drusorë origjinalë.

Punimet e restaurimit të kryera në vitet 1966-1967 patën synim ruajtjen e fazave të ndërtimit kur ato ishin zhdukur si dhe ndërhyrje të vogla në strukturë. Në dy ambientet e sajuara në strukturën mbajtëse të shkallëve u zbatua heqja e tyre me përjashtim të rindërtimit të dy fragmenteve

THE HOUSE OF SKËNDULAJ

The house of Skëndulaj (completed in 1823) is situated at the center of the neighborhood "Palorto" in an urban setting characterized by close-knit constructions and forced orientations. It is one of the largest houses in Gjirokastra, with two yards and survives to this day almost intact. The house of Skëndulaj is a precise reference point for the following features and character of the houses in Gjirokastra in its blooming period, 1800-1830.

The house of Skëndulaj represents the most developed type of the historical houses with two wings. By function, the areas of the house are divided into main, auxiliary and interconnecting rooms with a clear functional separation by floors. The plan and volumetric scheme of the house is formed by uniform compositional blocks in plan, which in total create a "U" shaped building.

The structural and technical condition of the monument, prior to restorative intervention represented problems such as the cutting and degradation of the guests' room shelter, degradation of the rear wall, plaster deterioration and degradation of the elements of the original timber. Previous restoration works carried out in the years 1966-1967 were aimed at maintaining the phases of construction when they were gone as well as small interventions in the structure. The two additions in the structural space of the staircase were removed, except for the reconstruction of the 2 fragments of the wall. This last intervention did not affect the original structure. Completion work was carried





Pamje të objektit para restaurimit
Views of the building before the restoration



Planimetria e katit të I-rë (gjendja ekzistuese)
First floor plan (the existing situation)

DO NOT COPY

të muraturës, veprim ky që nuk tjetërsonte strukturat origjinale. Punime plotësimi u kryen në strehën mbi ballin e odës së miqve dhe në disa oda të tjera. Pastrimi i tamburit të oxhakut nxorri në pah pikturimin e tij. U rindërtua muri fundor që rrezikonte shembjen.

out in the roof above the guests'room and other rooms. Cleaning the fireplace made it possible for discovering its decorative painting. The wall at the rear end which was about to collapse was also reconstructed.

DO NOT COPY



Fasada kryesore (gjendja ekzistuese)
The main elevation (the existing situation)



Fasada kryesore (projekti i restaurimit)
The main elevation (the restoration project)



Prerje e objektit
Section of the building



Pamje e objektit para restaurimit
View of the building before the restoration



Fasada jugore (gjendja ekzistuese)
The south elevation (the existing situation)



Fasada jugore (projekti i restaurimit)
The south elevation (project of restoration)







Porta kryesore (projekti i restaurimit)
The main gate (project of restoration)



Blloku qendror (projekti i restaurimit)
Central Corpus (project of restoration)



Kompleksi mafil-musandër
The complex of the inside balcony

DO NOT COPY



Blloku qendror (projekti i restaurimit)
Central Corpus (project of restoration)



Ndërhyrje restauruese
Restoration interventions

Projekti: Projekti i restaurimit: Prof. Emin Riza. Rilevoi: Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Atelieja e Gjirokastrës në vitin 1966-1967.

Bibliografi: Riza, E., "Një shembull i zhvillimit i banesës gjirokastrite", Monumentet, 1984, 2. Riza, E. Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX. Tiranë, 2009, fq. 263-266.



Ndërhyrje restauruese
Restoration interventions



Tavani i Odës së Madhe
The ceiling of "Oda e Madhe"- The best room



Banesa e Skëndulajve pas restaurimit
The Skendulaj house after the restoration

DO NOT COPY

BANESA E ZEKATËVE

Banesa e Zekatëve në Gjirokastër, e ndërtuar në vitet 1811-1812, shquhet për vlerat madhore arkitektonike, për faktin se ajo ruan kompozimin origjinal dhe elementet e veçanta arkitektonike, duke qënë një pikë mbështetje me rëndësi për tipologjinë dhe zhvillimin e banesës gjirokastrite.

Banesa e Zekatëve është e ndërtuar mbi një terren të pjerrët, e kompozuar me gjysëm kat dhe ka tre oborre. Ajo i përket variantit me dy krahë dhe përbën një nga shembujt më me interes të banesës së këtij varianti e cila shpreh qartë tiparet e saj në planin kompozicional, në atë të elementeve arkitektonike, si dhe në teknikën e ndërtimit. Pabarazia e truallit ka kushtëzuar zhvillimin e saj në bllokun e majtë me tre kate dhe në të djathtin me katër kate. Kompozimi planimetrik është i thjeshtë: një bërthamë qendrore ndërlidhëse, ndërsa anash dy blloqet e krahëve.

Në kompozimin vëllimor të jashtëm banesa shquhet për hedhjen në lartësi, tiparet e theksuara mbrojtëse dhe karakterin e spikatur monumental.

Projekti i restaurimit u hartua për shkak të prezencës së dëmtimeve të shumta në strukturë, në muret mbajtëse e në konstruksionin e çatisë. Gjithashtu, shumë elemente arkitektonike kishin humbur ose paraqiteshin shumë të degraduar. Dokumentacioni i mbledhur gjatë studimit të monumentit dhe analiza e gjendjes së tij teknike krijuan kushtet që projekti i restaurimit të arrinte zgjidhje të drejta. Qëllimi i projektit të restaurimit ishte konsolidimi i gjendjes konstruktive të objektit, ruajtja në maksimum

THE HOUSE OF ZEKATE

The house of Zekate in Gjirokastra, built in the years 1811-1812, is known for its major architectural values, because it preserves the original composition and specific architectural elements that qualify it as a very important example and basis for the typology and development of the houses of Gjirokastra.

The house of Zekate is built on steep ground. It is composed of a semi-floor (dirt with stone) with three yards. It belongs to the variant with two wings and is one of the most interesting examples of this variant of the house. It clearly represents the features in a compositional plan, in the architectural elements, as well as in the construction techniques. Because of the unevenness of the rugged terrain and steep slope, the left wing of the house is developed with three floors and the right wing of the house is developed with four floors. The plan is simple: a central area with 2 implied but slightly non-symmmetrical wings.

The exterior design and proportion of the house is known for its imposing height and scale, with accentuated details of protective architecture elements such as niches & windows in only the upper portions giving it an imposing and monumental proportion. The restoration project was developed due to the presence of multiple damages to the structure, the retaining walls and the roof structure. Many of the architectural elements were also lost or severely damaged. The documentation gathered during the study of the monument and the analysis of its technical situation





Pamje të objektit para restaurimit

Photos of the house before the restoration

DO NOT COPY

e elementeve origjinale, rindërtimi i elementeve të humbura sipas gjurmëve të gjetura në objekt dhe ruajtja e kontributeve të periudhave të mëvonshme.

led to the conclusion that the restoration project was to achieve a solution with a fair expectation.
The goal of the restoration project was the consolidation of a constructive situation of the object, the maximum preservation of the original elements, the reconstruction of the lost elements by traces found in objects and the maintenance of the contributions of different periods.





Fasada kryesore (gjendja ekzistuese dhe projekti i restaurimit)
North Elevation (the existing situation and project of restoration)





Planimetria dhe fasada e pasme (projekti i restaurimit)
The plan and the elevation on the back (the restoration project)

DO NOT COPY





Fasada veriore (gjendja ekzistuese dhe projekti i restaurimit)
North Elevation (the existing situation and project of restoration)



Planimetria e katit të II-të
The plan of the second floor





Prerje gjatësore (projekti i restaurimit)
Longitudinal section (the restoration project)





Tavani (projekti i restaurimit), Mafili (projekti i restaurimit)
The ceiling, the inside balcony (the restoration project)





Odaja e Madhe pas restaurimit.
"Odaja e madhe" after the restoration

DO NOT COPY





DO NOT COPY





Dhoma nr. 3 (projekti i restaurimit)
Room number three (the restoration project)

Projekti i restaurimit: Prof. Emin Riza. Rilevoi: Bashkim Penxha. Punimet u kryen nga: Atelieja e Gjirokastrës në vitin 1966.

Bibliografi: Riza, E., "Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve – Gjirokastër", Monumentet, 1977, 13.shqiptare shek. XV-XIX. Tiranë, 2009, fq. 263-266.

SHËTITORJA E SHKODRËS

THE PROMENADE OF SHKODRA

Zona-muze e qytetit të Shkodrës shquhet për vlerat e theksuara urbanistiko-arkitektonike dhe zë një vend me rëndësi në pasurinë e trashëgimisë së kulturës materiale të këtij qyteti. Vlen të përmenden disa ndërtesa në rrugën "Luigj Gurakuqi", të cilat janë të projektuara e të dekoruara nga artisti i njohur Kol Idromeno. Kjo zonë është dokument me vlerë historike, që dëshmon për futjen e koncepteve të reja në formulimin urbanistik të qytetit, me ndërtimin e arterieve rrugore, të cilat thithën një pjesë të veprimtarisë tregtare të pazarit të vjetër, duke marrë një funksion të qartë tregtar e shoqëror. Krahas vlerave arkitektonike, vende të caktuara në këto rrugë lidhen me ngjarje të shënuara historike të rëndësishme për qytetin.
Në përgjithësi, gjendja teknike e këtij ansambli është e mirë, ndërsa më e dëmtuar paraqitej veshja e jashtme dhe zbukurimorja. Ansambli kishte pësuar transformime të cilat përqendroheshin më tepër në katet përdhe, si mbyllje të hapësirave-dritë, trajtimin e tyre në forma dhe madhësi të ndryshme nga origjinalet, duke cënuar vende-vende unitetin dhe harmoninë e ndërtimit.
Projekti i restaurimit i këtij ansambli ndërtimor shtronte një sërë problemesh që kërkonin zgjidhje si: mënyrën e ndërhyrjes në ndërtime që kishin pësuar transformime të dukshme, në ndërtime që kishin pësuar transformime që cenonin harmoninë e ansamblit dhe në ndërtime me

The so called museum ensemble of the city of Shkodra is known for the significant urban architectural values, and plays an important role in the cultural heritage of this city. It is important to mention here that some of the buildings in "Louis Gurakuqi" street, are designed and decorated by the famous artist Kol Idromeno.
This area is a document of historical value, which testifies to new concepts in the urban planning design of the city. One of these is the construction of the arterial roads, which have attracted a part of the businesses of the old bazaar, giving them a clear commercial and social function. Besides the architectural values, different parts of these roads are associated with historical events, very important for the city. In general, the technical condition of the ensemble is good, while the decorations of the facades and the facades themselves were damaged.
The ensemble had been prone to different transformations, especially on the ground floors, as well as on the upper floors, in closing light spaces by walls, treating them in different shapes and sizes from the original, affecting in some places the unity and the harmony of the building. The project of the restoration of this construction ensemble raised a number of problems that required solutions: the interventions in buildings that have undergone some evident transformations that violate the harmony of the





Pamje të fasadave (gjendja ekzistuese)
Views of the facades (the existing situation)

DO NOT COPY

trajtim të varfër të zbukurimores së pamjes së jashtme dhe stononin me unitetin e ansamblit në tërësi. Ndërhyrjet konsistuan në kthimin në gjendjen fillestare të hapësirave të dritareve, bazuar në gjurmët origjinale të gjetura, u rikonstruktuan blloqet e dyqaneve në rrugën "Branko Kadia" dhe dritaret e tyre, u restauruan pamjet e jashtme të dyqaneve, u restauruan vitrinat e tyre, tarabatë, strehët e gjera etj. Ndërhyrjet restauruese përfshinë edhe ambientet e brendshme të dyqaneve, duke ruajtur funksionin e tyre të mëparshëm si ambiente shitjeje. Pamja e re që fitoi ansambli pas punimeve të plota restauruese pasuroi fondin e vlerave urbanistiko-arkitektonike të qytetit të Shkodrës, i cili në këtë drejtim zë një vend të rëndësishëm në mbarë trashëgiminë tonë kombëtare.

ensemble, and the poor treatment of ornaments of the facades which did not go very well with the unity of the ensemble design.
The interventions consisted of: the return of the windows to heir original conditions, based on the original traces found. The shops in "Branko Kadia" street were reconstructed and their windows were restored, as well as the window shops.
The restoration interventions included the restoration of the interior of the shops, while preserving their original function of selling. The view of the ensemble after the implementation of the project of restoration has enriched the fund of urban planning and architecture of Shkodra city, which in this respect plays an important role in the cultural heritage of Albania.



Fragment fasade dhe planimetria (projekti i restaurimit)
Fragment of the facade and plan (the restoration project)



Pamje të fasadave (gjendja ekzistuese)
Views of the facades (the existing situation)

DO NOT COPY





Fragment fasade dhe planimetria (projekti i restaurimit)
Fragment of the facade and plan (the restoration project)



Detaje ndriçimi (projekti i restaurimit)
Details of lighting scheme (the restoration project)



Detaje dyer të jashtme (projekti i restaurimit)
Details of the exterior doors (the restoration project)



Pamje të fasadave pas restaurimit
Views of the facades after the restoration

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Projekti i restaurimit: Shpresa Prifti. Rilevoi, Tushoi, Përpunoi: Bashkim Penxha, Harito Sava. Punimet u kryen nga: Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Tiranës në vitin 1981.
Diçitura:.

Bibliografi: Prifti, Sh., "Zona-muze e qytetit të Shkodrës dhe restaurimi i saj", Pasuri e trashëguar në shekuj, Tiranë, 1984.
Prifti, Sh., "Restaurimi i rrugës "Enver Hoxha" në zonën muze të qytetit të Shkodrës", Monumentet, 1983, 1.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



RESTAURIMI I OBJEKTEVE TË ARTIT

THE RESTORATION OF ARTWORKS

MOZAIKËT E BAZILIKËS PALEOKRISTIANE TË LINIT

Bazilika e Linit ndodhet në vendin e njohur me mikrotoponimin kodra e Shën Thanasit, në afërsi të vendbanimit të Zagraqit, në skajin perëndimor të Kepit të Linit. Ajo u zbulua gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1968, të cilat nxorën në pah një pjesë të monumentit, ndërsa në vitin 2008, kërkimet plotësuese rreth tij përcaktuan më qartë funksionin e kompleksit kishtar si qendër e rëndësishme pelegrinazhi, të ndërtuar përgjatë rrugës Egnatia, aksit kryesor tokësor që lidhte Lindjen me Perëndimin.

Përgjithësisht bëhet fjalë për një ndërtim trekonkësh, me naos, kapela anësore, baptister dhe atrium. Disa prej ambienteve kryesore, narteksi, pastofori, katekumeni, baptisteri dhe naosi, janë dekoruar me mozaikë shumëngjyrësh, të cilët reflektojnë njëkohësisht edhe funksionin e këtyre hapësirave në godinë. Tre njësi të ndryshme të ndërtesës ruajnë mozaikë që paraqesin skena zogjsh dhe kafshësh që shoqërojnë një kantar të mbushur me vile rrushi, ndërsa vendosja e tyre në pjesë të shenjta të ndërtesës thekson kontekstin liturgjik dhe domethënien eukaristike të tyre. Pjesa tjetër përmban dekor me motive gjeometrike dhe floreale. Përbërja e shtratit të mozaikëve konsiston në bazë llaçi gëlqeror të përzierë me rërë, guralecë e pluhur tulle dhe nga një shtrat llaçi të bardhë, mbi të cilin janë vendosur kubikët. Ngjyrat e teserave janë të larmishme, ku mbizotërojnë e bardha, e zeza dhe e kuqja.

Në vitin 1972, Instituti i Monumenteve të Kulturës vuri në mbrojtje objektin dhe prej asaj kohe ka organizuar



Pamje ajrore e Bazilikës së Linit

Aerial view of the Christian Basilica on the Cape of Lin

THE MOSAICS OF THE PALEOCHRISTIAN BASILICA ON THE CAPE OF LIN

The early Christian basilica is situated on a hill in the western part of the Cape of Lin, near the settlement of Zagraqi. Its ruins were discovered during the archaeological excavations of 1968, which uncovered only part of the monument, while the archaeological campaign of 2008 resulted in new data on the church complex showing that during Late Antiquity the Cape of Lin was an important center of Christian pilgrimage the route to which was through the Via Egnatia, the main link between East and West.

The structure of the monument consists in a triconch basilica, with a central nave, subsidiary chapels, a baptistery and an atrium. Parts of the monument as the narthex, the pastophoria, the catechumena, the baptistery and the central nave were lavishly decorated with polychrome mosaic pavements reflecting the function of the rooms in the church complex. Three different units have similar scenes of cantharoi filled with vines flanked by pecking birds or animals while their placement in the most sacred part of the building reveal their liturgical context and Eucharistic symbolism. The rest of the mosaics feature geometric and floral motifs.

The structure of the mosaic pavement consists of layers of coarse roughened mortar, layers of pounded bricks and mortar and a layer of white stucco over which are settled the tessserae. Tesserae of various colors are used for the making of the mosaic but white, black and red tesserae are predominant.

In 1972 the basilica and its mosaic pavements were



Pamje ajrore e fragmenteve të mozaikut

The mosaic floor of the basilica

DO NOT COPY

ekspedita të vazhdueshme me qëllim mirëmbajtjen e tij dhe të mozaikëve, të cilat kishin pësuar dëmtime. Ndërhyrjet e kryera kishin karakter periodik dhe konsistonin përgjithësisht në eliminimin e bimësisë, stabilizimin dhe nivelimin e sipërfaqes me injektime dhe plotësime, si dhe mbushjen e lakunave, konsolidimin e pjesëve të dëmtuara, rivendosjen e teserave të shkëputura nga tabani i tyre, pastrimin e sipërfaqes nga llaçi; në disa raste u aplikua edhe zhvendosja e mozaikut nga tabani origjinal në një të ri, më rezistues ndaj agjentëve atmosferikë, montimi i paneleve të restauruara dhe plotësimi i motiveve të qarta. Procesi i monitorimit të gjendjes së mozaikëve nga ana e specialistëve të IMK, ka vazhduar edhe vitet e fundit, me qëllim që të parandalohet dëmtimi i një vlere kaq të rëndësishme historike dhe artistike në kohë, ndërsa janë ndërmarrë punime pastrimi, për qëllime dokumentimi dhe për të evidentuar paraqitjen estetike të tyre.
Ndërhyrjet konservuese – restauruese në këto mozaikë, u kryen nga Sektori i Arteve të IMK, nën drejtimin e Uliam Çikopano-s.

declared a national monument of culture and since then the Institute of Cultural Monuments has developed backup strategies and implemented a conservation program for the maintenance of the mosaics. The periodical interventions were aimed at consolidating the mosaics and preparatory layers. This activity was carried out on several fronts aiming at the elimination of vegetation; securing de-cohesive, exfoliated and disintegrating surfaces; reducing soluble salts on surfaces; reduction or removal of microbiological organisms by mechanical or chemical means; resetting of detached tesserae in their original position; edging; filling of lacunae and treatment of cracks and fractures. In several cases the detached parts of the mosaic floor were re-layed in situ on a new support resistant to the deteriorating factors. U.Çikopano of the Albanian Institute of Monuments implemented the conservation and consolidation of the mosaic floors at the monument.
Given the artistic, aesthetic and historical importance of the monument and its mosaic floors, the Institute of Cultural Monuments has conducted the continuous monitoring of environmental conditions and developing guidelines for routine maintenance.

DO NOT COPY

Bibliografi:
ANAMALI, S., "Mozaikët e bazilikës paleokristiane të Linit", *Iliria* 3, 1974, f. 329 – 342.
MEKSI, A. *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII – XV)*, Tiranë, 2004.
MUÇAJ, S., "Vendet e shenjta të pelegrinazhit në Shqipëri", *Candavia* 4, 2014, f. 5 – 16.
SPIRO, M., "*Vergil in Albania: an early byzantine mosaic pavement at Arapaj*", *The medieval Albanians*, International Symposium 5, Institute for Byzantine Research, Athens 1998, f. 131 – 168.



Pamje e Bazilikës së Linit
General view of the early Christian basilica of Lin

MOZAIKËT E BAZILIKËS PALEOKRISTIANE TË ELBASANIT

Bazilika paleokristiane ndodhet në anën jugore të castrum – it të Skampinit (Elbasani modern), në afërsi të rrapit të Bezistanit. Rrënojat e saj dhe pjesë të mozaikëve u identifikuan rastësisht në vitin 2007 gjatë gërmimeve për ndërtimin e një objekti publik. Në vitin 2008 filluan gërmimet sistematike, sezonet e të cilave zgjatën deri në vitin 2012, duke nxjerrë në pah një pjesë të rëndësishme të monumentit. Prej tyre janë përftuar të dhëna të rëndësishme rreth planimetrisë, elementëve të tjerë dekorative dhe datimit të tij. Bëhet fjalë për një strukturë trenefëshe me absidë gjysmë rrethore të theksuar, me transept, krahët e të cilit nuk zgjaten përtej gjerësisë së naosit, dhe me narteks. Për ndërtimin e saj është përdorur teknika *opus mixtum*, me alternim radhësh të trefishta tullash dhe breza gurësh. Disa prej ambienteve të kishës, si nefi qendror dhe narteksi, janë shtruar me mozaikë shumëngjyrësh të një cilësie shumë të mirë. Mozaiku i nefit qendror përbëhet nga dy panele, ku në atë lindor spikat një skenë e madhe eukaristike, me dy figura njerëzore në krahët e një kantari, të vendosur në një sfond me hardhi dhe motive të tjera kafshësh dhe zogjsh, ndërsa në panelin perëndimor, të zbuluar pjesërisht, vërehen shkurre dhe zogj fluturues. Për realizimin e këtij mozaiku janë përdorur tesera prej guri, mermeri, qeramike dhe brumi qelqi me dimensione shumë të vogla. Ndryshe nga punimi elegant i nefit qendror të naosit, mozaiku i narteksit, i cili shtrihet përgjatë gjithë

THE MOSAIC FLOOR OF THE PALEOCHRISTIAN BASILICA AT SCAMPIS

In 2007 the ruins of an early Christian basilica were discovered by chance in an extra – mural area south of the castrum of Scampis (modern Elbasan) in the proximity of the large plane tree of Bezistane, during the excavations for the construction of a modern object. The systematic archaeological campaigns began in 2008 and by the end of the final season of 2012, significant data was obtained on the plan and the function of the monument, its decorative elements and its chronology. It is a three aisled basilica with a pronounced semicircular apse, a non-protruding transept and a narthex. The basilica is built in the opus mixtum technique, alternating three brick courses with sections of river limestone masonry. Parts of the monument were decorated with fine mosaic floors and fresco paintings. The mosaic of the central nave is arranged in two panels, where the east panel presents the Eucharistic scene with two human figures on either side of a cantharus, with grapes, animals, and birds filling the background. The west panel features bushes and flying birds. Glass tesserae, brick and marble tesserae of various colors are predominant in the making of this mosaic. In the narthex the mosaic extends over the entire floor featuring, within a meander and swastika decorated frame, three intertwined medallion bands. At the centre there would have been a large medallion. The tesserae used in the making of this mosaic are larger and

PO NOT COPY



Planimetria e qendrës së qytetit, pozicioni i mozaikut (E. Hobdari)
General plan of the center of the city indicating the position of the mosaic



Fragmente të Mozaikut
Fragment of the mosaic floor

sipërfaqes së ambientit, është më i thjeshtë, dhe konsiston në ndërthurjen e motiveve gjeometrike dhe zoomorfe. Teserat e përdorura për këtë mozaik janë më të mëdha dhe me gamë ngjyrash më të varfër.
Instituti i Monumenteve të Kulturës ka asistuar vazhdimisht procesin e gërmimit dhe të zbulimit të mozaikëve në monument, duke kryer ndërhyrje konsoliduese, që synonin konservimin paraprak të sipërfaqeve me mozaik dhe pikturës murale, si pastrimin e mozaikëve me qëllim dokumentimin dhe përmirësimin e paraqitjes së tyre.
Ndërhyrjet konservuese u kryen nga Sektori i Arteve të IMK, nën drejtimin e Agron Islamit.

of a poorer range of color. Experts and restorers from the Institute of Cultural Monuments assisted the process of excavation and the uncovering of the mosaic floors and implemented in situ consolidation interventions for the preliminary conservation of the mosaic surfaces and the fresco painting, improving their aesthetic presentation.
Agron Islami of the Albanian Institute of Monuments led the conservation and consolidation of the mosaic floors at the monument.

DO NOT COPY



Vizatim i mozaikut
Graphic design of the mosaic pavement



Foto ajrore
Aerial view of the mosaic pavement

Bibliografi:
CEROVA, Y., HOBDARI, E., ISLAMI, A., "Bazilika paleokristiane extra – muros në Scampis (Elbasan)", *Candavia*, 3, 2011, f. 105 – 118.
HOBDARI, E., CEROVA, Y., "Bazilika paleokristiane extra-muros në Scampis (Elbasan)", *Iliria*, XXXVI (2012), 2013, f. 451 – 457.





Fragmente të Mozaikut
Fragment of the mosaic floor

MOZAIKU I ORFEUT

Mozaiku i Orfeut është zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1988 në Durrës dhe përfaqëson një nga shprehjet më të bukura të artit romak në qytet. Në panelin kryesor të mozaikut, Orfeu shfaqet i ulur mbi një shkëmb në shkretëtirë dhe kafshët e grupuara përreth të magjepsura nga muzika e lirës së tij. Ai mban veshje orientale: klamidë ngjyrë të kuqe tulle, tunikë jeshile dhe kapelë frigjiane. I gjithë kompozimi dëshmon punën e një artisti cilësor, i cili ka përdorur tesera të vogla në përpjekje për të treguar detaje të veshjes, trupave të kafshëve dhe puplat e zogjve. Ndonëse nuk është zbuluar i plotë, paneli është konceptuar në mënyrë të tillë që Orfeu të përbëjë qendrën e tij, por pjesa që shtrihet në krah të djathtë me kafshët e tjera tashmë ka humbur. Ai veçohet nga pjesa tjetër e dyshemesë nëpërmjet një kornize komplekse, që përbëhet nga fasha të kuqe, fasha bardhë e zi dhe gërshet dysh. Më tej vijojnë një seri motivesh gjeometrike, si yll me gjashtë cepa, katrorë, rombe, të cilat kanë të integruar motive floreale. Ato alternohen me njëra tjetrën duke formuar një tërësi harmonike. Tematika e Orfeut midis kafshëve ka qenë mjaft popullore gjatë shek. II – IV dhe është e vetmja nga disa skena të mbështetura në mitin e Orfeut që gjeti shprehje në artin romak. Në studimet e fundit është argumentuar dhe theksuar domethënia

THE MOSAIC OF ORPHEUS

The Orpheus mosaic was found during the excavations of the year 1988 in Durres and represents one of the most beautiful expressions of Roman art in the city. The main panel contains the composition of Orpheus in the wilderness and the animals around him spellbound by the music of his lyre. He is depicted seated on a reddish stone and dressed in full "oriental" garb: a red mantle, a green tunic and a Phrygian cap. The whole composition testifies to the work of a skillful master, which used small tesserae in his attempt in the modeling with highlights and shadows of the clothing and the naturalistic rendering of bodies of the animals and the birds. Although a considerable portion of the mosaic remains to be excavated, it was conceived in a way that Orpheus comprises the main panel. The frame of the Orpheus panel was particularly ornate; the rectangular white field being directly bordered by a brick – red line and a white broad white band, rendered with a continuous dentil pattern rendered in black and white. Adjoining this frame was a band of a double guilloche. The rest of the mosaic continues with alternating geometric motifs, like hexagrams, lozenges etc, and enclosing other floral motifs. The theme of Orpheus and the animals was greatly common during the 2nd to 4th centuries and was the only scene from the Orpheus myth which found its





Fragmente motivesh të mozaikut

The Fragment of mosaic

DO NOT COPY

e krishterë e tematikës së Orfeut, më shumë se sa ajo profane, duke e parë tek ai simbolikën e Bariut të Mirë dhe një nga shprehjet më të hershme të repertorit të artit të Krishterimit në qytetin e Durrësit, të realizuar në periudhën e Kostandinit të Madh, nga atelie vendase.

way in Roman art. Recent studies on the compositions inspired from the myth of Orpheus emphasize the rather religious than the profane character of this thematic in the city of Durres. The mosaic is considered to be one of the earliest expressions of Christian repertory, the work of a local workshop, during the reign of Constantine the Great.

DO NOT COPY

Bibliografi:
MIRAJ, L., *"Orpheus the evolution of the myth in Greek, Roman, Early Christian period and Orpheus mosaic of Dyrrachium"*, Nis & Byzantium, Symposium XI, Nish, 2013, f. 101 – 122.



Fragmente motivesh të mozaikut
The Fragment of mosaic

SHËN SIMONI, IKONË

Ikona e Shën Simonit, e cila vjen nga kisha e Shpërfytyrimit në fshatin Mingul të Gjirokastrës ishte vendosur në ikonostasin e kësaj kishe, si pjesë integrale e kompozimit Deisis i Madh. Ajo spikat për kornizën e gdhendur mjeshtërisht në dru me guaskën dhe rozetat e integruara në dekorin floreal në pjesën e sipërme, dhe kolonat e ciboriumit në anë. Ikona është punuar në dru arre dhe ka dimensione rreth 65.5 x 30 cm. Ajo është pjesë e fondit të Muzeut Historik Kombëtar dhe u përfshi në programin e restaurimit të ikonave, të cilat do të trajtoheshin në laboratorin e sektorit të Artit, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Në momentin e këqyrjes nga ana e specialistëve, ikona paraqiste patologji të shumta, si dëmtim të shtresave përgatitore, dëmtim i suportit të drurit, mbulim të sipërfaqes së pikturës nga shtresa e pluhurit dhe papastërtive të tjera të depozituara në kohë, të cilat kishin bërë thuajse të padallueshëm leximin e imazhit të saj dhe elementëve të tjerë.

Për të përcaktuar metodologjinë e trajtimit të këtyre patologjive, objekti iu nënshtrua analizave paraprake diagnostikuese jo dëmtuese, si analizat e radiografisë me rreze X, për përcaktimin e gjendjes së suportit të drurit dhe të ekzistencës apo jo të shtresave më të vjetra të pikturës, analiza me rreze UV, analiza e pigmenteve me Fluoreshencë X dhe analiza spektrale me ndihmën e mikroskopit mineralogjik. Si rrjedhojë, pasi u konstatua vetëm një shtresë e pikturës, u krye fillimisht pastrimi i ikonës nga shtresat e pluhurave, dezinfektimi dhe konsolidimi i suportit të drurit. Më pas, u konsolidua shtresa e grundit dhe ajo e ngjyrës, në vendet ku u vërejt shkëputja e saj, pastrimi i sipërfaqes nga mbetjet e qirinjve dhe verniku i degraduar, si dhe u krye mbushja e lakunave dhe integrimi me ngjyrë. Për mbrojtjen e shtresës së pikturës u krye lyerja me vernik e gjithë sipërfaqes, duke arritur në përfundim paraqitje estetike të ikonës dhe lexueshmëri të lartë të imazhit të saj dhe duke mundësuar përvijimin e të dhënave përshkrimore më të detajuara. Kështu, krahas identifikimit të paraqitjes me imazhin e Shën Simonit, mund të deduktojmë se me anë të një palete

ST. SYMEON, ICON

The small icon of St. Simon which comes from the church of Transfiguration in the village of Mingul, adorned the epistyle of the iconostasis, as part of the Great Deesis. It is astonishingly decorated with a wooden carved frame in relief, displaying twisted colonettes, a shell – shaped niche integrated within standard rosette and scrolling foliate motifs. The icon panel was assembled from a single plank of well dried wood presumably of walnut and measures around 65.5 x 30 cm. The icon of St. Simon was stored in the Albanian National Museum storage environments and was selected for the conservation program implemented by trained restorers in the laboratory of the Albanian Institute of Monuments. The icon was found in a very bad state of preservation. The examination by the conservation professionals noticed that the object was subjected to various deteriorating factors; the wooden support was eroded by insect attack, which weakened its structure, affecting also the preparatory layers and the accumulation of surface dirt had made the representation unrecognizable.

In order to develop a conservation strategy and determine the treatment methodology, a range of analytical and diagnostic techniques were used which included non invasive scanning by means of X–ray radiography to ascertain the state of preservation of wooden support and existence or not of superimposed layers, pigment and medium analysis using X – ray fluorescence and UV fluorescence.

The X–ray radiography confirmed the existence of a single layer of painting. Initially the restorers proceeded with the cleaning of the accumulated dirt over the paint layer and after that with the disinfection of the object and the consolidation of the wooden support. Since the preparatory layers were severely damaged the subsequent move was the consolidation of ground and of the paint layer in many areas where its detachment was observed, and then the cleaning of the surface from candle residues and the deteriorated varnish layer. The filling of lacunae and color integration was also performed. For additional protection the whole painted surface of the icon was

DO NOT COPY

të kufizuar ngjyrash dhe me pikturimin shprehës, artisti i bën jehonë modeleve paleologe të modelimit të portretit, me trajtimin energjik të volumeve, formën e rrudhave dhe përdorimin
e penelit të gjerë për dritëhijet, ndërsa edukimi estetik me artin perëndimor ndjehet në gjestikulimin delikat të duarve. Duke iu referuar strukturës së ikonës, analizës stilistikore dhe të dhënave epigrafike që ruhen në kishë, mendojmë se ajo datohet në fund të shek. XVIII.
Ndërhyrjet konservuese – restauruese u kryen në vitin 2012 nga Enkelejda Nesturi, Zamir Marika, Genci Treska, në bashkëpunim me laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, drejtuar nga Prof. Nikolla Civici.

varnished and in the end a better legibility of the form and content of the icon was achieved with a more aesthetic representation of its image for further research. With the possibility of identification of the image with St. Symeon, one can deduce that even through a limited palette of colors, the artist recalls forms of the paleologan period. This is evident in the dynamic rendering of the volumes, the elaboration of garments and the modeling with rough brushstrokes and the highlighting of the face, while the delicate gesticulation of the hands and tranquil expression shows his contacts with western ideas.
The structure of the icon combined with iconographic and epigraphic data preserved inside the church decoration, suggest a late dating, around the end of 18th century.
The conservation interventions of the icon were implemented in 2012 by Enkelejda Nesturi, Zamir Marika and Genc Treska, in collaboration with the laboratory of the Institute of Applied Nucleonics, led by Prof. Nikolla Civici.

DO NOT COPY





Shën Simoni (para dhe pas restaurimit)
St. Symeon (before and after restoration)

KRYQËZIMI, IKONË

Ikona e Kryqëzimit e ka prejardhjen nga kisha e Shën Kollit, në fshatin Krutje e Sipërme (Lushnjë) dhe ishte pjesë e kompozimeve narrative ungjillore, që dekoronin ikonostasin e monumentit. Ajo ka përmasa 43 x 33 cm dhe është punuar në dru arre. Ikona qëndronte e depozituar në fondet e Muzeut Historik Kombëtar, nga ku u transportua për në laboratorin e Artit, pranë Institutit të Monumenteve, për t'iu nënshtruar procesit të konservimit dhe restaurimit.

Paraprakisht, objekti iu nënshtrua analizave diagnostikuese jo dëmtuese të radiografisë me rreze X, për përcaktimin e gjendjes së suportit të drurit dhe të ekzistencës apo jo të shtresave më të vjetra të pikturës, analizës me rreze UV, analizës së pigmenteve me Fluoreshencë X dhe analizës spektrale me ndihmën e mikroskopit mineralogjik.

Pas rezultateve të tyre, u përcaktua metodologjia e ndërhyrjeve konservuese – restauruese, të cilat konsistonin në pastrimin e ikonës nga shtresat e pluhurave, dezinfektimi dhe konsolidimi i suportit të drurit, konsolidimi i shtresës së grundit dhe i sipërfaqes së ngjyrës në vendet ku u vërejt shkëputja e saj, pastrimi i sipërfaqes nga mbetjet e qirinjve dhe verniku i degraduar, si dhe u krye mbushja e lakunave dhe integrimi me ngjyrë. Në përfundim u krye edhe lyerja me vernik e gjithë sipërfaqes.

Ky proces i rëndësishëm i konservimit dhe restaurimit jo vetëm siguroi konsolidimin dhe jetëgjatësinë e ikonës, por njëkohësisht arriti edhe prezantimin e saj me imazh më të qartë, estetik dhe të lexueshëm. Aty paraqitet subjekti i Kryqëzimit, i frymëzuar nga tekstet ungjillore, ku Krishti përfytyrohet në një sfond mistik ngjyrë të artë dhe blu të kodrave të Golgotës dhe pas tyre ngihen muret e larta të Jerusalemit. Krahas figurës qendrore të kompozimit, i cili dallon për muskulaturën e theksuar të anatomisë, perizomën e bardhë, aureolën e artë me kryq të brendashkruar me ngjyrë të kuqe dhe mbishkrimin shoqërues INBI (Ιησούς Ναζωραίος Βασιλεύς Ιουδαίων) paraqiten dhe Shën Mëria me Shën Gjonin në njërën anë dhe Longini me ushtarët e tjerë në anën tjetër, të ndara në një krijim të balancuar.

Ndonëse ekzekutimi i veprës karakterizohet si arkaik, që

CRUCIFIXION, ICON

The small icon of Crucifixion which comes from the church of St. Nicholas in the village Krutje e Sipërme (Lushnje) adorned the epistyle of the iconostasis as part of the Dodekaorton, the Twelve Great Feasts series. The icon panel measures around 43 x 33 cm and was assembled from a single plank of well dried walnut wood. This object belongs to the Albanian National Museum icon collection and was deposited into its storage environments. Due to its bad state of preservation the icon was selected for the conservation – restoration program led by The Institute of Cultural Monuments. Before the beginning of restoration interventions the icon was subjected to various diagnostic analyses, in order to ascertain its state of preservation and to define a proper methodology for its treatment, which included non invasive scanning by means of X – ray radiography to ascertain the state of preservation of wooden support and existence or not of superimposed layers, pigment and medium analysis using X – ray fluorescence, UV fluorescence and Spectral analysis.

The X – ray radiography confirmed the existence of a single layer of painting. Initially the restorers proceeded with the cleaning of the accumulated dirt over the paint layer and after that with the disinfection of the object and the consolidation of wooden support. Since the preparatory layers were severely damaged the subsequent move was the consolidation of ground and of the paint layer in many areas where detachment was observed, and the cleaning of the surface from candle residues and the deteriorated varnish layer. The filling of lacunae and color integration was performed. For additional protection the whole painted surface of the icon was varnished.

The improvement of the aesthetic appearance of the icon assured a better legibility of its content. In the Crucifixion are depicted Christ and the other figures, as usually in icons of this kind. The figure of Christ Crucified is represented against a mystic gold and blue background with the rocks of Golgotha and the walled city of Jerusalem spreading in the horizon behind him. Besides the main figure of Christ represented with a distinctly curved body with emphasized musculature and wearing a vividly lit

DO NOT COPY

reflektohet në elementë si tonalitetet e thjeshta të ngjyrave, ku spikat përdorimi i të bardhës, të zezës, të kuqes, blusë, okrës dhe derivateve të tyre, mungesa e modelimit të detajuar të trupave dhe fizionomive të figurave dhe e përcjelljes së emocionit, disa tipare të saj, si maska e njeriut në uniformën e centurionit, fytyrat e ëmbla dhe kontrastet e çiltra, sugjerojnë zhvillime më të vona në fushën e ikonografisë. Mbështetur në karakteristikat e ikonës dhe të dhënat e tjera mbishkrimore, mendojmë se ajo është vepër e Naum Çetirit, i cili ka punuar për pasurimin e ikonostasit të kishës me piktura të porositura nga anëtarë të komunitetit, duke filluar nga viti 1821. Edhe afresket e kishës i përkasin ateliesë së Çetirëve. Ato janë vepër e Nikollë Çetirit, të realizuara në vitin 1811.

Ndërhyrjet konservuese – restauruese në ikonë u kryen nga Enkelejda Nesturi, Zamir Marika dhe Genci Treska, në bashkëpunim me laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, drejtuar nga Prof. Nikolla Civici.

loincloth, with a gold halo and the usual inscription INBI (Ιησούς Ναζωραίος Βασιλεύς Ιουδαίων), in a balanced composition are also depicted the figures of the Virgin and John and Longinus and the soldiers. Despite the archaic rendering of the painting with the simple color palette, the lack of elaborate modeling of bodies and physiognomies, there are some features as the human mask in Centurion military garment, the serene and tender style and the light coloring suggesting later developments.

These stylistic features combined with the epigraphic data obtained from the wall – paintings of the church interior and the other icons which adorned the altar screen suggests that the icon of Crucifixion may be attributed to Naum Çetiri, with the commission of community members since 1821. The wall paintings of the church are also works of the workshop of another master from Çetiri workshop, Nikolla Çetiri, who worked in 1811.

The conservation interventions of the icon were implemented in 2012 by Enkelejda Nesturi, Zamir Marika and Genc Treska, in collaboration with the laboratory of the Institute of Applied Nucleonics, led by Prof. Nikolla Civici.

DO NOT COPY

Bibliografi:

POPA, TH., "Piktorët grabovarë Çetiri nga familja Katro", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, 3*, 1960, f. 121 – 142.

POPA, TH. *Mbishkrime të kishave në Shqipëri.* Tiranë, 1998.





Kryqëzimi (para dhe pas restaurimit)
Crucifixion (before and after restoration)

NGJITJA NË QIELL, IKONË

Ikona me kompozimin e Ngjitjes në Qiell vjen nga kisha e Apostujve të Shenjtë Pjetri dhe Pavli në Hoshtevë, Gjirokastër. Ajo gjendej e depozituar në fondet e Muzeut Historik Kombëtar, ku si rrjedhojë e kohës dhe ndryshimeve të kushteve klimaterike, ka pësuar dëmtime, të cilat reflektohen edhe në imazhin e sotëm të saj. Ikona është punuar me dru arre dhe ka përmasa 31x36,5 cm.

Në vitin 2012, përpara se t'i nënshtrohej ndërhyrjeve konservuese – restauruese në laboratorin e Artit të Institutit të Monumenteve nga ana e specialistëve restauratorë, objekti u trajtua me anë të metodave diagnostikuese jo dëmtuese të radiografisë me rreze X, për përcaktimin e gjendjes së suportit të drurit dhe të ekzistencës apo jo të shtresave më të vjetra të pikturës, analiza me rreze UV, analiza e pigmenteve me Fluoreshencë X dhe analiza spektrale me ndihmën e mikroskopit mineralogjik. Si rezultat i tyre u përcaktuan aspekte të patologjisë, të ngjyrave dhe mekanizmat e ndërhyrjes.

Kështu, u krye pastrimi i ikonës nga shtresat e pluhurave, dezinfektimi dhe konsolidimi i suportit të drurit, konsolidimi i shtresës së grundit dhe i sipërfaqes së ngjyrës në vendet ku u vërejt shkëputja e saj, pastrimi i sipërfaqes nga mbetjet e qirinjve dhe verniku i degraduar, mbushja e lakunave dhe integrimi me ngjyrë. Për mbrojtjen e shtresës së pikturës u krye lyerja me vernik e gjithë sipërfaqes së saj.

Në përfundim të ndërhyrjeve u përftua lexueshmëri më e lartë e kompozimit dhe pjesëve përbërëse të tij. Aty paraqitet Krishti, i cili lartësohet drejt parajsës, i ulur në madhështi brenda një mandorle të kuqe me rreze të arta, që mbahet si një lloj embleme nga dy engjëj. E gjithë ngjarja zhvillohet në një sfond ngjyrë ari, poshtë të cilit shtrihet kreshta e malit të Ullinjve, e pasqyruar me ngjyrë rozë. Dishepujt janë organizuar në dy grupime në pjesën e poshtme të kompozimit, me Shën Mërinë në qendër dhe dy engjëj të veshur me të bardha, të cilët shoqërojnë figurën e saj. Disa prej tyre vështrojnë ngjarjet të mrekulluar, në habi dhe të shqetësuar, ndjesi të arritura pjesërisht nëpërmjet gjestikulimeve dhe pozicionimit energjik. Elementët përbërës të këtij tipi ikonografik u formuluan

ASCENSION

The icon of Ascension comes from the Church of The Holy Apostles Peter and Paul in the village of Hoshtevë, Gjirokastër. The icon was stored in the Albanian National Museum storage environments where the dramatically inadequate microclimatic conditions caused damages, affecting also the paint surface. Thus, the icon was selected and included for the conservation program implemented by trained restorers in the laboratory of the Albanian Institute of Monuments. The icon panel was assembled from a plank of well dried walnut wood and measures around 31x36, 5 cm.

